



Komisioni i Komunitetit European, per dhe ne emer te Qeverise se Shqiperise,
Ref.: Ndhma Europiane/124909/C/SER/AL

Strategjia Kombetare Shqiptare mbi Mbetjet

Komponenti D: Planet e Menaxhimit te Mjedisit
Aktiviteti: Plani Kombetar i Menaxhimit te Mbetjeve



25 Maj 2010

Ky raport eshte pergatitur nga nje grup pune i Grontmij I Carl Bro, iniciative e financuar nen Bashkimin European CARDS 2006. Gjetjet, perfundimet dhe interpretimet te shprehura ne kete dokument jane ato te Grontmij I Carl Bro vetem dhe nuk reflektojne domosdoshmerisht opinionet dhe politikat e Keshillit European

Komisioni i Komunitetit European, per dhe ne emer te Qeverise Shqiptare,

Ref.: Ndhma Europiane/124909/C/SER/AL

Zbatimi i Planit Kombëtar për Përafrimin e Legjislacionit Mjedisor në Shqipëri

Planet e Menaxhimit Mjedisor

Strategjia Kombetare e Mbetjeve per Shqiperine

Mirenjohje:

Ekipi i projektit dëshiron ti shprehë mirënjohjen e tij të gjithë personave qe kane marre pjese ne kete projekt, ekspertëve nga të gjitha institucionet dhe palët e përfshira në mbledhjen e të dhënave dhe të informacionit si dhe të gjithë personave dhe organeve që kanë mbështetur zhvillimin e këtij Raporti. Falenderime të veçanta i shprehen Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të stafit të saj.

Permbajtja

LISTA E AKRONIMEVE	4
1. ADMINISTRIMI I MBETJEVE NE SHQIPERI	5
1.1 PERSHKRIM I PERGJITHSHEM LEGJISLATIV	5
1.1.1 <i>Kuadri Aktual Ligjor</i>	5
1.1.2 <i>Gjendja Aktuale e Zbatimit</i>	7
1.2 TRANSPONIMI I SEKTORIT LEGJISLATIV MBI ADMINISTRIMIN E MBETJEVE TE BE-SE	8
1.2.1 <i>Kerkesat e Direktives Kuader te Mbetjeve</i>	9
1.2.2 <i>Kerkesat e Legjislacionit te BE per Rrymat e Mbetjeve</i>	13
1.3 RRTIJA E GJENERIMIT TE MBETJEVE	20
1.4 GJENDJA AKTUALE E INVESTIMEVE	25
2.1 SHQIPERIA DHE BASHKIMI EUROPIAN: MOMENTET HISTORIKE	31
2.1 NJE VESHTRIM STRATEGJIK MBI SEKTORIN E MBETJEVE	32
2.1.1 <i>Hyrje ne Strategjine mbi Mbetjet</i>	32
2.2.2 <i>Administrimi i Mbetjeve: Sektori Specifik</i>	34
2.2.2 <i>Perparesite e Programit te Qeverise</i>	35
2.2.3.1 <i>Pertesimi i Standarteve Ligjore te Komunitetit Europian</i>	35
2.2.3.2 <i>Forcimi i zbatimit te ligjit mbi mbetjet</i>	36
2.2.3.3 <i>Investimet per mbrojtjen e mjedisit</i>	37
2.2.3.4 <i>Suport Financiar per Infrastrukturen e Mjedisit</i>	39
2.2.3.5 <i>Administrimi i burimeve mjedisore</i>	39
2.2.3.6 <i>Permiresimi i komunikimit dhe ndegjegjesimit</i>	39
2.2.3.7 <i>Permisimi i sistemit monitorues</i>	40
2.3 STRATEGJIA E QEVERISE	41
2.3.1 <i>Mbetjet e Rrezikshme Industriale te Ngurta</i>	42
2.3.2 <i>Ndotja e vendeve industriale nga hedhja e mbetjeve</i>	42
2.3.3 <i>Mbetje te rrezikshme</i>	43
2.3.3.1 <i>Elementi i I-re Strategjik: Planifikimi dhe Ngritja e Njesive (Vend-depozitimeve per Trajtimin e Mbetjeve te Rrezikshme</i>	45
2.3.3.5 <i>Elementi V-te Strategjik: Struktura Ligjore</i>	46
2.4 PARIMET E MENAXHIMIT TE MBETJEVE	49
2.4.1 <i>Hierarkia e Mbetjeve</i>	49
2.4.2 <i>Afersia e vendodhjes dhe Vete - Mjaftueshmeria</i>	50
2.4.3 <i>Ndotesi paguan</i>	50
3. POLITIKA KOMBETARE MBI MBETJET PER SHQIPERINE	51
3.1 POLITIKA PER ADMINISTRIMIN E INTEGRUAR TE MBETJEVE	51
3.1.1 <i>Edukimi ne Menaxhimin e Mbetjeve</i>	52
3.1.2.1 <i>Fushata per Informimin e Publikut</i>	52
3.1.2.2 <i>Trajnimi profesional</i>	53
3.1.3 <i>Financimi ne Menaxhimin e Mbetjeve</i>	53
3.1.4 <i>Legjislacioni ne Menaxhimin e Mbetjeve</i>	53
3.2 PERMIRESIMI I MENAXHIMIT TE MBETJEVE NE TE ARDHMEN	53
3.2.1 <i>Planifikimi I masave per te beret e mundur ndarjen nga mbetjet te materialeve per riciklim</i>	54
3.2.2 <i>Rritja e pergjegjesise se prodhuesve</i>	54
3.2.3 <i>Permiresimi i sistemit aktual te te dhenave mbi mbetjet</i>	54
3.3 MEKANIZMAT PER TE SIGURUAR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TE MBETJEVE	55
4. IMPLIKIMI FINANCIAR MBI KUADRIN EKONOMIK	59
4.1 BURIMET E FINANCIMIT	60
4.1.1 <i>Faza e 1 e Financimit: (Para pranimit ne BE)</i>	60
4.1.2 <i>Faza e 2 e Financimit: (periudha e pas pranimit ne BE)</i>	61
4.2 TARIFAT E MBETJEVE	62
4.3 FONDI MJEDISOR	63
5. RAPORTIMI, MONITORIMI DHE VLERESIMI	65
5.1 HAPAT E TJERE DHE MBAREVAJTJA E MONITORIMIT	65
5.1.1 <i>Administrimi i Ndryshimeve</i>	65
5.1.2 <i>Mbajtja ne Dijeni e Aktoreve kryesore</i>	65
5.1.3 <i>Monitorimi dhe Rishikimi i Planeve Zonale te Mbetjeve dhe Planit Kombetar mbi Mbetjet</i>	66
<i>Gjendja e Mjedisit</i>	66
<i>Raportimi dhe komunikimi midis institucioneve qeveritare</i>	68
<i>Komunikimi me komunitetin dhe me palet e tjera te interesuara</i>	68

Lista e Akronimeve

LEK	Leke/Leku Shqiptar
SHRSH	Shoqata e Ricikluesve Shqiptare
OMPM	Opsioni me i Mire i Praktikuar per Mjedisin
NSHM	Ndertimi dhe Shkaterrimi i Mbetjeve
KM	Keshilli i Ministrave
GjED	Gjykata Europiane e Drejtesise
AMP	Agjensia e Mjedisit dhe Pyjeve
VNM	Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis
FMT	Mjetet e Transportit Jashte Perdorimit
MR	Mbetjet e Rrezikshme
SPI	Sistemi i Planifikimit te Integruar
PZPKPLM	BE, CARDS 2006 Projekti per Zbatimin e Planit Kombetar per Perafrimin e Legjislacionit Mjedisor/ INPAEL
METE	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjise
MMPAU	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujërave
MSh	Ministria e Shendetesise
MPPTT	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
PBA	Programi Buxhetor Afatmesem
PKPL	Plani Kombetar per Perafrimin e Legjislacionit
SKZhl	Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrim
SKZhSE	Strategjia Kombetare per Zhvillimin Social- Ekonomik
PBB	Difenile polibromure
PBDE	Etere te difenilit polibromur
PCBs	Difenile poliklorur
PCTs	Terfenile poliklorur
PABL	Planifikimi, Arsimi, Burimet dhe Legjislacioni
NOQ	Ndotësit Organik te Qëndrueshëm
PVC	Poliklorur Vinili
ARM	Agjencitë Rajonale te Mjedisit
R.Sh	Republika e Shqipërisë
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asocimit

1. Administrimi i Mbetjeve ne Shqipëri

Administrimi i mbetjeve ne Shqipëri është ne një nivel shume te ulet. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve te ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Praktikohet shume pak riciklimi. Kryesisht mbetjet asgjësohen ne vend grumbullimet e mbetjeve. Me disa përjashtime te vogla (landfill-et e Sharres dhe Bushatit) nuk ka venddepozitime te tjera te planifikuara siç duhet. Dy venddepozitime te tjera te mëdha qe po planifikohen te bëhen brenda një afati te shkurtër janë: një ne Korçe/ Maliq (mbështetur nga KfW) dhe një tjetër ne Sarande/Bajkaj (mbështetur nga Banka Botërore). Nuk ka sisteme grumbullimi ne zonat rurale dhe qytetet e vogla. Pjesa me e madhe e mbetjeve te këtyre zonave depozitohen neper lumenj ose ne ane te rrugëve te cilat transportohen nga ujërat dhe ne ketë mënyre zhvendosen ne një pjese tjetër toke dhe ne fund ne rrjedhat ujore.

Nuk ka një sistem te sigurve për administrimin e mbetjeve te rrezikshme (atyre te prodhuara nga industritë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit te mbetjeve te rrezikshme është shume i dobët dhe pjesa me e madhe e grumbullimit te mbetjeve kryhet nga sektori privat gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë ne pronësi te sektorit privat. Sigurimi i këtyre aktiviteteve dhe sistemi i menaxhimit janë akoma ne fillimet e tyre dhe varen nga disponueshmeria e materialeve te riciklueshme me nje cilesi te mire. Ne shumicen e rasteve industria e riciklimit varet nga lendet e para te riciklueshme qe importohen ne Shqipëri.

Ekziston nje politike dominuese dhe e perhapur e hapjes se gropave dhe e grumbullimit te mbetjeve ne to. Instrumentet ekonomike per administrimin e mbetjeve jane te pakta dhe me vlere te pakonsiderueshme.

Problemet e administrimit te mbetjeve jane te shumta dhe te ndryshme. Pjesa me e madhe e mbetjeve te krijuara (ne peshe) jane te prirura te jene substanca inerte, ne vecanti mbetjet e ndertimeve, por rreziqet me te medha jane te lidhura me vellime te vogla (kryesisht industriale) te mbetjeve te rrezikshme. Mbetjet komunale kane nevojë per nje grumbullim te kushtueshem dhe te zgjeruar, transportim dhe rregullim. Kondita te vecanta duhet ti aplikohen kategorive te ndryshme, si p.sh mbetjet nga shendetsia. Sektori i mbetjeve paraqet nje nga sfidat me te rendesishme qe ndesh Shqipëria.

Raporti i fundit Mjedisor i hartuar nga Qeveria permbledh keto ceshtje:

- Sistemet per grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve jane te pamjaftueshme dhe joefektive;
- Vendimet per mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund te behen ne mungese te nje informacioni te besueshem;
- Nuk ka nje tradite te mirefillte per trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike jane te pamjaftueshme; dhe
- Publiku ka mungese informacioni persa i perket rrezikut qe shkaktohet nga administrimi i dobet i mbetjeve.

1.1 Pershkrim i Pergjithshem Legjislativ

1.1.1 Kuadri Aktual Ligjor

Perparimi me i madh persa i perket administrimit te mbetjeve deri tani eshte bere ne fushen e legjislacioni. Gjate periudhes 2003-2008 ligjislacioni mbi administrimin e mbetjeve ne Shqipëria ka perparuar me aprovimin e Ligjeve te reja, vendime dhe rregullore/udhezime qe pasqyrojne

direktivave/vendimet e KE dhe kërkesat e Konventës së Baselit. Parimet kryesore të administrimit të mbetjeve janë dhënë më poshtë:

- Ligji nr.8934, dt. 05.09.2002 “Mbi mbrojtjen e mjedisit”, ndryshuar nga Ligji no.9890, date 20.3.2008 dhe Ligji nr.9983, date 8.9.2008;
- Ligji nr.9010, dt.13.02.2003 “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta” dhe
- Ligji nr.9537, dt.18.5.2006 “Mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Një tjetër numër aktesh kanë të bëjnë direkt ose indirekt me mbetjet, përfshirë:

- Vendimin nr. 803, date 04.12.2003 “Mbi miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin, riciklimin dhe trajtimin e mbetjeve”.
- Vendimi nr. 99, dt.18.02.2005 “Mbi miratimin e listës Shqiptare për klasifikimin e mbetjeve”
- Norma nr.1, date 30/3/ 2007 “Mbi trajtimin e mbetjeve të ndertimit dhe prishjes nga krijimi dhe transportimi për asgjësimin”
- Norma nr.6, date 30.11.2007 “Mbi administrimin e mbetjeve spitalore”.
- Udhëzuesi nr.6, date 27.11.2007 “Mbi miratimin e rregullave, përmbajtjes dhe afatëve për hartimin e planeve për administrimin e mbetjeve të ngurta”

Ligjet ekzistuese Shqiptare transponojnë vetëm pjesërisht kërkesat e BE përsa i përket sektorit legjislativ mbi mbetjet. Shumë nga konceptet bazë mungojnë ashtu si edhe procedurat më të detajuara të për administrimin e mbetjeve.

Në të tjera Shqiptare që nuk transponojnë domosdoshërisht ligjet Europiane mbi mbetjet përfshijnë:

- Ligji Nr.8094, dt.21.03.1996 “Mbi heqjen publike të mbetjeve”
- Ligji Nr.9663, dt.18.12.2006 “Mbi koncensionet”. Nder çështjet e tjera ligji mbulon shërbimet publike dhe administrimin e mbetjeve, gjithashtu, përfshinë ndertimin e objekteve për trajtimin e mbetjeve.
- Ligji Nr.8652, dt.31.07.2000 “Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisë lokale”.

Duke monitoruar transportin siç është bërë në projektet “Monitorimi i Progresit për vendet potenciale kandidatë dhe ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë 2006-2007 dhe 2007-2008” në emër të KE, është vlerësuar që Direktiva 91/689/KEE mbi mbetjet e rrezikshme është transponuar rreth 62%, direktiva 75/442/KEE mbi mbetjet është transponuar 46% (sipas Ligjit mbi mbetjet e Rrezikshme), po sipas të njëjtes Direktive 75/442/KEE është vlerësuar që vetëm 15% është transponuar sipas Ligjit 9010, date 13.2.2003 “ Mbi trajtimin e mbetjeve të ngurta”.

Transpozimi i direktivave të reja dhe thellimi i metejshëm i tyre është bërë pothuajse gati, gjithashtu është bërë gati një plan me afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Ky është një rekomandim që bëhet në raporte të ndryshme të KE, Dokumenti I BE mbi Bashkëpunimin, Komiteti i Përbashkët i Takimeve etj.

Duke patur këto parasysh duhet të bëhet një draft i plotë Ligjesh mbi Administrimin e Mbetjeve duke marrë për bazë direktivën e re të Mbetjeve 2008/98/KE (duke përfshirë mbetjet e rrezikshme dhe ato të parrezikshme). Kjo strukturë është duke u përgatitur dhe duhet të përfundojë brenda gjysmës së parë të 2010, në kuadrin e projektit CARDS 2006 (PZPKPLM / INPAEL). Ky Ligj i ri do të shfuqizojë disa pjesë mbi mbetjet që ndodhen në legjislativat të cilat u përmenden më lartë, kështu do të vendoset një qasje më koherente dhe e integruar mbi administrimin e mbetjeve. Drafti i ri Ligjor mbi Administrimin e Mbetjeve do të rezultojë në shfuqëzimin e këtyre dy ligjeve. Kjo gjithashtu do të vendosi bazën ligjore për legjislativin dytesorë si dhe përputhjen me direktiva të tjera të ndryshme mbi mbetjet.

Dy Projekt Vendimet që po përgatiten nga INPAEL do të plotësojnë paketën e re ligjore mbi mbetjet: një Projekt Vendim mbi landfillin e mbetjeve (ato të rrezikshmet dhe të parrezikshmet bashkë) dhe një Projekt Vendim mbi Djegjen (gjatë gjysmës së parë të 2010). Përveç kësaj po përgatiten disa Projekt

Vendime nga nje projekt i IFC i cili po transponon Direktivat per Baterite dhe Akumulatoret, Ambalazhimin dhe Direktiva e Paketimit dhe te Paketimit te Mbetjeve dhe Direktivat e MPEE

Sic u permend me lart nje numer ligjesh jane aprovuar. Midis tyre permendim Ligjin 9010 mbi mbetjet e ngurta (jo te rrezikshme) dhe Ligji 9537 mbi mbetjet e rrezikshme qe jane me te rendesishmet. Pritet qe projekt ligji i ri mbi Administrimin e Mbetjeve do te rezultojte ne shfuqizimin e ketyre dy ligjeve.

1.1.2 Gjendja Aktuale e Zbatimit

Sic u shpjegua me siper, problemi me i madh ne administrimin e mbetjeve ne Shqiperi nuk qendron te mungesa e ligjeve (qe kane nevojte te permisohen edhe me tej), por te mungesa e planifikimit te menaxhimit institucional, teknik dhe kapaciteteve njerezore, burimeve financiare dhe investimeve ne infrastrukture; mungese experience/ tradite ne administrimin e nje sektori te tille; mungese e mjeteve ekonomike te perdorura per administrimin e mbetjeve; nje komunikim i dobet midis qeverise lokale dhe qendrore mbi ceshtjet e mbetjeve; nje bashkepunim i dobet midis njerezve dhe ndermarrjeve private mbi ceshtjen e mbetjeve; mungese mbi monitorimin, treguesin dhe statistikat e mbetjeve si dhe mungesa e rrjeteve per te mbledhur dhe perpunuar ato, etj

Nje analize e shkurter mbi zbatimin e ceshtjeve specifike persa i perket Direktives se Re mbi Mbetjet ne Shqiperi:

Nje hierarki mbetjesh

Eshte pranuar nga ligjislacioni i tanishem, por ende nuk eshte vene ne praktike;

Pergjegjesia e prodhuesit

Nuk jane ndermarre akoma hapa per te perfshire keto koncepte ne legjislacionin aktual, gjithashtu nuk jane ndermarre as ne praktike;

Perpunimi, riperdorimi dhe riciklimi i mbetjeve

Shoqata e Ricikluesve Shqiptare (SHRSH) eshte krijuar kohet e fundit. Rreth 60 kompani private jane ne treg te cilat po merren me riciklimin e mbetjeve. Jo te gjitha prej tyre kane leje per te vepruar nga MMPAU. Kompanite riciklojne keto rryma mbetjesh:

- o Riciklim letre: 3 kompani
- o plastike: 10 kompani
- o tekstik: 1 kompani
- o alumin: 4 kompani
- o celik: 15 kompani
- o metal skrap: 21 kompani
- o mbetje inerte (tulla nga shkaterimet): 1 kompani
- o dru: 1 kompani
- o vajra te mbetura: 1 kompani
- o goma te perdorura: 1 kompani

Grumbullimi mbetjeve per riciklim nga keto kompani behet ne menyre te thjeshte. 92% e komunitetit Rom, merret me mbledhjen e tyre, te cilet jane te rregjistruar si te papune. Jane rregjistruar rreth 12.000 individe qe merren me mbledhjen e metaleve. Ata nuk jane pajisur mire dhe te patrajnuar dhe mbi te gjitha nuk kane nje kontrate zyrtare me blesesit e tyre.

Jane identifikuar barrierat qe pengojne riciklimin: cmimi i larte i energjise si dhe cmimi i transportit, fuqia e dobet ekonomike e grumbulluesve, individet dhe kompanite sebashku; mungese e vecimit qe ne fillim; mungese informacioni ne nivel publik, administrative dhe tregtar; mungese ne stimulimin dhe promovimin e riperdorimit, riciklimit dhe perpunimin; mungese eksperience nga vete bizneset; veshtiresi ne hyrjen e burimeve financiare per te zhvilluar biznese te tilla.

Asgjesimi i mbetjeve

Shqiperia ka nje numer te madhe me pirgje plerash te trasheguara nga e shkuara, qe mund ti kene kaluar kapacitetet e tyre. Disa jane krijuar kohet e fundit. Gjithashtu ka te tjera qe jane jo legale. Shume prej tyre jane te rrezikshme. Asnje prej tyre nuk perputhet me kerkesat qe vendosen ne Direktivat e Landfillit. MPPTT ka plane per kryerjen e studimeve dhe punimeve per mbylljen e nje numeri venddepozitimesh si dhe per ndertimin e disa te rejave.

Administrimi i mbetjeve

Mbledhja e tarifave per mbetjet, e njohur si "Tarifa e Pastrimit", jane vendosur nga njesite e qeverise vendore sipas Ligjit mbi Taksat Lokale. Keto taksa jane te ndryshme per bashki te ndryshme. Ato jane shume te ulta, me disa ndryshime. Keto taksa kane te bejne vetem me pastrimin e qytetit, mbledhjen, transportin dhe per heqjen mbetjeve urbane nga gropat perkatese. Ato nuk mbulojne asnje perpunim, supervizim apo nje kujdes te mevonshem kur hidhen neper venddepozitime.

Nuk ka nje rrjet te integruar dhe te pershtatshem impiantesh per trajtimin dhe heqjen e mbetjeve si dhe rikuperimin e mbetjeve. Ata nuk e marrin ne konsidrate Teknikat me te Mira te Disponueshme (TMD). Nuk ka pasur asnje bashkepunim me Shtetet Anetare te tjera persa i perket administrimit te mbetjeve

Mbetjet e rrezikshme

Deri me tani, edhe pse e ndaluar me ligj, mbetjet e rrezikshme depozitohen ne te njeitin vend me ato te parrezikshme. Paketimi dhe etiketimi i duhur nuk jane ende pjese e praktikës, edhe pse legjislacioni e parashikon ate.

Vajrat e mbetura

Ka vetem nje kompani private ne Durres qe merret me mbledhjen e vajrave te mbetura me qellim riciklimin.

Mbetjet Bio

Keto lloj mbetjesh depozitohen ne te njeitin vend me mbetjet e tjera.

Lejet dhe regjistrimi

Leje mjedisore jane leshuar nga MMPAU per nje numer venddepozitimesh dhe nje landfill ne Shkoder. Nuk ka nje format standart per ndonje regjister qe eshte mbajtur deri me tani.

Administrimi i projekteve mbi mjedisin

Legjislacioni mbi Administrimin e Projekteve e Mbetjeve ekziston, por vetem disa projekte jane pergatitur deri tani. Nuk ka ende programe mbi parandalimin e mbejeteve.

1.2 Transponimi i sektorit legjislativ mbi Administrimin e Mbetjeve te BE-se

Qeveria shqiptare është angazhuar ne procesin e anëtarësimit të plotë në BE dhe në këtë drejtim, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave ka punuar për perputhjen e instrumenteve kryesore legjislative të BE në instrumentet ligjore shqiptare. Ky program per perputhjen e legjislacionit është financuar nga BE dhe perfshine projektet aktuale te PZPKPLM / INPAEL.

Ky projekt ka te ngjare te vazhdoje deri me 2012 pasi statusi aktual i Direktivave mbi perputhjen eshte perfunduar vetem pjeserisht. Legjislacioni qe i perket kesaj politike, strategjia e re dhe projekti eshte si me poshte:

- Direktiva 2008/98/KE mbi Mbetjet (Direktiva Kuader mbi Mbetjet);
- Direktiva 99/31/KE mbi Landfill-in e Mbetjeve;
- Direktiva 75/439/KEE mbi Heqjen e Vajrave te mbetura;

- o Direktiva 2006/66/KE mbi Baterite dhe Akumulatorët;
- o Direktiva 2002/96/KE mbi Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPEE);
- o Direktiva 2000/76/KE mbi Djegien e Mbetjeve;
- o Direktiva 2006/21/KE mbi Administrimin e Mbetjeve të prodhuara nga Industrite Nxjerrese;
- o Direktiva 2000/53/KE mbi Makinat jashtë përdorimit (në fund të jetës);
- o Direktiva 96/59/KE mbi Heqjen e PCB/PCT;
- o Direktiva 94/62/KE mbi Paketimin e dhe Paketimin e Mbetjeve;
- o Direktiva 86/278/KEE mbi Llumrat e kanalizimeve.

Me sipër është vetëm një listë specifike e legjislacionit përsa i përket mbetjeve. Ka një draft mbi legjislacionin mjedisor që pritet ose tashmë është duke u kthyer në Ligj. Ky është një proces i cili po vazhdon ende.

1.2.1 Kërkesat e Direktives Kuader të Mbetjeve

Legjislacioni kryesor nga Bashkimi Europian që ka të bëjë me mbetjet është Direktiva Kuader e Mbetjeve. Direktiva 2008/98/KE mbi mbetjet adaptuar në Nentor të 2008 parashikon një qasje të re mbi administrimin e mbetjeve bazuar në parandalimin e ndikimeve negative të gjenerimit të mbetjeve dhe administrimit mbi shëndetin e njeriut dhe mjedisin, si dhe duke synuar kufizimin e prodhimit të mbetjeve, si dhe nxitjen e përdorimit të mbetjeve si burim nga riciklimi dhe rikuperimi.

Mbetja është perkufizuar si një substancë ose objekt që zoteruesi e hedh ose ka ndermend ose i kërkohej ta hedhë. Një koncept i ri është prezantuar nga kjo Direktive nën “statusin e fundit të mbetjes”: një substancë ose objekt mund të mos jetë mbetje por thjesht një produkt, vetëm atëherë kur ndeshet me keto kushte:

- o Përdorimi i metejshëm i substancës ose objektit është i sigurtë;
- o Substanca ose objekti mund të përdoren direkt pa ndonjë përpunim të metejshëm
- o Substanca ose objekti konsiderohet si një pjesë e rëndësishme e procesit të prodhimit; dhe
- o Një përdorim i metejshëm është i ligjshëm, që do të thotë se një substancë ose objekt plotëson kërkesat mjedisore dhe të mbrojtjes shëndetsore të një produkti për një përdorim specifik dhe që nuk shkakton dëmim mjedisor apo të shëndetit të njeriut.

Disa mbetje mund të ndalohen se qenuri “mbetje” kur t’i jënë nënshtruar procesit të rikuperimit (që përfshin riciklimin) dhe që plotëson kriteret e duhura. Keto kritere mund të konsiderohen për grumbullimin e mbetjeve të tilla si letra, qelqi, metali, gomat dhe tekstilet. Nëse keto kritere nuk janë vendosur në nivel Komuniteti, ato mund të vendosen nga vete Shtetet Anetare.

Cdo kriter duhet të përmbushë keto kushte:

- o Substanca ose objekti përdoret për qëllime specifike;
- o ekziston në treg një kërkesë për të tilla substanca dhe objekte;
- o substanca ose objekti duhet të përmbushë cdo kërkesë teknike për qëllimet specifike dhe të gjithë standartet e aplikueshme të produkteve që ndodhen në legjislacion; dhe
- o përdorimi i substancës ose objektit nuk do të ketë ndikime negative në mjedisin dhe në shëndetin e njerëzve.

Direktiva krijon një hierarki mbi mbetjet dhe shtrën pyetje komplekse mbi procesin e transponimit të legjislacionit. Ajo ka për qëllim të përmitojë parandalimin e mbetjeve duke paraqitur programe mbi parandalimin e mbetjeve, si një instrument politik për Shtetet Anetare. Riciklimi dhe përpunimi i mbetjeve po promovohen me objektiva, si kriteret e mbledhjes së vecuar dhe efikasiteti i energjisë. Përgjegjësia e prodhuesit është rritur dhe Shtetet Anetare duhet të gjejnë një mënyrë që këto parime të transponojnë duke marrë parasysh strukturat e tyre administrative kombëtare dhe rolin e luajtur nga bashkitë/ komunitat.

Nje hierarki e mbetjeve eshte vendosur nga Direktiva si prioritet per parandalimin dhe administrimin e tyre:

1. Parandalim
2. Pergatitja per riperdorim
3. Riciklimi
4. Rikuperime te tjera, p.sh rikuperimi i energjise
5. Asgjesimi

Lista e mbetjeve (Vendimi i Listes/Katalogut te Mbetjeve 2000/532/KE, i ndryshuar) perfshin mbetjet e rrezikshme dhe merr parasysh origjinen dhe perberjen e mbetjeve. Katalogu merr parasysh cdo perqendrim vlerash, ku eshte e nevojshme. Mbetjet e Rrezikshme nuk duhet te perzihen ose te hollohen ose te klasifikohen si jo te rrezikshme.

Pergjegjesia e Prodhuesit

Masa ligjore ose jo-ligjore duhet te merren nga personat qe profesionalisht zhvillojne, prodhojne, trajtojne, shesin ose importojne produktet (prodhuesit e produkteve) dhe kane pergjegjesine e zgjeruar te prodhuesit. Keto masa mund te perfshijne pranimin e cdo produkti te kthyeshem dhe cdo mbetje qe ngelet pasi keto produkte jane perdorur, adminstrim mbetjesh dhe pergjegjesi financiare. Kjo mund te perfshije gjithashtu dhe informimin e publikut per riperdorimin dhe riciklimin.

Rikuperimi i mbetjeve

Rikuperimi është përcaktuar si çdo operacion rezultati kryesor i te cilit është riperdorimi i mbetjeve per nje qellim te dobishem duke zevendesuar materiale te tjera qe permbushin nje funksion te caktuar ose mbetje qe pergatiten per te permbushur ate funksion, ne fabrike ose ekonomi me gjeresisht.

Masa duhen ndermarre per te garantuar operacionet per rikuperimin e mbetjeve. Nese eshte e nevojshme dhe teknikisht e praktikueshme si nga ana mjedisore ashtu edhe ekonomike, mbetjet duhet te ndahen dhe mos te bashkohen me mbetje te tjera ose materiale me veti te ndryshme.

Shtojca II e Direktives Kuader mbi Mbetjet paraqet nje liste jo gjithë perfshirese mbi operacionet e rikuperimit.

Riperdorimi dhe Riciklimi

Riperdorimi eshte perkufizuar si nje operacion nga i cili produktet ose perberesit qe nuk jane mbetje perdoren perseri per te njejtin qellim per te cilin ato ishin konceptuar. Riciklimi eshte perkufizuar si cdo operacion tjeter rikuperimi nga ku mbetjet perpunohen ne produkte, material ose substanca qofte per qellimin paresor ose tjeter. Kjo perfshin riperpunimin e materialeve organike por nuk perfshin prodhimin e energjise, ose riperpunimin ne material qe do te perdoren si lende djegse.

Duhet nxitur riperdorimi i produkteve. Duhet promovuar cilesia e larte e riciklimit. Grumbullimi i ndare i mbetjeve duhet te behet aty ku eshte e mundur teknikisht, ekonomikisht, ekologjikisht dhe e pershtateshme per te permbushur standartet e domosdoshme te cilesise ne sektoret perkates te riciklimit. Kusht primar per zbatimin e gjitha niveleve te hierarkise te permendur me lart, eshte grumbullimi i ndare i mbetejeve ne burim. Riciklimi duhet te zhvillohet duke permbushur objektivat si me poshte:

1. deri ne 2015 te pakten duhen bere mbledhja e ndare per: leter, metal, plastike dhe qelq;
2. deri ne 2020 pergatitja per riperdorimin dhe riciklimin e mbetjeve te tilla si leter, metal, plastic dhe qelq nga shtepite dhe mundesisht dhe mbetje me origjina te tjera persa kohe ato jane te ngjashme me mbetjet shtepiake, do te rritet minimalisht me 50% te peshes se pergjithshme te mbetjeve;
3. deri ne 2020, pergatitja per riperdorim, riciklim dhe rikuperim i materialeve te tjera, duke perfshire operacionet per rimbushje duke perdorur mbetje per te zevendesuar materiale te tjera perfshire mbetjet nga prishjet dhe nga ndertimi qe nuk jane te rrezikshme, duke perjashtuar materialet me origjine natyrale sic jane percaktuar me kategoria 17 05 04 ne

Katalogun European mbi Mbetjet, do te rritet minimalisht deri ne 70% ne peshe.

Asgjesimi i Mbetjeve

Hierarkia e menaxhimit te mbetjeve e thekson ne menyre te qarte faktin qe asgjesimi eshte menyra e fundit per tu perdorur, dhe mund te perdoret vetem ne rastet kur menytrat e tjera te hierarkise nuk mund te jene te zbatueshme. Asgjesimi eshte faza me pak e deshirueshme e hierarkise se menaxhimit te mbetjeve per arsye se nepermjet asgjesimit humbasin vlerat e materialeve. Aty ku rikuperimi i mbetjeve nuk ka ndodhur duhet qe mbetjet t'i nenshtrohen operacioneve te sigurta te largimit dhe asgjesimit. Ky asgjesim mbetjesh duhet te behet pa demtuar shendetin e njerezve dhe ate te mjedisit. Asgjesimi eshte perkufizuar si nje operacion qe nuk eshte rikuperim edhe pse operacioni ka si nje perfundim te dyte rekuperimin e substancave ose energjise. Shtojca I e Direktives mbi Mbetjet parashton nje liste te hapur mbi operacionet e asgjesimit.

Administrimi i mbetjeve

Kostot e administrimit te mbetjeve duhet te mbuloohen nga prodhuesi i mbetjeve ose nga mbajtesi i meparshem ne perputhje me parimin ndotesi paguan. Administrimi i mbetjeve do te thote grumbullimi, transportimi, dhe asgjesimi e mbetjeve, perfshire dhe mbikeqyrjen e operacioneve te tilla si kujdesja me pas e venddepozitimeve te asgjesimit dhe veprimet e ndermarra si tregtar apo ndermjetes.

Shtetet Anetare duhet te vendosin dhe instalojne nje rrjet te integruar persa i perket grumbullimit dhe asgjesimit se mbetjeve bashkiake te perziera te cilat prodhohen nga familjet. Kjo duhet te marre ne konsiderate teknikat me te mira. Keto masa mund te merren persiper edhe ne bashkepunim me Shtetet e tjera Anetare, atu ku eshte e nevojshme dhe e keshillueshme.

Ky rrjet duhet te mundesoje qe BE-ja si nje e tere te jete e vetefinancueshme ne administrimin e mbetjeve dhe ne ndarjen e mbetjeve te perziera komunale si dhe per ti mundesuar secilit prej Shteteve Anetare levizjen drejt ketij qellimi ne menyre individuale.

Mbetjet duhet te depozitohen ne nje nga instalimet e duhura qe ndodhen me afer ne menyre qe te kete nje nivel te larte mbrojtjeje te shendetit publik dhe mjedisit.

Mbetjet e rrezikshme

Mbetja e rrezikshme eshte perkufizuar si mbetje qe paraqet nje ose me shume rreziqe te cilat jane listuar ne Shtojcen III te Direktives. Mbetjet e rrezikshme nuk duhet te perzihen me kategorit e tjera te mbetjeve te rrezikshme dhe as me mbetje te tjera, substanca apo materiale. Ky ndalim mbi perzierjen perfshin gjithashtu dhe hollimin e substancave te rrezikshme.

Per qellime te grumbullimit, transportit dhe magazinimit te perkohshem te MRr ato duhet te jene te paketuara dhe etiketuara ne perputhje me standartet nderkombetare te Komunitetit. Ajo gjithashtu duhet te shoqerohet me dokumentacionin perkatës.

Lejet dhe Regjistrimi

Cdo institucion qe merret me trajtimin e mbetjeve duhet te marri leje nga Autoritetet Kompetente. Kjo leje duhet te specifikoje, minimalisht:

- tipet dhe sasite e mbetjeve qe do te trajtohen;
- cdo tip operacioni te lejuar si dhe cdo kerkese tjeter teknike lidhur me vendin ne fjale.;
- sigurine dhe masat parandaluese qe duhet te ndermerren;
- metodat qe do te perdoren per cdo lloj operacioni;
- Monitorim dhe operacionet e kontrolli, si te jene te nevojshme
- masat e nevojshme pas mbylljes se aktivitetit

Duke iu nenshtruar ketyre konditave, cdo shtet antar mund te clirohet nga kerkesat e lejes se objekteve apo ndermarjeve ose vete rregullojne mbetjet jo te rrezikshme tek vendi i prodhimit.

Planet e menaxhimit te mbetjeve

Autoritetet kompetente te Shteteve Anetare duhet te percaktojne nje ose me shume projekte mbi administrimin e mbetjeve. Ky project ose keto projekte duhet te perfshijne te gjithe Shtetet Anetare si dhe te nxjerrin nje analize te qarte te gjendjes aktuale mbi administrimin e mbetjeve dhe sesi ky project do te mbeshtese zbatimin e Direktivave. Planet duhet te jene ne mbeshtetje me kerkesat e planifikimit te mbetjeve nga Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (MPEE), gjithashtu edhe me strategjine per reduktimin e asgjesimit ne landfill te mbetjeve te biodegradueshme.

Projekti mbi administrimin e mbetjeve duhet te perfshije te pakten:

- o nje analize mbi situaten aktuale te administrimit te mbetjeve ne Shqiperi
- o nje analize mbi masat qe duhen marre per zhvillimin ekologjik te riperdorimit, riciklimit si dhe asgjesimin e mbetjeve;
- o nje vleresim sesi Projekti do te mbeshtese zbatimin e legjislacionit mbi administrimin e mbetjeve;
- o llojin, sasine dhe burimin e mbetjeve te gjeneruar brenda Shqiperise, mbetjet qe do te dergohen nga ose ne Shqiperi, si dhe nje vleresim per zhvillimin e nivelit te mbetjeve ne te ardhmen;
- o skemat ekzistuese mbi mbledhjen e mbetjeve si dhe instalimet e medha qe ekzistojne per depozitimin e tyre, perfshire dhe vajrat e mbetura, mbetjet e rrezikshme apo edhe nivelin e mbetjeve te adresuara nga legjislacioni specific;
- o nje vleresim per skemat e reja te grumbullimit te mbetjeve, mbyllja e venddepozitimeve ekzistuese, vendosja e ndertimeve te reja dhe infrastruktures se nevojshme, investimet qe lidhen me to;
- o informacion te mjaftueshem mbi kriteret lokale per identifikim e kapaciteteve te venddepozitimeve te ardhshme dhe rehabilitimin e ketyre vendeve nese eshte e nevojshme;
- o politikat e pergjithshme mbi administrimin e mbetjeve, perfshire metodat dhe teknologjite e parashikuara ose politikat mbi mbetjet qe paraqesin probleme te caktuara ne administrim.

Duhet te vendosen programe mbi parandalimin e mbetjeve te cilat duhet te integrohen dhe te behen pjese e projekteve mbi administrimin e mbetjeve. Keto projekte dhe programe duhen rishikuar te pakten cdo gjashte vjet dhe vleresuar nese eshte e nevojshme.

Palet e interesuara, autoritetet dhe publiku duhet te kene te drejten te marrin pjese ne hartimin e ketyre projekteve dhe programeve, te cilat mund te behen publike ne websitet perkatese. Zbatimi i hierarkise se mbetjeve eshte vendimtar per qendrueshmerine afatgjate te administrimit te mbetjeve ne Shqiperi. Kjo si fillim kerkon permisimin e struktures ligjore dhe vecanerisht nepermjet zhvendosjes se mbetjeve te ngurta.

Ne praktike kjo kerkon nje nivel te larte organizimi perfshire dhe disa masa per ndarjen e mbetjeve qe ne burim si dhe kthimin e produkteve (sic eshte kerkuar nga Direktiva – 2002/96/EC Per Mbetjet nga Pasijet Elektrike dhe Elektronike), ndarjen e mbetjeve ne burim dhe pranimin e produkteve standarte per materiale te derivuara nga riperpunimi i mbetjeve (sic jane mbetjet e perpunuara nga ndertimet dhe qe mund te perdoren per ndertim rruges). Suksesi i ketij sistemi varet shume nga sjellja e individeve dhe kompanive, qe nga ana e tyre ndikohen nga demtimi i bere nga administrimi i dobet i mbetjeve dhe nga mundesite qe ekzistojne per zgjidhjen e ketyre ceshtjeve ne nje periudhe afatgjate. Zbatimi i plote i tyre do te behet per nje kohe afatmeseme nepermjet Projektit Kombetar per Mbetjet

Direktiva duhet te zbatohen nga shtetet anetare deri ne Dhjetor 2010

1.2.2 Kerkesat e Legjislacionit te BE per Rrymat e Mbetjeve

Mbetjet e Biodegradueshme

Rreziku me i madh ekologjik nga mbetjet-bio eshte prodhimi i metanit, i cili llogaritet per rreth 3% te totalit te emetimeve te gazit ne BE-15 ne 1995. Direktiva 1999/31/KE i detyron shtetet antare te reduktojne sasine e mbetjeve biodegradueshme me 35% deri ne 2016, gje qe do reduktonte mjaftueshem problemin. Prioritet per Komisionin eshte qe te sigurohet qe shtetet antare te plotesojne kete kusht ligjor ne kohe dhe plotesisht.

Shtetet antare kane nje numer mundesish qe mund ti marrin si alternative per trajtimin e mbetjeve bio duke marre ne konsiderate kushtet locale te tilla si ato klimatike qe kane te bejne ne perberjen e ketyre mbetjeve. Keto zgjedhje duhen bere ne menyre transparente, prandaj dhe Direktiva mbi Mbetjet kerkon qe shtetet antare ti perfshijne keto zgjedhje ne projektet e tyre kombetare per administrimin e mbetjeve. Kjo direktive gjithashtu kerkon qe shtetet antare te vleresojne zgjedhjet per administrimin e bio-mbetjeve qe ndihmojne ne karakterizimin e objektiveve ekologjike. Per te mbeshtetur shtetet antare ne kete detyrim ligjor, Komisioni do te mundosoje kriteret, ne formen e nje dokumenti udhezues, qe te ndihmoje ne identifikimin sa me te mire ekologjik per administrimin e mbetjeve bio te vendeve dhe rajoneve te ndryshme.

Nje opsion i mundshem eshte kompostimi i mbetjeve. Veprimet qe duhet te merren ne nivel te BE-se per te promovuar kompostimin e mbetjeve perfshijne percaktimin e standardeve te cilesis se kompostimit ne menyre qe tregjet per kompostim te mund te zhvillohen. Komisioni filloi te punoje mbi standardet ne 2007 ne menyre qe ato te jene ne dispozicion kur Direktiva mbi Mbetjet te hyje ne fuqi pas miratimit te Keshillit dhe Parlamentit Europian. Kjo do te luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar vendet anëtare për të kapërcyer një nga pengesat më të mëdha ate te politikave te kompostimit te mbetjeve, mungesen e besimit te perdoruesit dhe pranimit te tregut perdorues.

Eshtë gjithashtu e nevojshme për zhvillimin e standardeve të larta mjedisore që mund të aplikohen në objektet ku ndodh trajtimi biologjik. Kjo do të arrihet nëpërmjet shqyrtimit të ardhshëm të Direktivës mbi Parandalimin e Integruar te Ndotjes dhe Kontrollit (2008/1/KE), nën të cilat autoritetet kombëtare të japin leje për instalimet e mëdha industriale dhe bujqësore bazuar në konceptin Teknikat me te Mira te Disponueshme (TMD).

Se fundmi, Komisioni Tematik Strategjik mbi Tokat do te adresojë problemin e shterimit te karbonit ne toke, si ti shmanget atij dhe si ta sheroje ate. Kjo do te marre parasysht perdorimin e perzierjeve te mbetjeve si nje mjet per te rritur permbajtjen e karbonit ne toke.

Shteteve Antare do ti duhet pak kohe te zbatojne administrimin e shendoshe ekologjik te mbetjeve bio dhe Komisioni do te rishqyrtoje ceshtjen duke kontrolluar Strategjine Tematike mbi parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve ne 2010. Rishqyrtimi i ketij procesi do te vleresojë perparimin e Shteteve Antare dhe nevojen per masa shtese, perfshire dhe masat legjislative ne krye te masave legjislative te propozuara ne paketen e Strategjise.

Zhvillime te Reja.

Pas sigurimit të Strategjisë Tematike mbi Parandalimin dhe riciklimin e mbetjeve (COM 2005 (666) perfundimtar) në lidhje me nevojën për të adresuar standartin e nivelit të mbetjeve ne BE dhe duke iu përgjigjur thirrjes se bërë në nenin 22 të Direktivës Kuadër mbi mbetjet (2008/98/KE) kërkohet nga Komisioni te kryhet një vlerësim mbi administrimin e mbetjeve bio me qëllim dorëzimin e propozimit dhe nëse është e përshtatshme Komisioni fillon punën përgatitore për propozimin e mundshem legjislativ për mbetjet bio.

Mbetjet e gjeneruara nga ndertimet dhe shkaterrimet

Mbetjet e gjeneruara nga shkaterrimi dhe ndertimi jane identifikuar si nje prioritet nga Bashkimi Europian¹. Ka nje potencial te larte per riperdorimin dhe riciklimin e MNSH, pasi disa prej perberesve te tyre jane nje burim i dobishem. Ne vecanti ka nje treg qe merret me riperdorimin e agregateve qe rrjedhin nga MNSH neper rruge dhe nga projekte te tjera ndertimi. Per me teper teknologjia e perdorur per ndarjen dhe rigjenerimin e mbetjeve nga ndertimet dhe shkaterrimet eshte e mire vendosur dhe ne pergjithesi e lire.

Gjithsesi niveli i riciklimit dhe riperdorimit te NShM ndryshon shume (me pak se 10% dhe mbi 90%) neper Bashkim. Në disa shtete anëtare, ky lumë e mbetjesh është në një masë të madhe shkatërruese. Per më shumë, informacion rreth situatës aktuale te gjendjes në BE mund të gjendet në faqen e internetit të Qendrës Evropiane mbi Konsumin dhe Prodhimin e Qendrueshem.

Per me teper, nese keto mbetje nuk ndahen qe ne burim, MNSH mund te permbaje sasi te vogla mbetjesh te rrezikshme, perzierja e te cilave mund te jete nje rrezik per mjedisin dhe mund te pengoje riciklimin.

Nje nga objektivat e Direktives mbi Mbetjet (2008/98/KE) eshte te siguroje nje kornize per te vajtur drejt nje shoqerie recikluese Europiane me nje nivel dhe efikasitet te larte burimesh. Ne vecanti Artikulli 11.2 percakton qe "Shtetet Antare duhet te marrin masat e nevojshme te përcaktuara, qe brenda 2020 te kene arritur minimum 70% (ne peshe) te mbetjeve te gjeneruara nga ndertimi dhe shembja, duke perjashtuar materialet e percaktuara ne kategorine 17 05 04 ne Listen e Mbetjeve, duhet te pergatiten per riperdorim, riciklim ose te kalojne ndonje procedure tjeter.

Makinat ne fund te jetes (MFJ)

Makinerite jashte perdorimit jane nje ceshtje tjeter qe duhet marre ne considerate. Keto makineri permbajne nje sasi te larte substancash ndotese duke perfshire vajin, solucione dhe produkte te tjera petrolike. Edhe pse ne te gjithe Shqiperine ka objekte qe po merren me cmontimin e ketyre makinerive, shumica e tyre nuk jane te pajisura me masat e duhura parandaluese.

Direktiva MFJ (2000/53/KE) synon te zvogeloje sasine e mbetjeve te prodhuara nga makinerite (makina dhe kamione) kur ato te jene braktisur. Ne vecanti ajo perfshin shtrengimin e standarteve mjedisore per trajtimin e makinerive, si dhe qe pronaret te jene ne gjendje te caktivizojne makinerit e tyre pa pagese qe prej 2007, percakton ne rritje riperdorimin, riciklimin, rigjenerimin dhe shtrengon perdorimin e substancave te rrezikshme per makinerit e reja dhe pjeset e kembimit.

Paketimi dhe Mbetjet nga Paketimi

Direktiva (94/62/KE) mbi Paketimin dhe Mbetjet e Paketimit - "Direktiva e Paketimit" ka lidhje me minimizimin e paketimit te mbetjeve dhe promovon rigjenerimin e energjise, riperdorimin dhe riciklimin e paketimeve. Direktiva ka qellime tregtare dhe ekologjike ne te njejen kohe. Ajo percakton Kerkesat Esenciale te paketimit (te cilat duhet te merren parasysh ne hartimin dhe prodhimin e tij) dhe kufijte e paketimit te materilaleve. Direktiva e Paketimit perfshin te gjithe paketimin qe ndodhet ne tregun e BE dhe paketimin e mbetjeve qofshin ato industriale, tregtare apo shtepiake.

Synimet e Direktives jane:

- te harmonizojë masat kombetare ne menyre qe te parandaloje ose te redukoje impaktet qe ka paketimi ne mjedisin e te gjithe Shteteve Antare dhe Vendeve te Treta dhe te heqe pengesat per tregtine si dhe shtremberimin ose kufizimin e konkuresces; dhe
- te parandaloje prodhimin e mbetjeve te paketimit dhe te ule sasine e mbetjes per trajtimin final nepermjet riperdorimit, riciklimit dhe formave te tjera te rigjenerimit.

¹ Mbetjet e gjeneruara nga prishjet dhe ndertimet jane nje nga rrymat e mbetjeve me te medha dhe voluminoze ne BE. Eshte llogaritur qe 25%- 30% e mbetjeve te prodhuara ne BE perbehen nga nje numer i madh materialesh duke perfshire tulla, dru, qelq, metale, plastike, allci, asbest pjesa me e madhe e te cilave mund te riciklohet.

MNSH vijne nga veprimtari te tilla si ndertimi i infrastruktures dhe ndertesave, shkaterrimi i pjesshem ose toresor i ndertesave dhe infrastruktures civile, planifikimit dhe mirembajtjes se rrugeve. Perkufizime te ndryshme jane aplikuar neper BE gje qe e ben krahasimin te pavolitshem. Ne disa vende disa material te dala nga nivelimi i tokes konsiderohen si mbetje te shkaterrimeve dhe ndertimeve

Rikuperimi dhe riciklimi te vendosura nga Direktiva per paketimin e mbetjeve jane ripare ne 2004 dhe amenduar nga Direktiva 2004/12/KE per rritjen e objektivave te riciklimit qe duhen plotesuar nga Shtetet Antare deri ne 2008 per te:

1. rikuperuar deri ne 60% te mbetjeve te paketimit; dhe
2. minimumizuar ne 55% dhe 80% maximum i riciklimin e mbetjeve te paketimit.

Direktiva e amenduar vendos disa objektiva specifike per riciklimin te cilat bazohen ne pesha te tilla si: 60% per leter dhe karton, 60% per qelqin, 50% per metalet, 22,5 % per plastiken dhe drurin.

Vajrat e mbetura

Direktiva mbi vajrat e mbetura 75/439/KEE, ndryshuar heren e fundit nga amendamenti i Direktives mbi vajrat e mbetura 2000/76/KE eshte projektuar per te krijuar nje sistem ne harmoni per mbledhjen, ruajtjen, rikuperimin dhe asgjесimin /depozitimn e mbetjeve vajore, siç janë vajrat lubrifikant² për automjete, turbina, motore dhe vajrat hidraulike. Direktiva ka gjithashtu si qellim mbrojtjen e mjedisit kunder efekteve te demshme qe vijne si pasoje e hedhjeve ilegale dhe te perpunimeve. Eshte e rendesishme te grumbullohet sa me shume ne menyre qe mos te kete ndotje te mjedisit dhe te perfitohet sa me shume nga kjo rryme mbetjesh. Shkalla e mbledhjes ne BE15 eshte rreth 81%, por mund te permisohet edhe me tej. Per kete industrite, konsumatoret dhe ofcinat duhet te marrin pjese jo duke i hedhur keto lengje por duke i dorezuar ato tek autoritetet e caktuara qe do te ndermarrin rigjenerimin e tyre.

Sipas Direktives mbi vajrat e mbetura, ato duhet te mblidhen vecmas aty ku eshte e mundur teknikisht dhe gjithashtu te trajtohen. Mbetjet vajore nuk duhet te perzihen me mbetjet te tjera vajore ose me mbetjet te llojeve te tjera.

Mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike

Legjislacioni i BE po shtrengon perdorimin e substancave te rrezikshme tek pajisjet elektrike (Direktiva 2001/95/KE) dhe po promovon mbledhjen dhe riciklimin e ketyre pajisjeve (Direktiva 2002/96/KE) eshte ne fuqi qe prej Shkurtit te 2003. Legjislacioni parashikon krijimin e skemave të mbledhjes, ku konsumatorët kthejne mbetjet e perdorura falas. Qëllimi i këtyre skemave është rritja e riciklimit dhe / ose ri-përdorimi i produkteve të tilla. Ai kërkon gjithashtu metale të rënda si plumbi, zhiva dhe kromi qe te zevendesohen nga alternativa me te sigurta.

Pavaresisht rregullave te tilla per mbledhjen dhe riciklimin, vetem nje e treta e mbetjeve te pajisjeve elektrike dhe elektronike ne Bashkimin European eshte raportuar te jete trajtuar ne menyren e duhur dhe dy te tretat e tjera do te shkojne ne landfill-e ose do te trajtohen brenda ose jashte Bashkimit European. Synimi i mbledhjes se 4 kg per person ne vit nuk reflekton sic duhet situaten individuale te Shteteve Antare. Transportimi i mbetjeve elektrike dhe elektronike ne shtetet qe nuk jane pjese e BE vazhdon te perhapet.

Mos trajtimi i duhur i produkteve ve ne rrezik mjedisin dhe shendetin. Ne Dhjetor te 2008 Komisioni European propozoi rishikimin e direktivave per pajisjet elektrike dhe elektronike ne menyre qe te merret sa me shpejte me rritjen e ketyre mbetjeve. Synimi eshte qe te rritet sasia e mbetjeve elektrike/elektronike qe trajtohet ne menyren e duhur dhe te ulet numri i atyre qe do te groposen. Propozimet gjithashtu synojne te zvogelojne barren administrative

2 Vajrat lubrifikuese jane nje faktor i zakonshem ne ditën e perditshme, pasi ato jane te nevojshme per te vene ne levizje makinerite. BE ka konsumuar rreth 4.4 milion ton ne vit. Gjithsesi, nepermjet perdorimit te tyre, ato humbasin vetite, behen ndotese dhe arrin nje pike ku ato nuk perdoren me per qellimin e menduar. Keto vajra te perdorura zevendesohen dhe ne mbetemi me disa mbejte vajore. Rreth 50% e asaj qe eshte blere do te kthehet ne mbetje vajore. Mbetjet vajore jane mbetje te rrezikshme pasi ato shfaqin disa perberje te rrezikshme. Mbetjet vajore gjenden neper lumenj dhe liqene. Ne te vertet nje liter mbejte vajore ndot nje milion litra uje. Per me teper ndotja e rende e tokes mund te rezultojne nga mbetjet vajore qe lihen ne terren.

Komisioni ka propozuar vendosjen e objektivave të detyrueshme për mbledhjen e cilat shkojnë deri në 65% të peshës mesatare të pajisjeve elektrike dhe elektronike që kanë dalë në treg gjatë dy viteve të mëparshme në çdo Shtet Antar. Objektivat e riciklimit dhe të rikuperimit të pajisjeve të tilla tani mbulojnë riperdorimin e të gjitha pajisjeve të objektivit mbi bazë peshe do të rritet në 5%. Objektivat do të mbulojnë gjithashtu edhe pajisjet mjeksore.

Shtetet antare në të cilat konsumi i pajisjeve elektrike dhe elektronike është shumë i përhapur do të vendosin objektiva më ambicioze të cilat do të kushtezohen nga direktiva e re ndërsa të tjerët me më pak përdorim do të kenë objektiva më pak ambicioze.

Baterite dhe Akumulatorët

Legjislacioni mbi baterite (direktiva 2006/66/KE) është i aplikueshëm për të gjithë baterite dhe akumulatorët (përveç atyre që janë përdorur për çështje mbrojtje dhe interesa sigurie dhe ato që janë parashikuar për tu dërguar në hapsirë).

Direktiva synon të minimizimin e impakteve negative të baterive dhe akumulatorëve në mjedis dhe gjithashtu harmonizimin e kërkesave për funksionimin pa probleme të tregut të brendshëm. Për të arritur këto objektiva, Direktiva ka vendosur masa për të ndaluar tregtine e disa baterive që përmbajnë substanca të dëmshme. Ajo përmban masa për stabilizimin e skemave që synojnë një nivel të lartë grumbullimi dhe riciklimi baterish. Direktiva përcakton disa rregulla minimale për përgjegjësitë që ka prodhuesi në lidhje me etiketimin e baterive dhe levizshmërinë e tyre nga pajisjet.

Nenproduktet e shtazore

Nenproduktet e shtazore janë kafshët e ngordhura, pjesët e kafshëve të ngordhura ose produkteve me origjinë shtazore që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor. Kjo përfshin përdorimin e vajit të gatimit, ish-ushqimoret, mbetjet e thertores, gjak, pupla, lesh, lëkurat, kafshë shtëpiake, kopshtin zoologjik dhe kafshët e cirkut, gjuetinë, plehun organik, embrione dhe spermë.

Legjislacioni ekzistues i BE mbi nenproduktet shtazore (Norma KE/1774/2002) do të zëvendësohet nga një Normë e re KE/1069/2009 që nga Marsi 2011. Gjatë kësaj periudhe rregullat e detajuara për zbatimin e Normës së re do të pranohen.

Llumrat e kanalizimeve

Heqja e llumrave të kanalizimeve në zbatim të Direktives 91/271/KEE mbi Trajtimin e Mbetjeve Ujore Urbane po rritet në të gjithë Shtetet Antare³. Në 1992 janë tharë rreth 5.5 milion ton, ndërsa deri nga fundi i 2005 ka arritur gati në 9 milion ton. Kjo rritje vjen me shumë si pasoje e zbatimit të Direktives, rritjes së lidhjes së banesave me sistemin e kanalizimit dhe rritja e nivelit të përpunimit..

Direktiva përcakton objektivat e mëposhtme për përpunimin e llumrave që vijne nga grumbullimet:

1. jo më së vonë se deri më 31 dhjetor 2000 për aglomeratet me më shumë se 15000 PE (Ekuivalent popullsisë);
2. jo më së vonë se deri më 31 dhjetor 2005 për aglomeratet midis 10.000 dhe 15.000 PE;
3. jo më së vonë se deri më 31 dhjetor 2005 për aglomeratet e PE në mes 2000 dhe 10000 të shkarkojnë në ujërave të freskëta dhe grykderdhjet e gjera.

Ka disa masa me të rrepta për shkarkimet në zona delikate si në ujrat e freskëta apo grykderdhjet.

³ Llumi vjen nga procesi i trajtimit të mbetjeve ujore. Për shkak të proceseve fizike dhe kimike të përfshira në trajtim, ka tendenca që në llum të mbeten metale të rënda dhe të dobëta si dhe të gjehen perberës organik si viruse dhe baktere. Gjithsesi llumi përmban lende ushqyese si azoti dhe fosfori dhe lende organike që janë shumë të rëndësishme kur toka është e varferuar ose objekt i erozionit. Lendet organike dhe ato ushqyese janë dy nga elementet kryesor që e bëjnë përhapjen e kësaj lloji mbetjeje si fertilizues për tokën ose si një lende organike për tokën.

Direktiva 86/278/KEE mbi llumrat e kanalizimeve perpiqet te nxise perdorimin e ketyre ne buqesi dhe te rregulloje perdorimin e saj ne menyre te tille qe te parandaloje efektet e rrezikshme qe mund te kete ne toke, kafshe dhe nerez. Ne fund ajo ndalon perdorimin e llumrave te paperpunuar ne tokat buqesore vetem nese ajo nuk eshte e injektuar ne toke. Perpunimi i llumrave i eshte nenshtuar procesit " biologjik, kimik dhe ruajtjes se gjate ose cfaredolloj procesi tjetër aq sa con ne reduktimin e fermentimit dhe rrezikimit te shendetit". Per tju shmangur rreziqeve qe mund ti shkaktohen shendetit nga semundje shkaktuesit, llumrat nuk duhet te aplikohen kur perimet apo frutat po rriten ose jane rritur, ose te pakten 10 muaj perpara se frutat apo perimet te korren. Kafshet nuk lejohen te shkelin ne fusha te pakten deri pas tre javesh qe jane perdorur llumrat. Direktiva gjithashtu kerkon qe llumrat duhen perdorur ne menyre te tille qe te jene marre parasysh nevojat ushqyese te bimeve dhe qe cilesia e tokes dhe e siperfaqes te mos demtohet.

Direktiva thekson rregullat per monitorimin dhe analizimin e llumrave dhe tokes. Ajo thote qe duhet te mbahen shenime per sasine e llumit te prodhuar, sasine e perdorur ne buqesi, perberjen dhe permbajtjesit e llumit, tipi i perpunimit dhe vendet ku llumi eshte perdorur. Vlerat kufitare te perqendrimeve te metaleve te renda ne llumrat e destinuar per perdorim buqesor dhe ne toke jane te trajtuara ne Shtojcat I A, I B dhe I C te Direktives.

Edhe pse ne nivel Komunitar riperdorimi i llumrave arrin ne gati 40% te totalit te prodhuar, grosjsja dhe djegia ne disa Shtete Antare jane metodat me te perdoruara pavaresisht demit qe mund ti shkaktojne mjedisit.

PCB dhe PCT

Difenilet poliklorur (PCB) dhe terfenilet poliklorur (PCT) hyjne ne grupin e lendeve kimike te prodhuara nga njeriu dhe njihen si Ndots Organik te Qendrueshem. PCB/PCT⁴ jane prodhuar ne nje shkalle te gjere kombetare industriale midis viteve 1930 dhe 1980. Duke pasur parasysh stabilitetin e tyre kimik dhe rezistencen ndaj nxehtesise, ata ishin të punësuar gjerësisht si komponentë në pajisjet elektrike dhe hidraulike dhe lubrifikante.

Ato jane aplikuar ne 2 lloje te ndryshme:

- **Perdorime te mbyllura:** lëngjeve jopërçuese në pajisjet elektrike të tilla si transformatorët, kondensatorve (kondensatoreve te medhenj industrial, por edhe kondensatoreve te vegjel në aparatet elektrike shtëpiake), transferimin e nxehtesise dhe sistemet hidraulike;
- **Perdorime te hapura:** si përhapës pesticidesh, letër kopjeje prej karboni, vajra industriale, ngjyra, ngjitës, plastike si dhe për të kontrolluar pluhurin në rrugë;

Ne vitet 1970, per shkak te shqetesimeve qe kishin lidhje me helmueshmerine tek njerzitet dhe dyshimt se ishin kancerogjene vende te ndryshme kufizuan perdorimin e PCB/PCT-se, me se fundi ne 1985 perdorimi dhe tregtimi i PCB/PCT ne Komunitetin European u kufizua shume.

PCB/PCT klasifikohen si shkaktar te kancerit tek njerzitet dhe shkakut te shume efekteve te tjera te njeriu dhe kafshet, perfshire helmimin riprodhues dhe teratologjine.

Ato mund te transportohen ne distanca te largeta dhe jane zbuluar ne qoshet me te largeta te globit, perfshire dhe vendet qe jane shume larg atyre ku ato jane prodhuar apo perdorur. Ato jane zbuluar ne gjithë perberesit e mjedisit (brendshme, jashtme, ne ujrata siperfaqesore dhe nentokesore, toke dhe ushqim).

⁴ PCB/PCT-te klasifikohen si shkaktare te semundjeve kancerogjene tek njerzitet dhe prodhojne nje spekter te gjere efektesh te kunderta tek kafshet dhe njerzitet, duke perfshire helmet riprodhuese, teratogenicitet dhe imunotoksicidet.

Ata mund te transportohen ne distanca te largeta nga mjedisi dhe jane zbuluar ne vendet me te largeta te globit, duke perfshire ketu edhe vende qe ndodhen larg nga vendi ne te cilin ato jane perdorur apo prodhuar. Ato jane zbuluar ne median virtuale te mjedisit (brenda dhe jashte, ujerat siperfaqesore apo nentokesore, toka dhe ushqimi).

Direktiva 96/59/KE mbi heqjen e PCB/PCT synon te heqi komplet PCB/PCT dhe pajisjet qe permbajne PCB/PCT sa me shpejte te jete e mundur dhe per pajisjet e medha perpara fundit te 2010. Shtete antare duhet te bejne nje inventar te pajisjeve te medha qe permbajne PCB/PCT dhe duhet te miratojne nje plan per shkaterrimin e ketyre pajisjeve si dhe plane per mbledhjen dhe heqjen e pajisjeve qe nuk jane ne inventar(pajisje te vogla elektrike, shpesh te pranishme ne shtepi perpara ndalimit ne treg.)

Per me teper Komisioni ka adoptuar nje Strategji mbi PCB/PCT me qellim qe te reduktoje sa me shume te jete e mundur clirimin e ketyre substancave ne mjedis dhe futjen e tyre ne zinxhoret ushqimor.

Norma Nr 850/2004 mbi Lendet Organike Ndotese (LON) te KE vendos kufizime ne prodhimin, tregtimin dhe perdormin e LON, si dhe administrimin e mbetjeve LON. Komisioni ka bere nje studim mbi zbatimin sa me te thjeshte te masave qe ndodhen ne kete Norme.

Mbetjet Minerare

Mbetjet e nxjerra nga operacione te dala nga perpunimi i resurseve minerale, dmth mbetjet e nxjerrjeve jane nje nga burimet me te medha te mbetjeve ne BE. Ajo përfshin materiale që duhet të hiqen për të patur akses te burimet minerale, si shtresa e punueshme, mbingarkesa dhe guret qe mbeten, si dhe mbetjet qe ngelen pasi mineralet jane nxjerre nga xeherori.

Disa nga keto mbetje jane te parrezikshme keshtuqë nuk paraqesin ndonje rrezik te madhe ndotjeje per mjedisin, thjeshte mund te pengojne shtreretit e lumenjve dhe ndonje renie nese depozitohen me sasi te medha. Megjithate ato te prodhuara jo nga industria minerare metalike mund te permbajne sasi te medha substancash te demshme, si p.sh metale te renda.⁵

Nje kuader gjithepershiresë per administrimin e sigurt te mbetjeve te nxjerra nga industrite ne nivel BE eshte e perbere nga:

- Direktiva 2006/21/KE mbi administrimin e mbetjeve te nxjerra nga industrite (direktiva mbi mbejtet minerare);
- Nje Teknike me e Mire ne Dispozicion per administrimin e mbetjeve ne aktivitetet minerare; dhe
- Nje amendament i Direktives se II Seveso qe te perfshije ne te qellimet e saj perpunimin e xeheroreve dhe ne vecanti pellgjet me mbetje dhe digat e perdorura ne lidhje me perpunimin e mieraleve te tilla.

Dioksidi i Titaniumi

Dioksidi i Titaniumit eshte nje pluhur i bardhe me nje bardhesi te larte dhe te shkelqyer. Keto veti e kane bere ate nje pigment qe perdoren per nje numer te madhe funksionesh si ne piktura, objekte plastike, bojra dhe letra. Dioksidi i Titanit gjithashtu perdoret edhe per shume objekte te bardha ose produkte te ngjyrosura, perfshire ushqimin, kozmetiken, prdouktet mbrojtese me element UV, qeramike dhe produkte te gomes.

Pigmenetet e Dioksidit te Titanit jane te perbera nga dy element kimik: sulfati dhe klori Klordi prodhon produkte dioksidi titaniumi nga reaksioni i xeheroreve titanium me gazin klorhidrik. Metoda sulfate e prodhimit te dioksidit te titanit konsiston ne trajtimin e xeherorit me permbajtje titan me acidin sulfurik 70% e prodhimeve Europiane vjen nga perpunimii i sulfatit dhe 30% nga ai i klorit.

5 Nepernjete nxjerrjes dhe perpunimit minerar, metalet dhe bashkimi i metaleve priret te behen kimikisht me te disponueshem gje qe mund te coje ne prodhimin e acidit ose kullimin e alkali. Per me teper administrimi i mbetjeve mund te jete i rrezikshem pasi perfshin shpesh kimikatet e mbetura nga perpunimi dhe nivelet te larta te metaleve. Ne shume raste mbejtet ruhen ne grumbullime ose ne pellgje te medha. Shembja e digave apo grumbullimeve mund te kete pasoja te renda per mjedisin, per shendetin dhe sigurine e njeriut.5 Impakte te tjera jane humbja e produktivitetit te tokes, efektet ne ekosistem, tymrat dhe erozioni.

Keto efekte mund te lejne pasoja te qendrueshme mjedisore dhe socio-ekonomike dhe do jete shume e veshtire dhe e kushtueshme te merren masa korigjuese. Mbetjet industrial kane arsye per tu administruar si duhet për të siguruar në mënyrë të veçantë stabilitetin afatgjatë të objekteve të deponimit dhe të për të parandaluar ose minimizuar çdo ndotje te ujit dhe tokes, që rrjedhin nga ose kullimi i acidit alkali ose kullimit te metaleve te renda.

Mbetjetet qe dalin nga prodhimi i dioksidit te titanit⁶ kalojne mbetjet e ngurta, mbetjet acide te forta dhe te buta, mbetjet e neutralizuara, trajtimin e mbetjeve dhe pluhurat.

Legjislacioni i BE (Direktiva 78/176/EEC, Direktiva 82/883/EEC dhe Direktiva 92/112/EEC) mbi mbetjet e industrise se dioksidit te titaniumit ka per synim te parandaloje dhe te reduktoje ne menyre progresive ndotjen e shkaktuar nga mbetjet e industrise se dioksidit te titaniumit me qellim eleminimin e nje ndotjeje te tille. Gjithashtu synon harmonizimin e ligjeve mbi mbetjet e industrise se dioksidit te titaniumit ne menyre qe te shmange shtremberimin e konkurrences brenda tregut te brendshem.

Ndotjet Organike te Qendrueshme (NOQ)

Komuniteti nderkombetar ka kerkuar reduktimin, eleminimin, perdorimin dhe clirimin e ndotesve organike te qendrueshem (NOQ)⁷. Per ti dhene fund kesaj eshte negociuar dhe eshte arritur ne dy perfundime:

- o Protokolli rajonal UNECE i Konventes mbi ndotjen e Ajrit pertej Kufijve per NOQ u firmos ne Qershor te 1998 dhe hyri ne fuqi me 23 Tetor 2003.
- o Konventa Globale ne Stokholm per NOQ, u firmos ne Maj te 2001 dhe hyre ne fuqi ne 17 Maj 2004.

Këto instrumente krijojnë regjime strikte ndërkombëtare për listat fillestare të NOQ-ve (16 në Protokollin e UNECE dhe 12 në Konventën Stokholm). Të dy instrumentet përmbajnë gjithashtu dispozita për të përfshirë kimikate të tjera në këto lista. Ata i përcaktojnë masat e kontrollit si me poshte vijon:

- o Ndalimi ose kufizimi i produkteve ose perdorimi i NOQ-ve te prodhuara me qellim
- o Kufizimi i eksportimit dhe importimit te NOQ-ve te prodhuara qëllimisht (Konventa e Stokholmit)
- o Masa ne trajtimin e sigurte te stoqeve (Koneventa e Stokholmit)
- o Masa mbi asgjesimin e mbetjeve qe permbajne NOQ
- o Masa mbi reduktimin e rrezeve qe prodhohen ne menyre jo te qellimshme nga NOQ-te

Komuniteti European eshte i angazhuar shume seriozisht ne zbatimin e ketyre dy marreveshjeve ekologjike. Bazuar ne nje propozim te Komisionit, Parlamentit European dhe Keshillit te Rregullimit (KE) Nr. 850/2004 me 29 Prill 2004. Rregullorja e re ploteson legjislacionin e hershem te Komunitetit mbi NOQ-te dhe e radhit ate me dispozitat e marreveshjeve nderkombetare mbi NOQ-te. Rregullorja shkon me tej se marreveshja nderkombetare duke theksuar synimin qe ka per te eleminuar komplet prodhimin dhe perdorimin e NOQ-ve te njohura.

Plani i Zbatimi i Komunitetit European.

Cdo pale ne Konventen e Stokholmit, shtete te vecanta gjithashtu edhe Komuniteti European si nje organizate rajonale per zhvillimin e integruar ekonomik duhet te vendose nje Plan Zbatim per te treguar masat konkrete qe do te merren kundra NOQ-ve qe jane listuar ne Konvente. Plani i Zbatimit te Komunitetit European, qe ploteson planet kombetare te Shteteve Antare te BE, u miratua me 9 Mars 2007

⁷ Pigmenti I dioksidit te titaniumit (TiO₂) eshte nje puder e bardhe me nje aftesi te madhe dhe nje bardhesi te shkelqyer. Keto karakteristika e kane bere ate nje pigment me vlerë dhe qe perdoret per lysterje, per te shkruar ne materiale plastike, bojra dhe leter. Dioksidi I titaniumit perdoret gjithashtu edhe ne shume produkte te bardha dhe me ngjyre duke perfshire ushqimin, kosmetiken, produktet e mbrojtjes se lekures, ceramike dhe produktet e gomes. Pigmentet e dioksidit te titaniumit jane prodhuar me ane te dy proceseve kimike: procesin e sulfatit ose te klorit. Procesi klorit prodhon produkte te dioksidit te titaniumit nepemjet reaksionit te xeherorit me gazin klorik. Procesi i sulfatit prodhon produkte te dioksidit te titaniumit nepemjet reaksionit te xeherorit te titaniumit me acidin sulfurik. 70% e produkteve Europiane jane perftuar nga procesi i sulfatit dhe 30% nga procesi i klorit.

⁷ Ndotjet e Perhershme Organike (NOP) jane substanca kimike qe ndodhen ne mjedis, qe grumbullohen nepermjet rrejetit ushqimor dhe perbejne nje rrezik per shendetin e njeriut dhe mjedisit. Ky lloj grupi mbetjesh perbehet nga pesticide, kimikate industrial si PCB-ja dhe nga produktet e proceseve industrial si dioksina. NOP transportohen pertej kufijeve nderkombetar, larg prej burimeve te tyre, madje dhe ne rajone qe nuk i kane perdorur apo prodhuar ndonjehere. Ekosistemet dhe popujt indigjen te Artikës jane vecanerisht ne rrezik prej transportimit dhe akumulimit te ketyre substancave. Rrjedhimisht NOP vene ne rrezik mjedisin dhe shendetin e njeriut ne te gjithë rruzullin.

Identifikimi i metejshem i NOQ.

Te dy marreveshjet nderkombetare mbi NOQ perfshijne masa per shtimin e substancave qe paraqesin karakteristikat e NOQ ne Shtojcat teknike. Komisioni, sebashku me Shtetet Antare po promovon dhe mbeshtet aksionin per identifikimin e metjeshen te NOQ si dhe te nxisi aksionin kontrollues nderkombetar

Poliklorur vinili

PVC ka qene ne qender te debatit gati ne pjesen me te madhe gjate dy dekadave te fundit. Shume opinion shkencore, teknike dhe ekonomike jane dhene ne lidhje ne PVC dhe efektet e saj ne shendetin e njeriut dhe mjedisin. Disa Shtete Antare kane rekomanduar ose kane marre masa per disa aspekte te ciklit te jetes se PVC. Me qellim per te vleresuar te gjithë ciklin e jetës së PVC dhe ndikimit të tij të mundshem në shëndetin e njeriut dhe mjedisit si dhe funksionimin e rregullt të tregut të brendshëm, Komisioni ka kryer disa studime dhe lëshoi një Liste te Gjëlber për Çështjet Mjedisore te PVC.

Substancat Holluese te Ozonit

BE ka aprovuar legjislacionin specifik (Rregulloren EC/2037/2000 mbi substancat qe hollojne shtresen e ozonit) me qellim parandalimin e shpërhapjes se substancave ozon holluese dhe promovimin e rikuperimit pas perdorimit ne proceset industriale, edhe pse ky proces nuk kryhet ne produktet e prodhuara.

1.3 Rritja e gjenerimit te mbetjeve

Nje nga problemet madhore qe ndeshet kur hartohet strategjia apo planifikimi i menaxhimit te mbetjeve eshte aksesin per te siguruar informacion te sakte dhe te perditesuar ne te cilin te bazohen kerkesat e planifikimit dhe te burimeve per te ardhmen.

Kjo ceshtje ka qene nje problem per Shqiperine si ne te shkuaren ashtu edhe ne ditet e sotme. Projekti INPAEL ka kryer nje studim per te vleresuar sasine dhe perberjen e mbetjeve bashkiake ne Shqiperi, ne menyre qe te hartojte nje strategji dhe plan te vlefshem.

Nga ky studim jane percaktuar pesha dhe perberja e rrymave te mbetjeve te cilat bejne pjese ne mbetjet bashkiake si vijon: mbetjet organike, derrase, leter, karton, plastike me densitet te ulet, plastike me densitet te larte, qelq, tekstile, metale me ngjyre, metale pa ngjyre, mbetje spitalore, gome, inerte, mbetje nga materiale sanitare, mbetje nga pajisje elektrike dhe elektronike MPEE, baterite dhe mbetje nga produkte shtazore.

Rritja e numrit te popullsise me ritme te larta dhe perqindja e larte e migrimit drejt qyteteve me shume te zhvilluara ka ndikuar shume ne rritjen e prodhimit te mbetjeve, dhe ne vecanti te mbetjeve inerte, si rrjedhoje e ndertimeve te shumta te ndertesave te reja, si dhe te shkaterrimeve te ndertesave te vjetra. Megjithate duke u bazuar ne informacionin ne sasine e prodhimit te mbetjeve (per Tiranen, Durresin, Fierin dhe Shkodren) vihet re se Shqiperia prodhon gati gjysmen e sasise mesatare per fryme te vendeve qe bejne pjese ne Organizaten per Bashkepunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe krahasuar me vendet e tjera te OECD-se pjesa me e madhe e mbetjeve te prodhuara jane mbetje organike.

Tabela e meposhtme paraqet rezultatet e studimit te permendur me lart.

Nr i Zonave te mbetjeve	Qytetet	Banoret	Gjenerimi i mbetjeve per kg/person/dite	Prodhimi i mbetjeve ne (Dite)	Gjenerimi i mbetjeve per kg/person/vit	Prodhimi i mbetjeve ne(Vit)	Pesha mesatare e mbetjeve ne nje kontenier per nre konteniereve	Kontenieret grumbulles te mbetjeve	Vol. I kontenierve per liter	Frekuenca e mbledhjes	Amplitude e zgjedhjes se popullsise	Koeficienti i mbetjeve ne kg per person ne dite
											Komunat rurale	0.4
8	Erseke	2,956	0.7	2	247	730	36 x 124kg	36	1,100	3 x ëeek	< 25,000 banore	0.7
4	Koplik	3,569	0.6	2	205	730	80 x 124kg	80	1,100	javore		
6	Klos	4,344	0.7	3	252	1,095	20 x 124kg	20	1,100	Ditore		
3	Rreshen	4,498	1.1	5	406	1,825	53 x 112kg	53	1,000	Ditore		
8	Bilisht	7,966	0.6	5	229	1,825	40 x 124kg	40	1,100	Ditore		
4	Vau Dejes	10,240	0.3	3	107	1,095	22 x 124kg	22	1,100	Ditore		
2	Fushe-Kruje	12,154	0.6	7	210	2,555	52 x 124kg	52	1,100	Ditore		
1	Vore	16,350	0.6	10	223	3,650	120 x 124kg	120	1,100	40% Ditore 60 % dita e 2 ^{te}		
3	Lezhe	21,150	1.1	24	414	8,760	150 x 124kg 50 x 338kg	200	150 x 1100L 50 x 3000L	Ditor 150 & 2 x javor 50		
8	Pogradec	27,104	0.7	19	256	6,935	150 x 124kg	150	1,100	Ditore	>25,000 por < 100,000 banore	1.0
1	Kavaje	28,193	0.9	24	311	8,760	195 x 124kg	195	1,100	Ditore		
12	Lushnje	29,649	1.4	41	505	14,965	331 x 124kg	331	1,100	Ditore		
9	Berat	36,354	0.9	34	341	12,410	270 x 124kg	270	1,100	Ditore		
12	Fier	51,773	1.3	66	465	24,090	530 x 124kg	530	1,100	Ditore		
8	Korce	56,593	0.9	50	322	18,250	400 x 124kg	400	1,100	Ditore		
4	Shkoder	75,097	0.9	71	345	25,915	575 x 124kg	575	1,100	Ditore		
7	Elbasan	78,446	1.1	88	409	32,120	350 x 124kg 250 x 180kg	350 250	1,100 1,600	Ditore		
2	Durres	127,851	1.1	136	388	49,640	1,100 x 124kg	1,100	1,100	Ditore	>100,000 por < 200,000 banore	1.1
1	Tirane	468,718	1.5	703	547	256,595	3215 x 192kg 255 x 271kg 48 x 361kg	3,518	3215 x 1700L 255 x 2400L 48 x 3200L	Ditore	> 200,000 por < 750,000 banore	1.5

Në kushtet e peshës së përgjithshme dhe bazuar në shifrat e INSTAT-in 2009 për popullsinë, 3,2 milion banorë, prodhimi i mbetjeve bashkiake në Shqipëri është i barabartë me një prodhim vjetor të mbetjeve që shkon deri në 852.360 ton në Shqipëri, bazuar në një mesatare prej 0,7 kg për person në ditë.

Te dhënat janë zbatuar në secilin bashki të Shqipërisë dhe tabela e mëposhtme ilustron shifrat Kombëtare për shqiptarët në nivelin bashkiak dhe bazuar në sektoret e zonave të mbetjeve.

Tabela: Zonat e mbetjeve- Shqipëri

Zona e mbetjeve/ Bashkia	Rregjistrimi i përgjithshëm në pop. 2001	Banorët e Pop. 2009	Prodhimi i mbetjeve/ person/ditë	Tonet për ditë	Tonet për Vit
Zona e mbetjeve 1					
Tiranë	341,453	468,718	1.5	703	256,623
Kamëz	44,443	59,952	1.0	60	21,882
Vorë	12,885	16,350	0.7	11	4,177
Kavajë	24,776	28,193	1.0	28	10,290
Rrogozhinë	7,071	9,398	0.7	7	2,401
Komunat	167,298	217,439	0.4	87	31,746
Zona e mbetjeve 2					
Durrës	98,792	127,851	1.0	128	50,735
Shijak	8,097	7,892	0.7	6	2,016
Manëz	7,587	6,314	0.7	4	1,613
Sukth	13,093	15,784	0.7	11	4,033
Krujë	13,075	8,102	0.7	6	2,070
Fushë Krujë	18,441	12,154	0.7	9	3,105
Komunat	86,084	132,286	0.4	53	19,314
Zona e mbetjeve 3					
Lezhë	14,420	21,150	0.7	15	5,404
Rreshen	11,447	4,498	0.7	3	1,149
Rubik	6,842	2,215	0.7	2	566
Lac	19,964	12,988	0.7	9	3,318
Mamurras	17,676	9,798	0.7	7	2,503
Komunat	86,138	108,122	0.4	43	15,786
Zona e mbetjeve 4					
Koplik	3,126	3,569	0.7	2	912
Shkodër	83,273	75,097	1.0	75	27,410
Vau Dejës	9,430	10,240	0.7	7	2,616
Pukë	4,579	2,735	0.7	2	1,460
Fushë Arrez	4,090	3,342	0.7	2	1,825
Komunat	148,158	150,986	0.4	60	22,044
Zona e mbetjeve 5					
Kukës	17,157	10,595	0.7	7	2,707
Krume	6,378	3,146	0.7	2	804
Bajram Curri	6,546	4,456	0.7	3	1,139
Komunat	81,312	61,077	0.4	24	8,917
Zona e mbetjeve 6					
Pershkopi	14,017	12,341	0.7	9	3,153
Burrël	12,123	7,087	0.7	5	1,811
Klos	10,489	4,344	0.7	3	1,110
Bulqizë	10,454	1,966	0.7	1	502
Komunat	142,771	114,272	0.4	46	16,684
Zona e mbetjeve 7					
Elbasan	86,148	78,446	1.0	78	28,633
Cërrik	9,406	9,806	0.7	7	2,505

Belsh	12,162	9,806	0.7	7	2,505
Peqin	7,267	6,740	0.7	5	1,722
Gramsh	10,533	9,323	0.7	7	2,382
Librazhd	7,216	6,291	0.7	4	1,607
Prrenjas	6,643	4,746	0.7	3	1,213
Komunat	223,954	217,832	0.4	87	31,803
Zona e mbetjeve 8					
Korce	55,017	56,593	1.0	57	20,656
Maliq	5,655	4,921	0.7	3	1,257
Pogradec	23,762	27,104	1.0	27	9,893
Billisht	6,729	7,966	0.7	6	2,035
Leskovik	2,848	2,674	0.7	2	683
Erseke	5,499	2,956	0.7	2	755
Communes	159,079	153,859	0.4	62	22,463

Table: Zonat e mbetjeve- Shqiperi

Ëaste Area/ Municipality	Pop 2001 Census	Pop 2009 Resident	Ëaste generation/ person/day	Tonnes per Day	Tonnes per Year
Zona e mbetjeve 9					
Berat	44,040	36,354	1.0	36	13,269
Ure Vajgurore	9,181	6,925	0.7	5	1,769
Kucove	18,038	16,756	0.7	12	4,281
Corovode	6,755	4,330	0.7	3	1,106
Polican	6,623	5,293	0.7	4	1,352
Komunat	108,383	101,125	0.4	40	14,764
Zona e mbetjeve 10					
Gjirokaster	20,601	19,357	0.7	14	4,946
Libihove	2,317	4,249	0.7	3	1,086
Permet	7,726	6,510	0.7	5	1,663
Kelcyre	3,419	3,064	0.7	2	783
Tepelene	6,539	4,926	0.7	3	1,259
Memaliaj	4,748	4,547	0.7	3	1,162
Komunat	67,478	59,858	0.4	24	8,739
ZONA E MBETJEVE 11					
Vlore	77,652	97,729	1.0	98	35,671
Himare	3,278	9,535	0.7	7	2,436
Orikum	6,376	7,151	0.7	5	1,827
Selenice	3,949	4,767	0.7	3	1,218
Delvine	6,421	4,061	0.7	3	1,038
Sarande	15,247	20,095	0.7	14	5,134
Konispol	2,230	1,513	0.7	1	387
Komunat	77,829	66,844	0.4	27	9,759
ZONA E MBETJEVE 12					
Fier	56,164	51,773	1.0	52	18,897
Patos	21,812	19,795	0.7	14	5,058
Roskovec	5,939	4,568	0.7	3	1,167
Lushnje	37,860	29,649	1.0	30	10,822
Divjake	10,916	7,412	0.7	5	1,894
Ballsh	9,154	7,875	0.7	6	2,012
Komunat	240,702	252,863	0.4	101	36,918

Ne vijim te llogaritjes se sasise se mbetjeve bashkiake te prodhuara ne Shqiperi, perberesi tjetër i studimit ishte llogaritja e sasise se 17 llojeve specifike te mbetjeve prezente ne mbetjet bashkiake ne Shqiperi. Keshtu, studimi ka matur llojet e 17 mbetjeve ne bashkite kryesore per secilen nga pikat e percaktuara ne studim.

Perqindja e shifrave te pergjithshme te perdorura ne tabelen e mesiperme rrjedhin nga nje mesatare e perqindjes se shifrave te studimit qe jane nenvizuar ne tabelen me poshte.

Derdhja e Mbetjeve	Tirane %	Vore %	Durres %	Fushe Kruje %	Shkoder %	Lezhe %	Berat %	Lushnje %	Kombetar %
Organike	45.2	51.7	46.5	52.3	45.4	45.3	47.1	49.9	47.36
Druri	1.6	0.9	1.0	3.3	1.5	1.3	0.3	1.3	1.43
Letre	6.7	3.6	6.4	4.9	5.1	5.4	6.2	4.1	5.37
Kartoni	10.6	9.3	9.0	5.2	8.3	8.6	6.8	8.3	8.13
LD-Plastike	6.9	6.2	8.0	6.9	10.7	9.8	9.0	10.9	8.46
HD-Plastike	6.2	4.4	6.9	4.6	3.5	5.6	5.0	4.1	4.75
Qelqi	5.0	4.7	5.5	5.0	5.4	6.4	6.5	2.2	5.75
Tekstile	6.0	5.4	3.7	4.6	5.1	5.0	6.9	6.9	5.27
Metale –Ferrore	0.7	0.8	0.8	0.6	0.5	0.7	0.5	0.20	0.56
Metale me Ngjyra	0.5	0.4	0.5	1.0	0.5	0.6	0.5	0.4	0.57
Prodhime Spitali	0.2	0.06	0.1	0.2	0.1	0.6	0.07	0.1	0.17
Produkte Kaucuku	0.5	0.2	1.1	0.07	0.3	0.3	0.05	0.06	0.2
Inerte	5.3	6.1	4.2	7.2	7.7	4.9	6.7	5.9	7.20
Mbetje sanitare	3.5	3.3	3.3	2.5	4.3	4.0	3.1	4.5	3.25
MPEE	0.3	0.2	1.2	0.3	0.50	0.07	0.10	0.09	0.31
Baterite	0.04	0.02	0.3	0.04	0.03	0.01	0.01	0.02	0.02
Prodhime nga Kafshet	0.8	3.0	1.6	2.1	1.14	1.5	1.4	1.0	1.08

Tabela e meposhtme ilustron sasite kombetare te llojeve te mesiperme te mbetjeve te prodhuara ne Shqiperi, mbi bazen e zbatimit te perqindjes mesatare te shifrave krahasuar me totalin e shifrave te pergjithshme per mbetjet bashkiake per Shqiperine. Ky informacion i detajuar eshte vecanerisht i dobishem per qeverine qendrore dhe qeverisjen vendore ne interes te planifikimit per objektivat specifike te zhvendosjes se llojeve te mbetjeve.

Rrymat e Mbetjeve	% Mesatare në Hedhjen e Mbetjeve Bashkiake	Pasha e Mbetjeve Bashkiake te Shqiperise/dite (0.7kg/person/dite)	Pasha e Mbetjeve Bashkiake te Shqiperise/vit (266kg/person/vit)
		2,335 T/Ditë	852,360 T/vit
Organike	47.36	1,106	403,690
Druri	1.43	33	12,045
Letre	5.37	125	45,625
Kartoni	8.13	190	69,350
Total i mbetjeve te Biodegradueshme	62.3	1,454	530,710
LD Plastike	8.46	198	72,270

HD Plastike	4.75	111	40,515
Qelqi	5.75	134	48,910
Tekstile	5.27	123	44,895
Metale – Ferrere	0.56	13	4,745
Metale- Me ngjyra	0.57	13	4,745
Mbetjet Spitalore	0.17	4	1,460
Produkte Kaucuku	0.2	5	1,825
Mbetje Inerte	7.20	168	61,320
Mbetje sanitare	3.25	76	27,740
MPEE	0.31	7	2,555
Bateritë	0.02	1	365
Prodhime të Mbetjeve Kafshët nga	1.08	25	9,125

1.4 GJENDJA AKTUALE E INVESTIMEVE

Legjislacioni i menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri nuk është mbështetur nga një infrastrukturë e pershtatshme. Vihet re një mungesë financimi, planifikimi dhe kapaciteti teknik brenda sektorit dhe si rrjedhojë vetëm një pjesë shumë e vogël e shërbimit ofrohet siç është grumbullimi dhe hedhja në vendin e grumbullimit të mbetjeve.

Përgjegjës për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve urbane është Autoriteti Lokal. Shumë prej tyre kanë nënshkruar kontrata me kompani për grumbullimin dhe largimin e mbetjeve. Shpesh vihet re mungesa e kontenierëve dhe zakonisht janë në gjendje shumë të keqe. Frekuenca e grumbullimit të mbetjeve dhe koha e qëndrimit të tyre në konteniere ndryshon shumë.

Problemet që dalin me sistemin aktual të menaxhimit të mbetjeve përfshijnë:

- Standarte të dobëta të makinave;
- Gjendje e keqe e kontenierëve;
- Grumbullim jo i shpeshtë mbetjeve dhe si rrjedhojë kontenieret mbushen me tepër sec duhet, dhe;
- Mbetje nëpër rrugë që shkaktojnë erera të pakëndshme dhe probleme me shëndetin.

Në Komunitet e vogla dhe në zonat rurale nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të mbetjeve dhe individët janë përgjegjës për largimin dhe asgjësimin e mbetjeve të tyre. Si rrjedhojë mbetjet shpesh hidhen anash rrugës ose digjen në zone të hapura. Mbetjet urbane shpesh asgjësohen në një landfill të caktuar por një sasi e konsiderueshme hidhen gjithashtu në zona të paautorizuara, në afërsi të vendbanimeve apo përgjatë rrugës.

Para se të grumbullohen mbetjet nuk ndahen as nga familjet as nga bizneset. Megjithatë, në qytetet me të madha bëhet grumbullimi dhe ndarja informale e mbetjeve me qëllim riciklimin, nga grupe që kërkojnë nëpër mbetjet e hedhura në rrugë për kanacet e aluminit të cilat me pas shiten për tu ricikluar. Procesi tjetër riciklimi bëhet edhe në vende asgjësimi ku grupe të paautorizuara kërkojnë për metal, plastike, leter dhe dru.

Në rastet me të shumta, vendet e caktuara për asgjësimin nuk janë projektuar apo menaxhuar mirë. Ato janë ndërtuar pa pasur infrastrukturën e nevojshme apo pajisjet inxhinierike siç janë sistemet e kullimit të liksiviateve dhe të gazrave të landfillit. Shumë prej vendeve të grumbullimit nuk janë të sigurt dhe janë të pajisura me pajisje jo të pershtatshme për menaxhimin siç është një zyre, stafi, peshorja, vendi për larjen e makinave apo ndricimi. Si rrjedhojë, të gjithë kanë akses dhe hedhin mbetje pa pasur autorizim, ashtu sikurse mund të marrin zjarr shumë lehtësisht. Inspektimi i mbetjeve në hyrje nuk është një praktikë e zakonshme dhe nuk mbahet një regjistër i depozitimeve.

Asgjesimi i pa autorizuar eshte nje procedure e zakonshme ne toke dhe ne rrjedhat e ujit, vecanerisht ne afersi te vendbanimeve te vogla. Materialet shpesh lahen ne rrjedhat e ujit apo hidhen ne mjedis duke infektuar keshtu token dhe rrjedhen e ujit.

Per asgjesimin e mbetjeve urbane nuk ka asnje impiant incinerimi te licensuar. Megjithate eshte procedure e zakonshme per mbetjet shtepiake dhe mbetje te tjera te digjen ne vend te hapur, duke nxjerre keshtu gaze toksike dhe tym te zi. Disa rryma mbetjesh, duke perfshire ketu edhe mbetjet e gomave dhe te drurit digjen ne furrat e gurteve gelqerore, duke cliruar dioxine dhe ndotes te tjere.

Niveli i demit mjedisor te shkakuar nga keto probleme eshte shume i larte. Megjithate edhe kostot per permiresimin e ketyre demeve jane shume te larta.

Ne ditet e sotme, investimi ne kete sektor eshte shume i limituar. Pergjegjesia per sigurimin e ketyre infrastrukturave nga autoritetet lokale (bashkite dhe komunat) eshte duke u zhvilluar nga MPPTT.

Programi aktual i shpenzimeve kapitale i Ministrise per menaxhimin e mbetjeve eshte relativisht i ulet ne krahasim me ate qe ne te vertete do te duhej per te permbushur investimet e nevojshme ne Shqiperi. Gjithashtu autoritetet lokale nuk jane ne gjendje te sigurojne fondet e nevojshme per investim. Pervec mungeses se sigurise financiare, autoritetet lokale kane gjithashtu probleme teknike dhe administrative gje qe e ben te veshtire zhvillimin e infrastrukturës se sherbimeve te nevojshme. Ne vecanti, huate ose grantet nga donatoret nderkombetare nuk jane mundesi reale per shume autoritete, duke qene se autonomia e tyre financiare apo e te ardhurave shpesh nuk eshte e mjaftueshme per ti lejuar ata te bejne nje oferte. Per me teper ne shume raste, struktura manaxheriale per te administruar huate dhe infrastrukturen nuk eshte ne nivelin e duhur.

Keto probleme duhet te zgjidhen ne menyre qe te gjendet financimi i nevojshem per te mbeshtetur nivelin e duhur te zhvillimit te infrastrukturës. Nje element kyç ne zhvillimin e ketij kapaciteti eshte nje Fond Mjedisor, i cili duhet te vendoset ne nje linje me Programin e Qeverise. Ky Fond duhet te financoje projektet per investimet mjedisore. Parashikohet qe Fondi Mjedisor do te drejtoje investimet nen kompetencen e disa ministrive, duke perfshire aktivitetet si menaxhimin e mbetjeve te ngurta, trajtimin dhe grumbullimin e ujerave te ndotura dhe investime te tjera per mbrojtjen e mjedisit.

1.5 Rolet dhe Përgjegjësitë

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU) është institucioni kryesor i përfshirë në menaxhimin dhe politiken e mbetjeve. Ajo është përgjegjëse për formulimin e strategjisë, hartimin e legjislacionit, përgatitjen e projektit, përgatitjen e lejeve për nënshkrimet e ministrit, për inspektimet qendrore, dhe zbatimin. Bashkë me agjencitë rajonale dhe Inspektoratin e Mjedisit është përgjegjëse për ngritjen e një sistemi mbi menaxhimin e mbetjeve dhe monitorimin e zbatimit të tij në të gjitha nivelet dhe fazat (Neni 5, ligji nr. 9010).

Ministria:

- Harton rregullat/ligjet për menaxhimin e mbetjeve për të gjitha fazat (ndarja, ripërdorimi, riciklimi, kompostimi, hedhja, djegia (neni 11 i ligjit nr. 9010) duke ndjekur teknikat standarde dhe udhëzimet për mbetjet e rrezikshme (neni 26 & 27 i ligjit nr. 9537);
- Jep lejet për mbetjet (neni 25 i ligjit nr.9010) dhe i ndryshon ose i pezullon ato, (neni 17 i ligjit nr. 9537); vlereson dhe jep lejet tranzite për transportimin e mbetjeve (neni 27&28 i ligjit nr.9010); jep leje për mbetjet e rrezikshme (neni 21 i ligjit nr. 9537); harton lejet për importin e mbetjeve (çka më vonë duhet të miratohet edhe nga Këshilli i Ministrave);
- Vendos rregullat për monitorimin dhe inspektimin/kontrollin për zbatimin e akteve lidhur me mbetjet (neni 30 i ligjit nr. 9010);

- Organizon dhe manaxhon regjistrat lidhur me çështje të ndryshme të mbetjeve, si lejet e mbetjeve (neni 45/1 i ligjit nr. 9890); vendet për mbetjet e rrezikshme; agjentët dhe shitjet e mbetjeve të rrezikshme (neni 11 i ligjit nr. 9537); mjetet e transportit lidhur me transportimin e mbetjeve të rrezikshme (neni 10 i ligjit nr. 9537); lejet për mbetjet e rrezikshme (neni 18 i ligjit nr. 9537);

Rrjeti i Agjencive Mjedisore (RAM) është pjesë e MMPAU-së, e specializuar në monitorimin dhe mbrojtjen e mjedisit. RAM-i përbëhet nga Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve (AMP) si organi qendror i saj dhe nga dymbëdhjetë Agjenci Rajonale të Mjedisit (ARM) të cilat punojnë në nivel rajonal. RAM-i është në përgjegjësinë e ministrit. AMP-ja ka një sektor për Metalet e Rënda dhe Mbetjet. Thelbi i punës së saj është mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i tyre.

ARM-të mbajnë regjistrin e lejeve për territorin në juridiksionin e tyre (neni 14 i ligjit nr. 9890). Ato janë të përfshira edhe në miratimin e mbledhjes së vendeve të mbetjeve (neni 34 i ligjit nr. 8405) dhe punon në bashkëpunim me autoritetet lokale qeverisëse për dhënien e lejeve mjedisore për objektet lokale të mbetjeve (neni 25/2 i ligjit nr. 9010).

Inspektorati i Mjedisit (IM), si pjesë e MMPAU-së është një organ i specializuar në kontrollin dhe forcimin e ligjeve mjedisore (neni 20 i ligjit nr. 8990); ai vendos gjoba për shkeljet administrative (neni 84 i ligjit nr. 8934); pezullon ose mbyll përfundimisht aktivitetet që nuk zbatojnë ligjet e mjedisit (neni 86 i ligjit nr. 8934); ndihmon personat fizikë dhe juridikë të kryejnë vetë-monitorimin dhe zbatimin e sistemeve të integruara të menaxhimit; informon rregullisht autoritetet për gjendjen e mjedisit, për aktivitetet e miratuara, projektet dhe instalimet; kontrollon regjistrat e ndotësve, rregullat e brendshme teknike dhe teknologjike dhe dokumente të tjera të lidhur me aktivitetin dhe rreziqet e ndotjes; publikon rezultatet e çdo kontrolli (neni 71 i ligjit nr. 8934).

Inspektorati i Mjedisit bashkëpunon me inspektoratet e tjerë për të kryer detyrat e tyre (Inspektoratin Shtetëror të Shëndetit, Policinë Ndërtimore, Policinë Bashkiake, etj.)

Ministritë e tjera, institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, bashkë me MMPAU-në, kanë detyrat e mëposhtëme: hartojnë metodologjitë për trajtimin e mbetjeve mjedisore në përputhje me llojin dhe natyrën e mbetjes; vënë në dispozicion dhe sigurojnë përdorimin efikas të burimeve financiare; monitorojnë dhe kontrollojnë vazhdimisht aktivitetet që prodhojnë mbetje; kontrollon te ngarkuarit për transportimin, riciklimin, përpunimin dhe depozitimin e mbetjeve në zonat nën juridiksionin e tyre (neni 5 i ligjit nr. 9010). Ligji nr. 9010 bën përgjegjës një numër aktorësh, të bashkëpunojnë me MMPAU-në për të hartuar dhe miratuar rregullat specifike mbi menaxhimin e mbetjeve.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) ka për detyrë të formulojë, zbatojë dhe monitorojë politikat kombëtare, normat dhe standardet në ... shërbimet publike... duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe promovimin e investimeve private dhe rritjen ekonomike...

Bashkë me MMPAU-në, ajo ka për detyrë të hartojë rregullat në:

- Menaxhimin e mbetjeve të ngurta (neni 12 i ligjit nr. 9010). Rregulli për mbetjet e ngurta (nr.1, dt.30.03.2007) është miratuar bashkarisht nga ministri i MPAU-së dhe nga ministri i PPTT. MPPTT-ja është përveç autoriteteve të tjera, përgjegjëse për zbatimin e tyre.
- Rregulloren për menaxhimin e mbetjeve masive (voluminoze) (neni 17 i ligjit nr. 9010). Kjo nuk është hartuar ende.
- Menaxhimin e mbetjeve ndërkufitare (neni 19 i ligjit nr. 9010). Nuk është hartuar ende.

Në përmbushje të misionit të saj MPPTT është autoriteti kontraktues për koncesionet e aktiviteteve ekonomike nën përgjegjësinë e saj (duke përfshirë edhe fushën e shërbimeve publike, pra edhe të menaxhimit të mbetjeve, gjithashtu), pra edhe për projektet me koncesion të mbetjeve (neni 5 i ligji nr. 9663). Kjo duhet të vendoset nga Këshilli i Ministrave (neni 5 i ligjit nr. 9663). MPPTT, në bashkëpunim me Njësinë e Koncesionit, bën identifikimin e koncesioneve të mundshme dhe vlerëson efikasitetin e tyre dhe përshtatshmërinë e kostos financiare në mënyrë që të gjykohet mbi zbatimin ose jo të koncesioneve të caktuara.

MPPTT organizon tenderat për identifikimin e ofruesve të përshtatshëm për të zbatuar koncesionin dhe negociacion kushtet e koncesionit dhe nën rrethana të caktuara mund të mbyllë marrëveshjen koncesionare (nenet 11, 15, 16, 20, 21, 28 të ligjit nr. 9663).

Inspektoriati Ndërtimor dhe Urbanistik Kombëtar (në varësi të MPPTT) është përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin e zbatimit të kësaj rregulloreje për mbetjet e ngurta bashkë me inspektorate të tjera si Inspektorati i Mjedisit apo Inspektorati i Shëndetsor.

Këshilli Kombëtar për Rregullimin e Territorit miraton lejet e vendeve të ndërtimit për çdo lloj objekti (gjithashtu edhe për landfillet) me një sipërfaqe më të madhe se 0.5 ha, që janë për t'u ndërtuar jashtë kufijve administrative të qyteteve/fshatrave/zonave të pabanuara (neni 9 i ligjit nr. 8405).

Ministria e Shëndetësisë (MSH), bashkë me MMPAU-në ka përgjegjësi për të hartuar rregulloret në:

- Nivele të ndryshme të hierarkisë së menaxhimit të mbetjeve (neni 11 i ligjit nr. 9010), ashtu si për
- Menaxhimin e mbetjeve shëndetësore (neni 18 i ligjit nr. 9010). Rregullorja "Mbi menaxhimin e mbetjeve shëndetësore" është miratuar bashkarisht (nr.6, dt.30.11.2007). MSH ka në përgjegjësi ta zbatojë atë.
- Menaxhimin e mbetjeve ndër-kufitare (neni 19 i ligjit nr. 9010). Kjo nuk është hartuar ende.

Spitalet dhe të gjithë gjeneruesit e mbetjeve shëndetësore kanë përgjegjësi të hartojnë dhe azhurnojnë Planet e tyre të Menaxhimit të Mbetjeve, në përputhje me Planet Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Planet e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit bashkëpunon me Inspektoratin e Mjedisit, dhe në raste të veçanta me inspektoratet e tjera, për të kryer aktivitete të lidhura me inspektimin e mbetjeve. Ajo përfshihet edhe në miratimin e vendeve të grumbullimit të mbetjeve (neni 34 i ligjit nr. 8405).

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (në bashkëpunim me MMPAU) ka për detyrë të hartojë rregulloret mbi:

- Mbetjet industriale (neni 13 i ligjit nr.9010). Rregullorja nuk është hartuar ende.
- Mbetjet minerale (neni 14 i ligjit nr.9010). Rregullorja nuk është hartuar ende.
- Rehabilitimin e vendeve të hedhjes sipas specifikave të përmbajtjes së mbetjeve (neni 22 i ligjit nr. 9010).

Rregullorja nuk është hartuar ende.

METE ngre një njësi që merret me koncesionet, që ka për detyrë promovojë dhe ndihmojë autoritetin kontraktues për vlerësimin e koncesionit dhe negociatat (neni 8 i ligjit nr. 9663). Kjo vlen për

koncesionet lidhur me grumbullimin, transportin, përpunimin dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta (neni 4 i ligjit nr. 9663).

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (në bashkëpunim me MMPAU) ka për detyrë të hartojë rregulloret për mbetjet bujqësore dhe të kafshëve (neni 16 i ligjit nr. 9010). Rregullorja nuk është hartuar ende.

Ministria e Mbrojtjes (në bashkëpunim me MMPAU) ka për detyrë të hartojë rregulloret lidhur me mbetjet ushtarake (neni 15 i ligjit nr. 9010). Rregullorja nuk është hartuar ende.

Ministria e Financave (në bashkëpunim me MMPAU) ka për detyrë të hartojë legjislacionin për taksat e ndryshme mjedisore (neni 6 i ligjit nr. 9010). Deri tani, ajo ka hartuar ligjin nr. 8977, dt. 12.12.2002 "Mbi taksat në Republikën e Shqipërisë", ku janë paraqitur dy taksat e para për mjedisin (taksa e gjelbër dhe taksa e paketimit të pijeve).

Ministria e Financave harton rregullat mbi garancitë financiare për lejet mjedisore të vendeve të mbetjeve të rrezikshme, të cilat miratohen më vonë nga Këshilli i Ministrave (neni 14 i ligjit nr. 9537). Këto rregulla nuk janë hartuar ende.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (nën Ministrinë e Financave) mbledh të ardhurat nga taksat e mjedisit, të cilat aktualisht i kalojnë buxhetit të shtetit.

Qeverisja vendore ka për detyrë të organizojë heqjen e mbetjeve dhe të kontrakttojë kompanitë që pastrojnë qytetet (neni 20 i ligjit nr. 8094); të hartojë dhe miratojë rregulloret specifike territoriale për çdo metodë të menaxhimit të mbetjeve duke ndjekur prototipet e miratuara nga Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë (neni 11 i ligjit nr. 9010).

Bashkitë dhe komunat vendosin tarifat për heqjen e mbetjeve në territoret nën juridiksionin e tyre dhe autorizojnë persona të caktuar për t'i mbledhur ato (nenet 31 & 34 të ligjit nr. 8094);

Ligji nr. 8652, dt. 31.07.2000 "Mbi organizimin dhe funksionimin e qeverisë vendore", neni 10, njeh veprimtaritë për administrimin e mbetjeve (mbledhjen, transportin, trajtimin, dhe asgjесimin) në nivelin lokal si funksione të veta në zonën e investimeve dhe shërbimeve publike.

Autoritetet e qeverisjes vendore janë të përgjegjshme për të përcaktuar mbledhjen e mbetjeve dhe përpunimin e tyre në vende të caktuara, në përputhje me kriteret mjedisore dhe planet e zhvillimit; për organizimin e vend-depozitimit për mbetjet dhe substancat e rrezikshme; për mbetjet urbane dhe trajtimin e mbetjeve të impianteve të ujit. Bashkitë kanë sektorë të veçantë për pastrimin e qytetit dhe menaxhimin e mbetjeve.

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Qarkut/Bashkisë përcakton vendin grumbullimit (një sipërfaqe të barabartë ose më pak se 0,5 ha) për të gjitha llojet e mbetjeve (teknologjikë/urbane/inerte) në territorin e juridiksionit të tyre (nenet 9, 20 & 34 të ligjit nr. 8405).

Çdo njësi e qeverisjes vendore është autoriteti kontraktues për koncesionet e aktiviteteve ekonomike nën juridiksionin e vet, gjithashtu edhe për projektet koncesionare mbi mbetjet (neni 5 i ligjit nr. 9663).

Inspektoratet bashkiake bashkëpunojnë me Inspektoratin e Mjedisit, dhe në raste të veçanta me inspektoratet e tjera, për të kryer inspektime mbi aktivitetet të lidhura me mbetjet në territoret nën juridiksionin e tyre.

Këshilli Bashkiak është i përfshirë në procesin e lejimit të vendeve për grumbullimin e mbetjeve të rrezikshme (neni 13 i ligjit nr. 9537).

Agjentët ekonomikë të përfshirë në aktivitetet për menaxhimin/trajtimin e mbetjeve:

- Ndarja e mbetjeve që në burimin e prodhimit të tyre; grumbullimi i saktë, magazinimi dhe trajtimi i mbetjeve sipas llojit; ndërtimi i objekteve dhe impianteve për riciklimin e mbetjeve dhe përpunimin e tyre; hartimi i programeve sipas hapave teknike, teknologjike dhe organizative për menaxhimin e mbetjeve (neni 9 i ligjit nr.9010); Ato janë të detyruara t'i kryejnë aktivitetet e tyre duke mos rrezikuar shëndetin e njeriut, ujin, ajrin, tokën, bimët dhe kafshët; pa zhurmë dhe erë; pa shkaktuar dëme të pakthyeshme ndaj natyrës (neni 21 i ligjit nr. 8934);
- Ndarja e mbetjeve të rrezikshme nga mbetjet e tjera, paketimi, etiketimi dhe transporti në përputhje me rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Monitorimi i prodhimit të mbetjeve të veta, mbajtja e të dhënave (mbi llojin, sasinë e mbetjeve që ato prodhojnë, ripërdorimin, riciklimin, mbajtjen, transportin, sistemimin, ose shkatërrimin) dhe publikimi i informacionit lidhur me to (nenet 10, 11, 30 & 31 të ligjit nr. 9010);
- Të informojnë periodikisht ARM-të mbi mbetjet e rrezikshme që ato mund t'u jepen personave të tjerë dhe t'u japin akses në regjistrat e tyre të mbetjeve të rrezikshme (neni 8 i ligjit nr. 9537);
- Të raportojnë/informojnë MMPAU-në (neni 55 i ligjit nr. 8934) çdo 3 muaj (neni 58 i ligjit nr. 8934);
- Të garantojnë me shpenzimet e tyre sigurinë e hedhjes së mbetjeve të eksportuara kur vendet transit refuzojnë t'i lejojnë ato të kalojnë (neni 27 i ligjit nr.9010);
- Të paguajnë kostot e transportit, përpunimit dhe hedhjes për mbetjet e tyre (neni 10 i ligjit nr.9537, neni 7 i ligjit nr. 9537);
- Të hartojnë dhe zbatojnë programet e tyre për reduktimin e volumit, sasisë dhe helmueshmërisë të mbetjeve të rrezikshme (neni 7 i ligjit nr. 9537).

2. Vizioni, Prioritetet dhe Qellimet Strategjike

2.1 Shqipëria dhe Bashkimi Europian: Momentet Historike.

Synimi i kësaj strategjie është që të shërbejë sektorit të Administrimit të Mbetjeve në Shqipëri si dhe antarsimit të saj në Bashkimin Europian (BE), vazhdimin e forcimit të institucioneve ekonomike dhe sigurisë rajonale, si dhe bashkëpunimin Euro-Atlantik në fushat e sigurisë dhe të ekonomisë.

Në Nëntor të 2005, Qeveria e Shqipërisë pranoi Sistemin e Integruar të Planifikimit (SIP) një grup parimesh operacionale për të siguruar që politikat e ndërruara nga qeveria për planifikimin dhe zbatimin të jenë koherente, eficientë dhe të integruara. Dy janë proceset, shtyllat kryesore të SIP:

- Një planifikim strategjik afat mesëm dhe afat gjatë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), që përcakton synimet strategjike kombëtare prioritet.
- Një proces afatmesëm të buxhetit, Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri të ketë zhvilluar nga mesi i marsit deri në qershor një plan tre-vjeçar brenda një limiti shpenzimesh të caktuara për arritjen e objektivave të strategjisë, si hapa të ndërmjetëm për arritjen e qëllimeve të SKZHI.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programi Buxhetor Afatmesëm përshtasin plotësisht këto procese planifikimi:

- Programin Qeveritar 2009-2013;
- Integrimin në Bashkimin Europian, në vecanti zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim Asocimit nepermjet realizimit të standarteve për antaresim;
- Administrimin e investimeve publike, që nën një grup të ri procedurash të zhvilluara për herë të parë në 2007 do të bëhen pjesë e rendesishme të PBA_{se} ;
- Ndihmen e jashtme, në vecanti perpjekjet e qeverisë për të përdorur në mënyrë sa më efektive ndihmat e huaja në marrëveshje me angazhimet e Deklaratës së Parisit mbi efikasitetin e ndihmës që u firmos në Mars të 2005.

Në kuadër të SKZHI, Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Nder-sektoriale të Mjedisit. (Vendimi nr.847, Dt. 29.11.2007)

Strategjite, gjithashtu dhe Strategjite Nder-sektoriale të Mjedisit, pritet që të ndryshojnë sa herë që të ketë një ndryshim të rendesishëm në strategji, kurse SKZHI nuk pritet të ndryshojë. Gjithsesi një rishikim i zbatimit të SKZHI do të bëhet çdo vit në fillim të PBA. Do të publikohet një progres raport vjetor. Qëllimi kryesor i tij nuk do të jetë ai i një dokument planifikimi por që të shërbejë si një dokument monitorues për ndërtimin e një llogaridhenieje.

Me 12 Qershor 2006, Shqipëria firmosi Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit dhe Marrëveshjen e Përkohshme me BE. Qeveria Shqiptare ka përgatitur dhe po ve në zbatim Planin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit si instrumenti kryesor politik, ekonomik, ligjor dhe institucional dhe konsiderohet si një pjesë e rendesishme e Planit Kombëtar Strategjik për Zhvillim dhe Integrim.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit është instrumenti që do të mundësojë integrimin gradual të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Marrëveshja krijon strukturën e duhur për forcimin e ligjit, rrit efikasitetin e saj, si dhe mbështet reformat institucionale dhe ekonomike me qëllim që të rrisë standartet e jetesës për të të gjithë qytetarët e saj. Nepermjet kësaj Marrëveshjeje, Shqipëria synon të

realizojë standartet dhe të garantojë statusin e saj si vend kandidat dhe me pas “shoqerine” me Bashkimin Europian.

Kushtet për pranimin shkojnë përtej programit të punës të nënkuptuar nga ana e Stabilizimit dhe Asociimit. Shqipëria do të përdorë eksperiencën e Bashkimit Europian në zgjerimin drejt Europës Qendrore dhe Lindore për të përgatitur pozicionin e saj negociues.

Kjo do të kërkojë në vlerësim të thelluar lidhur me impaktin e adoptimit të disa aspekteve të Acquis Communautaire në mënyrë që të jepet përparesi kërkesave për periudhën e tranzicionit.

Ministria e Integritimit Europian është institucioni përgjegjës për orientimin, koordinimin dhe monitorimin e masave për zbatimin e kërkesave të vendosura në Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit dhe Instrumentit të Asistencës së Para-Aderimit.

Raport progresi i vitit 2009 për Shqipërinë nga Bashkimi Europian nuk është pozitiv përse i përket mjedisit. Administrimi i Mbetjeve shihet si shumë i dobët. Rezultatet për administrimin e mbetjeve dhe aspekteve të tjera vijojnë si më poshtë:

“...progresi në fushën e administrimit të mbetjeve është i vogël. Qeveria ka miratuar disa rregullore. Përvetësimi i venddepozitimit të Sharres ka patur shumë pak zhvillime në administrimin e mbetjeve nga ana e bashkisë. Hedhja e pakontrolluar dhe djegia e mbetjeve ende vazhdon të jetë një rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin. Shqipëria i mungon një sistem modern i grumbullimit, hedhjes dhe riciklimit dhe nuk ka ende një strategji të qarta për të mbrojtur nga hedhja e mbetjeve të rrezikshme. Përgatitjet në fushën e administrimit të mbetjeve nuk kanë përparuar.

.... Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për forcimin e kapacitetit administrativ të të gjitha institucioneve të përfshira në bërjen e politikave mjedisore dhe zbatimit. bashkëpunimi dhe koordinimi midis institucioneve duhet përmirësuar ende. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Mjedisor nuk është ende aprovuar. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për ratifikimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare. Përafrimi me legjislacionin “Acquis” është shumë i ngadalta, por zbatimi dhe forcimi ende janë të prapambetura. Përgatitjet në fushën e mjedisit janë shumë të ngadalta”

2.1 Një Vështrim Strategjik mbi Sektorin e Mbetjeve

2.1.1 Hyrje në Strategjinë mbi Mbetjet

Aspiratat strategjike kombëtare në lidhje me mbetjet janë të përshkruara në këto katër dokumente kryesore të prodhuara nga Qeveria Shqiptare në periudhën nëntor 2006-mars 2008:

- Strategjia Kombëtare mbi Mbetjet (SKM) publikuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave në emër të Qeverisë së Shqipërisë në Nëntor të 2006.
- Strategjia Kombëtare mbi Zhvillimin dhe Integrimin 2007-2013 shpallur nga KM në Mars të 2008.
- Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA 2007-2012 shpallur nga KM në Shtator të 2007
- Sektori Mjedisor Strategjia Ndersektoriale (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim) shpallur nga MMPAU në Nëntor të 2007
- Plani strategjik mbi mbetjet e rrezikshme, sic është përgatitur sipas projektit CARDS të BE në 2002 “ Mbi venddepozitimet e mbetjeve të rrezikshme”.
- Direktiva e Zbatimit të Planit mbi Mbetjet përgatitur nga projekti CARDS i BE 2006, INPAEL.

Ne menyre qe te kemi nje dokument strategjik mbi te cilin te bazohet Projekti Kombetar mbi Administrimin e Mbetjeve, elementet e dokumentave strategjike te permendura me siper jane kombinuara ne kete dokument ne menyre qe te sigurohet nje Strategji Kombetare e qarte per Mbetjet.

Strategjia mbulon periudhën 2010-2025 e cila është parë si periudhë e rëndësishme para dhe menjëherë pas pranimit në BE kohë gjate te ciles qeveria Shqiptare e ka kthyer administrimin e mbetjeve ne një çështje prioritare dhe ku përpjekje të rëndësishme do të duhen te bëhen për të përmirësuar rrënjësisht situatën aktuale .

Strategjia bazohet ne kater shtyllat themelore politike te Politikës Kombetare mbi Mbetjet si: **Planifikimi, Edukimi, Burimet dhe Legjislacioni.**

Në lidhje si më lart, Qeveria është e angazhuar për një program të përmirësimit të mjedisit si pjesë e një axhende më të gjerë politike për të fituar anëtarësimin e plotë në BE te Shqipërisë. Kjo do të përfshijë zbatimin e një përafrimi te planifikimit të integruar për administrimin e mbetjeve ne nivel Kombëtar, Rajonal dhe Lokal.

Kjo kerkon edukimin e te rinjve te vendit ne aftesi te reja qe do te krijojne mundesi te reja per ata ne sektorin e mjedisit. Keto programe do te prekin cdo sektor te sistemit arsimor, shkollat dhe universitetet, do te kete trajnim profesional per industrite dhe Ministrite, si dhe nje mori fushatash sensibilizuese per te mbajtur ne dijeni publikun mbi iniciativat e reja qe do merren per administrimin e mbetjeve

Qeveria eshte angazhuar qe te mbeshtesi kete strategji dhe Projektin Kombetar mbi Mbetjet nepermjet fondeve kombetare dhe atyre te donatoreve nderkombetar persa i perket burimeve njerzore dhe infrastructures.

Se fundi dhe ndoshta me i rendesishmi, qeveria eshte angazhuar qe te gjitha direktivat e BE lidhur me mjedisin dhe sektorin e administrimit te mbetjeve, te kthehen ne nje ligj Shqiptar.

Menjehere pasi te jete arritur hyrja ne BE, Shqiperia do te kete mundesine te perdore fonde te konsiderueshme per zhvillimin e infrastruktures. Ne kete pike strategjia duhet ripare dhe nje strategji e re te zhvillohet duke njohur perparimet e bera ne kete strategji si dhe te merren parasysh mundesite qe Shqiperia do kete nepermjet teknologjise se re dhe fondeve per infrastriktire ne dispozicion.

Zgjidhjet e vena ne kete dokument strategjik dhe ne Planin e ri Kombetar mbi Menaxhimin e Mbetjeve do te reflektojne pozicionin aktual financiar dhe do te kufizohet ne kete drejtim. Ato gjithashtu reflektojne situaten ekzistuese te infrastruktures, kapaciteteve teknike dhe masat e marra per administrimin e mbetjeve; ato reflektojne aspiratat te cilat jane ne nje vije me burimet dispoibel.

Kjo nuk ndryshon faktin se qeveria Shqiptare është e angazhuar për miratimin e legjislacionit të BE-së si dhe praktikën më të mira apo të futjes se teknologjisë në sektorin e administrimit të mbetjeve, por gjithesesi duhet kuptuar qe Shqipëria, si shtetet e tjera te pranuar ne te shkuaren dhe sot, ka panuar landfill-et (venddepozitimet sanitare) si opisionin kryesor te grumbullimit te mbetjeve.

Shqiperise i duhet kohe qe te rregulloje dhe te aplikojte praktika te reja dhe teknologji bashkekohore mbi administrimin e mbetjeve. Strategjia po reflekton realisht afatet kohore ne kete drejtim dhe vendi si i tere nuk po nenvlerson sfidat me te cilat ndeshet.

Prioritet në këtë periudhë të përkohshme është pranimi i kesaj strategjie te shoqeruar me zbatimin e Planit Kombetar dhe Rajonal per Menaxhimin e Mbetjeve, në mënyrë që Shqipëria të jete ne nje rruge te pajtueshme / te perputhur me Direktiven mbi Mbetjet. Projektet dhe kjo strategji janë zhvilluar për të reflektuar aspiratat realiste të Shqipërisë dhe ato do të jenë një themel i fortë për të ardhmen.

Strategjia Kombetare e Mbetjeve e pranon nevojën për të marrë plotësisht në konsideratë nevojat dhe rrethanat lokale, në mënyrë që të identifikojë zgjedhjet praktikisht më të mira për menaxhimin e mbetjeve në të gjithë vendin. Për këtë arsye, strategjia e ndan vendin në 12 zona mbetjesh bazuar në kufijtë gjeografike të qarqeve ekzistuese, ku secili nga planet do të zhvillohet në bashkëpunim me aktorët lokale.

Strategjia gjithashtu njeh nevojën për të identifikuar burimet përsosë të mbetjeve në mënyrë që ata të mund të jenë subjekt i vecantë në konsideratë për qeverinë dhe komunitetin ndërkombëtar të donatorëve.

2.2.2 Administrimi i Mbetjeve: Sektori Specifik

Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është i një niveli të ulët dhe paraqet probleme për grumbullimin afër qendrave urbane dhe sidomos përpunimi i mbetjeve në pika të caktuara, kurse zonat rurale nuk janë të mbuluara fare nga këto lloje shërbimesh. Përveç reabilitimit të vendit depozitimi të Sharres ka patur zhvillime të vogla përse i përket administrimit të mbetjeve nga bashkia. Mos kontrollimi i hedhjes së mbetjeve apo djegies së tyre paraqet një rrezik për shëndetin dhe mjedisin.

Shqipëria i mungon një sistem grumbullimi, depozitimi, dhe riciklimi dhe nuk ka ende një strategji të qartë mbi depozitimin e sigurt të mbetjeve të rrezikshme. Rigjenerimi i mbetjeve dhe monitorimi i tyre mungon ashtu siç mungon dhe një database moderne në nivel kombëtar dhe rajonal.

Zhvillimi i shpejtë dhe i qëndrueshëm është një nga objektivat kryesore të Qeverisë së Shqipërisë. Shqipëria duhet të zhvillojë mbrojtjen e burimeve të saj natyrore nga ndotja dhe degradimi, duke nxitur vlerat mjedisore dhe venien e tyre në dobi të prosperitetit ekonomik të vendit.

Një zhvillim i tillë do të drejtohet nga politikat dhe vizionet e Qeverisë, që do të sigurojnë një zhvillim të zonave urbane dhe rurale së bashku dhe duke mbështetur njëkohësisht dhe mbrojtjen e mjedisit. Synimi i kësaj qeverie do të jetë realizimi efektiv i politikave sektoriale me një qëndrim unik dhe të integruar.

Qëllimi është zhvillimi i qëndrueshëm i vendit duke mbrojtur sa më shumë të jete e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore.

Zhvillimi i qëndrueshëm është një model i përdorimit të burimeve që synon të përmbushë nevojën e njeriut por duke ruajtur mjedisin në të njëjtën kohë në mënyrë të tillë që të mos plotësojë vetëm nevojat e të tashmës, por edhe të brezave të ardhshëm. Për të arritur një zhvillim të tillë të qëndrueshëm Shqipëria ka nevojë për hartimin e një plani që të funksionojë në drejtim të:

- Permisimit të cilesive të jetës;
- Krijimit të kushteve të një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të integruar; dhe
- Integritetit të strategjisë mjedisore me strategjitë e sektoreve të tjera.

Sipas Strategjisë së Sektorit Mjedisor dhe Nder-sektorial (2007) "Për vitin 2006 Shqipëria i ka kaluar 722 000 ton në vit në prodhimin e mbetjeve urbane". Vëllimi mesatar i prodhimit të mbetjeve është 550 kg për frymë në vit në zonat urbane dhe 170 kg në zonat rurale. Administrimi i mbetjeve në Shqipëri është në nivel të ulët dhe paraqet probleme për grumbullimin pranë qendrave urbane dhe sidomos të përpunimit të mbetjeve në pikat e caktuara ". Këto shifra u cituan në bazë të një mesatareje statistikore të BE-së dhe nuk kanë të bëjnë me shifrat aktuale të popullsisë të kohës.

Sipas një studimi të kryer kohët e fundit nga INPAEL, që është realizuar në 2009, rezultoi se shuma totale e mbetjeve komunale të gjeneruara mund të ketë arritur në 850.000 ton në vit, barabartë me 266 kg për person në vit. Kjo shifër pritet të rritet me zhvillimin e ekonomisë dhe rritjes së konsumimit.

2.2.3 Perpresite e Programit te Qeverise

Per te arritur asocimin dhe antaresimin e plot ne Bashkimin European vendit do i duhet te pershtase legjislacionin e Komunitetit European ne fushen e mjedisit gjate dekades se ardhshme. Ne disa raste, vecanerisht per elementet e "investimeve te medha" te legjislacionit te Komunitetit, perputhja e plote nuk do te mund te arrihet deri kur Shqiperia te pranohet dhe disa kohe me pas sic ndodh me Shtetet e Reja Antare

Megjithate nevojitet nje perparim i dukshem edhe ne keto fusha. Mjedisi eshte nje nga perberesit me te medhenj te legjislacionit te Komunitetit European dhe eshte pranuar se eshte nje nga fushat me te veshtira per te arritur perputhshmerine.

Prioritetet e Qeverise ne lidhje me sektorin e mjedisit, ne kontekstin e rruges drejt antarsimit ne BE, jane paraqitur ne nje numer dokumentash strategjike:

Strategjia e Mjedisit dhe Nder-sektoriale e 2007 si dhe Strategjia Kombetare per Zhvillim dhe Integrimin (2007-2013) skicojne 7 pika kryesore strategjike qe do te trajtohen ne kuader te procesit te integrimin ne BE. Ato jane si me poshte:

2.2.3.1 Pervetesimi i Standarteve Ligjore te Komunitetit European

Kjo eshte nje kerkesë e procesit të pranimit dhe veprimet e nevojshme për të arritur këtë janë përcaktuar në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Legjislacioni i ri do të përcaktojë objektivat e përkohshme, në bazë të një vlerësimi të kostos se plotesimit, për të krijuar një peraftrim ne arritjen e standarteve.

Zbatimi i legjislacionit si dhe rritja e masave kunder atyre personave qe shkelin ligjet kunder mjedisit jane padyshim shume te nevojshme. Per momentin zbatimi i ligjit eshte i dobet. Nje zbatim me i madh kerkon burime ekstra per Agjensine Kombetare te Mjedisit dhe zyrat rajonale si dhe Inspektoriatin Kombetar te Mjedisit. Fuqizimi i zyrave rajonale të mjedisit do te ndihmojë ato të veprojnë si një mjet komunikimi ne nivel kombetar dhe rajonal, qe do të jetë gjithnjë e më e rëndësishme me vazhdimin e procesit te decentralizimit. Për më tepër, Agjencitë do të jenë në gjendje për të vepruar si këshilluese për të ndihmuar autoritetet lokale në përmbushjen e detyrimeve të tyre në sektorin e mjedisit si dhe të luajë një rol më aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit lokal, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duke përfshirë pyjet, kullotat dhe burimet e ujit dhe të peshkimit.

Zbatimi i suksesshëm i legjislacionit të BE-së do të kërkojë gjithashtu përmirësime në sistemin e lejeve mjedisore, qe perben mekanizmin kryesor te kontrollit. Zbatimi dhe forcimi i ligjit do të kërkojnë në të njëjten kohe ndërgjegjësim dhe nje qajse te pergjithshme ndaj mjedisit. Kjo do të jetë e mundur gjithashtu edhe me përmirësimin e legjislacionit dhe te komunikimit. Përderisa përmirësimet në zbatimin e lejeve do të japin përfitime mjedisore, përmirësime të tilla duhet të jenë realiste dhe të arritshme në përputhje me nocionin e "teknologjisë më të mirë te disponueshme" ku industritë dhe subjektet e tjera ekonomike mund të planifikojne te investojne ne teknologjine e re dhe masat mbrojtese te mjedisit. Nuk është e përshtatshme që të kërkojen aktivitetet ekonomike për të kompensuar mungesën e infrastrukturës së shërbimeve komunale te tilla si kanalizimet.

Aktualisht niveli i respektimit të ligjit mjedisor është i ulët. Arritja e ndryshimeve në sjelljen dhe qëndrimet e individëve dhe të entiteteve komerciale do të kërkojë një numër te madhe masash duke përfshirë përmirësimin në legjislacion dhe komunikim. Megjithatë, një nga elementët kyç duhet të jetë zbatimi i ligjeve kunder shkelesve. Do të jetë i nevojshem zbatimi i një serie fushatash për trajtimin e problemeve të veçanta.

Sic eshte vene re, niveli i burimeve administrative të përkushtuara aktualisht për mbrojtjen e mjedisit është i pamjaftueshëm për të arritur nivelin e duhur te zbatimin e masave ashtu sic kerkohet.

Forcimi i 12 inspektorateve rajonale te mjedisit është i nevojshëm urgjent. Aktualisht janë vetëm 40 inspektorë për të gjithë vendin dhe shumë prej tyre nuk kanë mjete transporti. Inspektoratet duhet të kenë personel të mjaftueshëm dhe mjete për zbatimin e ligjeve, por mungesa e tyre paraqet një pengesë të madhe. Numri i personelit te nevojshem për të siguruar një zbatim te kenaqshem është i vështirë të përcaktohet sepse ajo është e varur shkalla e respektimit te ligjit.

Nje rritje e tille do te rriste tre here me shume kostot per personelin. Gjithsesi rritja e numrit te personelit do jete e pamjaftueshme. Mjetet shtese si automjetet, kompjuterat dhe mjetet e komunikimit do te jene te nevojshme. Kjo do te perfshije shpenzime te reja teresore dhe shpenzime operationale te vazhdueshme.

2.2.3.2 Forcimi i zbatimit te ligjit mbi mbetjet

Kjo është një kërkesë e procesit të pranimit dhe veprimet e nevojshme për të arritur këtë janë përcaktuar në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Direktiva të shumta mbi mbetjet janë të lidhura me zhvendosjen në legjislacionin kombëtar. Legjislacioni i ri për mbetjet do të përcaktojë objektivat e përkohshme për të krijuar një qasje për arritjen e standardeve.

Forcimi i legjislacionit mbi mbetjet, që aktualisht është i dobët dhe rritja e masave ndëshkuese kundër shkelesve të ligjit për mjedisin është padyshim i nevojshem. Zbatimi me i suksesshem do të kërkojë burime të tjera për Inspektoriatin e Mjedisit dhe Agjencite Rajonale të Mjedisit, për forcimin e tyre në mënyrë që të veprojnë si një mjet komunikim ndërmjet nivelit Kombëtar dhe atij lokal që do të jetë gjithnjë e më e rëndësishme pasi vazhdon procesi i decentralizimit. Për më tepër, AMP do të jetë në gjendje për të vepruar me një kapacitet këshillues për të ndihmuar autoritetet lokale në përmbushjen e detyrimeve të tyre në sektorin e mjedisit dhe mund të luajë një rol më aktiv në rritjen e ndërgjegjësimit lokal për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe në shfrytëzimin e burimeve natyrore nën administrimin e tyre, duke përfshirë pyjet, kullotat, burimet e ujit dhe të peshkimit.

Një zbatim i suksesshëm i legjislacionit të mbetjeve do të kërkojë gjithashtu përmirësime në sistemin e lejeve mjedisore, të cilat përbëjnë mekanizmat kryesor të kontrollit.

Nje zbatim i sukseshem ligji kerkon ne te njeiten kohe ndergjegjesim dhe ndryshime ne qasjet e pergjithshme kundrejt mjedisit. Kjo mund te behet e mundur dhe nepermjet zhvillimit te legjislacionit dhe komunikacionit.

Përderisa përmirësimet në zbatimin e lejeve do të japin përfitime mjedisore, përmirësime të tilla duhet të jenë realiste dhe të arritshme në përputhje me nocionin e "teknologjisë më të mirë të disponueshme" ku industritë dhe subjektet e tjera ekonomike mund të planifikojnë të investojnë tek teknologjia e re dhe masat e mbrojtese të mjedisit. Nuk është e përshtatshme që tu kërkohej aktiviteteve ekonomike për të kompensuar mungesën e infrastrukturës së shërbimeve komunale të tilla si kanalizimet.

Aktualisht niveli i respektimit të ligjit mjedisor është i ulët. Arritja e ndryshimeve në sjelljen dhe qëndrimet e individëve dhe të entiteteve komerciale do të kërkojë një numër të madhe masash duke përfshirë përmirësimin në legjislacion dhe komunikim. Megjithatë, një nga elementët kyç duhet të jetë zbatimi i ligjeve kundër shkelesve. Zbatimi i një serie fushatash për trajtimin e problemeve të veçanta do të jetë i nevojshem.

Sic eshte vene re, niveli i burimeve administrative të përkushtuara aktualisht për mbrojtjen e mjedisit është i pamjaftueshëm për të arritur nivelin e duhur të zbatimit të masave ashtu sic kerkohet.

Forcimi i Inspektoriateve Mjedisore eshte i nevojshem urgjentisht. Inspektoriatet kane nevojte per personel te mjaftueshem dhe per zbatimin e ligjeve kundra atyre qe shkelin ligjet mbi mjedisin. Numri i personelit te nevojshem për të siguruar një pengesë të tillë është i vështirë të caktohet sepse ajo është e varur shkalla e respektimit të ligjit.

Gjithsesi rritja e numrit të personelit do jete e pamjaftueshme. Mjetet shtese si automjetet, kompjuterat dhe mjetet e komunikimit do te jene te nevojshme. Kjo do te perfshije shpenzime te reja kapitale dhe shpenzimet e operacioneve te vazhdueshme.

Kjo do te arrihej nepermjet forcimit te AMP dhe inspektoriateve, permisime ne sistemin e lejeve dhe nje nerhyrje e forte ne ndalimin e shkelesve te ligjit.

Rritja e burimeve në sektorin publik do të sigurojë rritjen e kapacitetit të përafritimit në “ Acquis Communautaire” nga afati i shkurtër tek ai i mesëm. Megjithatë është e pamundur si për sektorin privat ashtu edhe për atë publik të pajtohen me standartet afatshkurtra dhe afatgjata. Siç u diskutua në seksionet e mëparshme shkalla e ndryshimeve dhe investimeve të kërkuara është tepër e madhe. Për këtë arsye, legjislacioni i ri mbi mbetjet do të duhet të caktojë objektiva të përkohshme, të cilat krijojnë një qasje për arritjen e standardeve të Komunitetit Evropian në afat më të gjatë. Miratimi i standardeve për administrimin e mbetjeve urbane mbetet një çështje prioritare për investimet në infrastrukturën urbane dhe rurale, të shoqëruara me një faturë të konsiderueshme financiare.

Mbledhja dhe perpunimi i mbetjeve urbane permban nje standart, plotesimi i te cilit eshte goxha i shtrejnte. Duke marre parasysh qe standartet Europiane kerkojne gati 5 € per m³ dhe se gjenerimi i mbetjeve arrin midis 300kg dhe 500kg per person ne vit, ne nje afat te mesem si dhe nje jetegjatesi prej 15 vitesh te nje landfill-i, kosto totale mund te arrij afersisht ne 50 milion Euro⁸ per te siguruar venddepozitime sanitare ne te gjithe vendin. Duhet theksuar qe kjo shume nuk merr parasysh mbetjet industriale, komerciale ose te ndertimeve. Kostoja e sigurimit të hapësirës për mbetje të tilla do të ishte shtesë. Ky vlerësim nuk ka marrë parasysh investimet që do të jenë të nevojshme në pajisjet grumbulluese si konteneret, makinerit grumbulluese ose pajisjet ricikluese.

Në mënyrë që të sigurojë një raport të balancuar midis mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit ekonomik, duhet të përcaktohet një standart i mesëm në bazë të një analize të qartë të burimeve financiare dhe ekonomike të nevojshme për zbatimin e çdo pjese të legjislacionit. Nje kosto e tille vleresimi ende nuk eshte dhene ne menyre te detajuar. Prandaj, është e këshillueshme që përveç stafit të lart-identifikuar, burimet shtesë financiare dhe ekonomike të përcaktohen për përmirësimin e legjislacionit të propozuar.

Paraqitja e ketyre lloj procedurave kaq te perparuara do te lejojë për përmbushjen e standardeve të përkohshme për periudha më të gjata, të cilat do të sigurojnë industrisë një kuadër rregullator më të mirë, me të cilën ajo mund të zbatojë planet e saj të biznesit dhe të marrë vendime mbi investimet.

2.2.3.3 Investimet për mbrojtjen e mjedisit

Kjo do të bëhet me qëllimin për të siguruar që Direktiva 2008/98/EC mbi Mbetjet dhe standardet dhe akte të tjera të Komunitetit Evropian të mund të arrihen brenda 20 viteve të ardhshme në fushat e mëposhtme:

9 Kjo e dhene eshte marre nga Strategjia Ndersektoriale e Mjedisit, Nentor 2007

Administrimin e mbetjeve të ngurta, projektimin, ndërtimin dhe funksionimin e vend-depozitimeve sipas standardeve të BE:

- Mbyllja e vend-depozitimeve ekzistuese ose të paligjshme ose që nuk janë në përputhje në zonat urbane;
- Rehabilitimi i tokave të ndotura dhe burimeve të ndotjes;
- Zhvillimi teknologjik i industrive shtetërore dhe private sebashku

Kostoja e një programi të tillë do të jetë e madhe. Ndonëse komercializimi i shërbimeve është arritur në disa zona, ai është ende në një fazë fillestare. Tarifat aktuale për shërbimet e pastrimit, me disa përjashtime, si bashkia e Tiranës, janë relativisht të ulëta dhe nuk mund të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për një operator komercial për të bërë investime të suksesshme. Nivelet aktuale të shpenzimeve publike për elementet e këtij programi janë të pamjaftueshme për të arritur rezultatet e mësipërme për një periudhë prej 20 vjetësh. Për të nxitur investimet e mjedisit, qeveria ka rënë dakord të ngrejë një Fond Mjedisor⁹ që të sigurojë financimet fillestare për projektet e investimeve mjedisore.

Bazuar në analizat e përafërta financiare në përputhje me standardet, rezulton se niveli aktual i investimeve është i pamjaftueshem për të përmbushur këto nevoja në terma afatmesëm. Prandaj objektivi nuk ka gjasa të jetë i arritshëm dhe i perballueshem. Megjithatë është e rëndësishme që programi aktual i investimeve është forcuar dhe se një program investimesh afatgjatë është zhvilluar për të realizuar standardet e Komunitetit Europian brenda 20 viteve të ardhshme

Ky lloj programi investimi duhet të ketë nevojën të adresojë:

- Mbetjet e ngurta – parandalim, pergatitje për riperdorim, rigjenerim dhe asgjësim duke ndjekur të njëjtin rend për nga prioriteti të sugjeruar nga hierarkia e menaxhimit të mbetjeve.
- Cilesine e tokës – rehabilitimin e “zonave të nxehta”
- Permisimin teknologjik të industrive shtetërore

Siç u përmend më lart, kostoja e një programi të tillë do të jetë thelbësore. Pjesa më e madhe e këtyre shpenzimeve do të duhet të bëhet nëpërmjet sektorit publik, pa përjashtuar kontributin e sektorit privat.

Ndonëse komercializimi i shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve dhe të funksionimit të shërbimeve të ujit është arritur në disa zona, nuk ka gjasa që privatizimi i infrastrukturës me qëllim të tërheqjes së investimeve të sektorit privat do të jetë i suksesshëm. Tarifat aktuale të paguara për shërbime të tilla janë relativisht të ulëta dhe nuk do të sigurojnë të ardhura të mjaftueshme për të bërë investime të tilla financiare të besueshme për një operator komercial. Për këtë arsye, shumë nga këto investime do të duhen të bëhen nëpërmjet sektorit publik.

Shpenzimet aktuale publike për elementet e këtij programi janë të pamjaftueshme për të arritur këtë brenda periudhës 20 vjeçare sic u citua më sipër. Investimet do të kërkohen dhe nga sektori privat. Arritja e standardeve nga industritë private duhet të jenë objekt i dispozitave ligjore, por edhe mund të mbështeten nga përdorimi i stimuljeve fiskale ose instrumenteve të tjera ekonomike. Shpenzimet nga qytetarët / familjet do të jenë gjithashtu të nevojshme, duke përfshirë edhe rinovimin e automjeteve si të përmendura më lart.

⁹ Në mënyrë që të jete në një linjë me Programin, Qeveria do të vendose një Fond Mjedisor të vecantë që do të financohet nga taksat dhe gjatë mjedisore si dhe nga donacionet. Ky fond do të shërbejë për të financuar projekte të ministrive të ndryshme, duke përfshirë aktivitetet të tilla si menaxhimi i mbetjeve të ngurta, grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura si dhe për prodhimin e energjisë. Gjithashtu Fondi do të mbulojë edhe nevojat e Programit të Mbrojtjes së Mjedisit.

Per te percaktuar investimet me te duhura, duhen marre ne konsiderate edhe investime te tilla si p.sh kostoja e tokes dhe perdorimi i saj, duke lejuar nje kosto te perballueshme. Per shembull aplikimi i teknologjise per trajtimin e mbetjeve mund te kerkoje me shume toke per zbatimin e saj, por kostot operacionale mund te jene shume me te ulta duke lejuar nje kosto me te perballueshme disavantazhet e te ciles nuk i ndjen as konsumatori as prodhuesi

2.2.3.4 Suport Financiar per Infrastrukturen e Mjedisit

Investimet qe duhen per arritjen e standardeve do te ndihmohen nga Fondi Mjedisor, i cili do te krijohet ne perputhje me Programin e Qeverise ne pjese e dyte te mandatit te dyte te saj. Ky Fond Mjedisor do te financoje mjedisin dhe per kete arsye dhe projekte investimi mbi mbetjet. Eshhte parashikuar qe Fondi Mjedisor do t'i adresoj investimet ne kompetencë te disa ministrive, duke përfshirë edhe aktivitete si administrimin e mbetjeve të ngurta, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza, dhe efikasitetin e përdorimit të energjisë. Përveç kësaj, Fondi Mjedisor do të mbulojë nevojat e programit për Mbrojtjen e Mjedisit.

Fondi i Mjedisit do të kërkonte ndryshime të rëndësishme buxhetore dhe një ndarje të përgjegjësisë ndermjet disa Ministrive. Pavarësisht nga këto nderlikime Fondi Mjedisor është krijuar në disa shtete Europiane. Në shumicën e rasteve fondi është krijuar si një "pjese më vete" subjekti financiar i te cilit është themeluar me ligj dhe qe administrohet nga një bord ekzekutiv i përbërë nga Ministria dhe zyrtarë të tjerë të lartë.

2.2.3.5 Administrimi i burimeve mjedisore

Përmirësimi i administrimit të mbetjeve në të gjithë vendin do të përmirësojë efikasitetin e përdorimit të burimeve natyrore. Përveç kësaj ripërdorimi i agregateve të perdorura nga sektori i ndertimt dhe i prishjeve do të reduktojë presionin mbi agregatët e paster dhe nevojën për reduktimin e guroreve dhe prodhuesve të zhavorit.

2.2.3.6 Permiresimi i komunikimit dhe ndegjegjesimit

Niveli aktual i ndërgjegjësimit mjedisor është i ulët, pra rezulton në sjelljen dëmtuese nga ana e qytetarëve. Vëmendje do t'i jepet masave të cilat ofrojnë informacion për publikun, për të rritur ndërgjegjësimin e kërkesave ligjore dhe promovimin e sjelljeve miqësore ndaj mjedisit.

Masat relativisht me kosto të ulët për të rritur ndërgjegjësimin e publikut mund të kenë një ndikim të rëndësishëm pozitiv në kushtet mjedisore. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet masave të cilat:

- Ofrojnë informacion për publikun në nivel kombëtar dhe lokal
- Rrisin ndërgjegjësimin ndaj kërkesave ligjore
- Nxitin sjelljen miqësore ndaj mjedisit

Disa përparime janë bërë në arritjen e bisedimeve në fushën e mjedisit, por keto duhet të konsolidohen dhe nga burimet e departamentit të komunikimit të MMPAU qe te forcohen për të arritur qëllimet e programit.

Sisteme të ndërgjegjësimit afatgjate do të ngrihen nëpërmjet sistemit arsimor dhe integritit të temave mjedisore në programin e shkollave dhe atyre të arsimit të lartë.

2.2.3.7 Permisimi i sistemit monitorues

Specifikimi dhe arritja e qëllimeve kërkon monitorim të të dhënave për emetimet dhe mbi gjendjen e mjedisit, të cilat për shumë çështje nuk janë në dispozicion në Shqipëri. Objektivat e strategjisë të përqëndrohen kryesisht në arritjen e zvogëlimit të presioneve mjedisore në mënyrë që të arrihet pajtueshmëri me standardet kufitare të emetimeve.

Përputhjet me objektivat e cilësisë së mjedisit do të arrihen vetëm në një fazë të mëvonshme, megjithatë, objektivat mjedisore për përmirësim janë propozuar në lidhje me administrimin e mbetjeve.

Për më tepër ka edhe çështje të rëndësishme nga dokumentat e mësipërme që kanë të bëjnë me sektorin e administrimit të mbetjeve në kuadër të zhvillimit rajonal, planifikimit dhe të infrastrukturës. Këto çështje janë të përshkruara më poshtë.

Zhvillimi urban, rural dhe rajonal

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ka për qëllim të parandalojë zhvillimin e pabarabartë që të bëhet një pengesë në rritje. Në zhvillimin rajonal dhe rural, propozohen politika të reja dhe strukturat të zbatimit të cilat përgatisin administratën për përdorimin me efikasitet të instrumenteve financiare që do të jenë në dispozicion në vitet që vijnë. Në zonat rurale, këto politika janë nxitur nga nevoja për të siguruar një nivel minimal të qasjes në shërbimet që do të mbështesin aktivitetin ekonomik dhe nxisin diversifikimin ekonomik. Kjo përfshin gjithashtu administrimin e mbetjeve. Varësia e shumë zonave rurale ndaj turizmit pritet të rritet dhe kjo është një arsye më shumë për zonat rurale që të përfshihen në skemat e integruara të administrimit të mbetjeve.

Planifikimi hapësinor

Informalitetit është një nga sfidat kryesore që ndesh zhvillimi territorial dhe hapësinor në Shqipëri. Sfida të tjera të rëndësishme në zhvillimin territorial dhe hapësinor janë:

- Lëvizja demografike dhe urbanizimi i shpejtë, këto fenomene janë të shoqëruara me mungesën e planifikimit urban dhe mungesën e shqyrtimit të ndikimeve të saj mbi infrastrukturën ekzistuese dhe mjedisin. Zona të reja në brendësi të qytetit po ndërtohen pa pasur një plan të shtrirjes së infrastrukturës mjedisore të nevojshme duke përfshirë edhe infrastrukturën e mbetjeve.
- Ndarja e paqartë e përgjegjësisë midis qeverisë qendrore dhe asaj lokale: Shumë funksione të administrimit në zonat urbane janë transferuar gradualisht në njësitë e qeverisjes vendore, pa sigurimin e burimeve të nevojshme financiare dhe njerezore, për të ushtruar këto funksione në mënyrë të efektshme.
- Kapacitetet e ulëta profesionale në fushën e planifikimit.
- Korrupsioni i lartë në administratë

Politika e planifikimit hapësinor në të ardhmen duhet të promovojë dhe mbështesë zhvillimin territorial që të mundësojë një përdorim racional të tokës, burimeve natyrore dhe mjedisit. Kur bëhet planifikimi hapësinor i zhvillimit të qyteteve dhe rajoneve duhet të merret parasysh edhe Infrastruktura e Menaxhimit të mbetjeve.

Zhvillimi rajonal i infrastrukturës së mbetjeve

Pervec qëllimit të zbatimit të Direktives së Mbetjeve, kjo strategji, do të synojë të mbyllë vend grumbullimet aktuale të mbetjeve të cilat nuk janë në përputhje me kërkesat e Direktives së Lendfillit.

Gjithashtu ajo synon te reduktoje ndertimin e lendfilleve te rinj ne vend, duke gene se promovon zbatimin dhe detyrimin e hierarkise se menaxhimit te mbetjeve. Nevoja per te pasur landfille do te zvogelohet duke gene se investimet kryesore ne infrastrukturen e menaxhimit te mbetjeve do te synojne ne minimizimin e mbetjeve, grumbullimin e ndare te mbetjeve qe ne burim, riperdorimin, riciklimin dhe rikuperimin, dhe reduktimin ne menyre drastike te asgjesimit te mbetjeve. Nepermjet kesaj strategjie eshte prezantuar nje koncept i ri: ajo e infrastruktures se asgjesimit te mbetjeve ne nivel rajonal. Ajo cka sugjeron strategjia eshte qe te lihet menjane koncepti 1 bashki – 1 landfill (aktualisht ne vend ekzistojme me shume se 65 vende grumbullimi mbetjesh) dhe te shkohet drejt konceptit per te pasur te pakten 1 landfill per rajon. Bashkite dhe Komunat te cilet ndodhen ne te njejtin qark duhet te nenshkruajne marreveshje per vendin ku duhet te ndertohet landfilli, menyren e menaxhimit te tij, si mund ta bejne financiarisht te qendrueshem etj. Kjo menyre do te kerkoje me pak hapësire, me pak investime, dhe do te kete me pak impakt ne mjedis. Duke ndjekur kete koncept, do te nevojiten 12 landfille per 12 qarqe, keshtu qe numri i landfilleve do te ulet deri ne 5 here.

Zhvillimi rural

Standardet e jetesës në zonat rurale janë shumë më të ulëta se ato në zonat urbane. Permasat e varfërisë rurale janë ne nje nivel me të ulët të te ardhurave për frymë, rreziku shëndetësor eshte relativisht i larte, shërbimet publike të pamjaftueshme, etj. Varfëria e tyre është pasqyruar edhe në përjashtimin e tyre nga skemat e administrimit te mbetjeve. Vizioni i kesaj strategjie është të kontribuojë në zhvillimin e barabartë të të gjitha zonave rurale, për të përmirësuar cilësinë e jetës në keto zona, si dhe për zvogëloje popullaten e varfer rurale ne nje menyre te qendrueshme. Ky vizion vlen gjithashtu per administrimin e mbetjeve. Shumë duhet bërë duke pasur parasysh mungesën e përvojës dhe investime te bera në këto zona në të kaluarën.

Transporti

Rrjeti i transportit i trashëguar nga e kaluara nuk eshte i mjaftueshem për të përballuar zhvillimin e tanishëm dhe të ardhshëm social-ekonomik të vendit. Megjithëse investime të konsiderueshme jane bere, rrjeti rrugor është ende i kufizuar në cilesi ne krahasim me vendet e tjera. Kjo mund të pengojë në një farë mase transportin e mbetjeve për dhe nga të gjitha vendet e mundshme.

Nga ana tjetër, infrastruktura fizike e hekurudhave është e dobët. Për shkak të burimeve të pamjaftueshme dhe mungeses se punimeve të mirëmbajtjes, standardet teknike të hekurudhave janë të ulëta dhe nuk garantojnë lëvizjen e sigurt. Shpejtësia mesatare e trenave është në nivelin 30-40 km/h. Sasia e mallrave te transportuar është e vogël dhe ngarkesa mesatare është shumë e shkurtër. Megjithatë, përmirësimi dhe / ose mirëmbajtja e sistemit hekurudhor ofron një potencial të mirë për të përmirësuar transportin e mbetjeve dhe administrimin në vend. Përdorimi i sistemit hekurudhor për transportin e mbetjeve, kudo që të jetë e mundur do ule ngarkesën e transportit dhe për këtë arsye të trafikut në rrugët e ndër-urbane.

2.3 Strategjia e Qeverise

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë aprovuar me referendum ne 1998, e frymëzuar nga parimet e Agjendës 21 dhe nga konventat ndërkombëtare mjedisore ka sanksionuar qëllimet e shtetit "për një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm" dhe "për shfrytëzim racional te burimeve natyrore ..., bazuar në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm "(neni 59,1 / d, dh). Ajo gjithashtu ka sanksionuar te drejtat e çdo individi "të jetë i informuar për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij" (neni 56).

Strategjia e tanishme e Shqipërisë mbi mbetjet është e bazuar në strategjinë Evropiane. Objektivi kryesor i qeverisë është te përmbushë detyrimet e rëna dakord në MSA (neni 108), duke deklaruar

se: "Palët do të zhvillojnë dhe forcojnë bashkëpunimin e tyre në luftën kundër degradimit mjedisor, me qëllim promovimin e qëndrueshmërisë mjedisore ". Bashkëpunimi do të përqëndrohet kryesisht në fushat prioritare që lidhen me "Acquis e Komunitetit" në fushën e mjedisit. Deklarata mbulon të gjitha çështjet nën "Acquis" mjedisor, pra administrimin e mjedisit gjithashtu.

Administrimi i mbetjeve është identifikuar dhe pranuar si një çështje prioritare mjedisore e lartë në një numër dokumentesh strategjike të tilla si Strategjia e Studimit të Mjedisit (BB, 1993), NEAP (1994), NEAP (2002), EPR Shqipëria 2002 (UNECE), etj

Nevoja për përmirësim në fushën e administrimit të mbetjeve është vënë në dukje edhe në raporte të ndryshme të Komisionit Europian për Shqipërinë. Raportet e Progresit të KE 2006, 2007 dhe 2008:

- *inkurajon ndërtimin "e infrastrukturës për trajtimin e mbetjeve urbane, mbledhjen selektive, riciklimin dhe depozitimin e tyre;*
- *thekson se hedhja e pakontrolluar dhe djegia e mbetjeve vazhdojnë të përbëjnë rreziqe për shëndetin dhe mjedisin;*
- *theksojnë se nuk ka një strategji të zhvilluar qarte për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme;*

Edhe pse është pranuar gjerësisht që çështja e mbetjeve është një çështje me prioritet të lartë mjedisor, ende nuk është aprovuar një Strategji Kombëtare mbi Administrimin e Mbetjeve (ose të Mbetjeve të Rrezikshme) dhe një Plan mbi Administrimin e Mbetjeve. Mungesa e një Strategjie mbi Mbetjet dhe në Plani për Administrimin e Mbetjeve në gjithë këto vite ka çuar në përdorimin e ulet të fondeve në këto fushë.

Megjithatë, një Projekt Strategji Kombëtare për Mjedisin (SKM) u përgatit në 2006 në kuadër të projektit CARDS 2002 ELPA, e cila nuk u aprovua si e tillë, por bazuar në këtë projekt u hartua Strategjia Nder-Sektoriale e Mjedisit dhe Strategjia për Zhvillim dhe Integrim u aprovua nga Këshilli i Ministrave me vendim 847, dt 29.11.2007, ku një kapitull i këtij dokumenti i është kushtuar administrimit të mbetjeve.

2.3.1 Mbetjet e Rrezikshme Industriale të Ngurta

Grumbullimi dhe depozitimi i mbetjeve industriale është përgjegjësi e prodhuesit. Informacione për sasinë apo llojet e mbetjeve industriale nuk janë mbledhur. Nuk ka informata të sakta edhe pse është e njohur se shumica asgjësohen në vendet e mbetjeve komunale, disa mbahen në vendin e prodhimit, por një pjesë hidhen në vende të paautorizuara.

Bazuar në një krahasim me vendet e tjera niveli i gjenerimit të mbetjeve industriale në Shqipëri është vlerësuar të arrijë në 170.000 ton në vit, nga të cilat një pjesë do të klasifikoheshin si të rrezikshme.

Në përgjithësi gjeneruesit kryesorë të mbetjeve industriale kanë qenë industrite kimike, metalurgjike, minerare, vajore, ushqimore, etj Nga aspekti fiziko - kimik, toksikologjik dhe eko-toksikologjik një pjesë janë identifikuar si shumë toksik, iritues, si mbetje kancerogjene, etj

Nga sasia e përgjithshme e kimikateve të industrisë kimike, 40 ton (3% e sasisë totale) janë kimikate shumë helmuese, 110 ton (7%) janë jashtëzakonisht të ndezshëm dhe ndezës, 575 ton (38%) kanë karakteristika helmuese etj nga të cilat mund të ndajme veçant arsenikun, merkurin dhe disa substanca të tjera organike.

2.3.2 Ndotja e vendeve industriale nga hedhja e mbetjeve

Bazuar në një vlerësim të fundit bërë nga UNDP për ndotjen e mjedisit në zonat industriale nga hedhja e mbetjeve, numri i zonave të percaktuara si Zona të Nxehta është rritur dhe impakti që kanë këto zona në ndotjen e tokës dhe ujërave tokësor është vlerësuar si shumë i rëndësishëm.

Ne disa nga keto zona (ish P.V.C ne Vlore, Rafineria e Naftes ne Ballsh, fabrika e nxjerrjes se naftes ne Patos- Marinze, ish fabrika e metarlugjikut ne Lac, metarlugjiku ne Elbasan, ish fabrika e tekstileve ne Berat, zona e ndotur e Porto Romanos ne Durres etj) rreziku per shendetin e njeriut dhe per mjedisin ne vecanti eshte shume i larte dhe eshte e nevojshme nje nderhyrje urgjente per rehabilitimin e tyre. Nje pune per rehabilitimin e ketyre zonave te nxehta eshte bere pothuajse nepermjet nje numeri projektesh qe jane mbeshtetur nga donatore te ndryshem, sic tregohet tek seksioni 2.6.7 Investimet Nderkombetare te Donatoreve.

Bazuar në të dhënat në dispozicion nga pikat e nxehta të identifikuar në të gjithë territorin e Shqipërisë rreth 70% e tyre kishin (dhe vazhdojnë të kenë) një ndikim në ndotjen e tokës. Zonat me potencial me te larte ndotjeje jane shprehur ne % perkrah numrit total te zonave te nxehta ne tabelen e meposhtme.

Tabela: Ndotsit e mundshem ne zonat e identifikuar

Zonat	Perqindja (%)
Ndotur nga metalet e renda(Cu,Zn,Pb,As,Ni, etc) dhe mbetjet e ngurta industriale	45
Mbetjet kimike te depozituar ne magazina(kimikate toksike, etj)	22.5
Kimikate dhe pesticide qe besohet te kene ndikuar ne ndotjen e tokes	9.6
Zonat e ndotura nga Klori dhe substanca organike	6.4
Zona te ndotura nga vajrat dhe perberesit e tjere	6.4
Ndotja nga merkuri/ zhiva	3.2
Te tjera	6.9

2.3.3 Mbetje te rrezikshme

Legjislacioni është krijuar kohët e fundit për të trajtuar administrimin e mbetjeve të rrezikshme në Shqipëri. Megjithatë, për momentin nuk ka të dhëna të besueshme lidhur me nivelet e mbetjeve të rrezikshme të krijuara në të vërtetë.

Studimet e fundit të ndërmarra në lidhje me përgatitjet për ndërtimin e një vendi te pershtatshem per landfillin e mbetjeve të rrezikshme të tregojne qe rreth 3-4% e mbetjeve industriale jane te rrezikshme (me përjashtim të mbetjeve klinike dhe elementet e rrezikshme e mbetjeve shtëpiake), një nivel i krahasueshëm me atë të vendeve të tjera mesdhetare.

Një çështje kritike që lind në këtë kontekst është se si të trajtohet trashëgimia e aktivitetit të kaluar, duke përfshirë edhe hedhjen e pakontrolluar te mbetjeve të rrezikshme, ndotjen e pikave te nxehta mjedisore dhe ruajtjen e kimikateve të papërdorura, të vjetëruara ose të ndaluara.


Cdo strategji ne fuqi mbi MRR duhet te njohet te pakten elementet e meposhtem:

- Objektet fizike jane te nevojshme per trajtimin dhe asgjесimin e MRr
- Ndotja dhe pastrami i tokes duhet te njihen si nje potencial i larte burimi i MRr; rehabilitimi i tokes duhet te merret me zgjidhjen e zonave te nxehta dhe aktiviteteve ndotese ekzistuese
- Dikush duhet te financoje keto projekte, qofte nga sektori privat apo publik, nderkombetar ose nje kombinim i tyre
- Sherbimet jane te nevojshme per analizimin, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve te rrezikshme tek vendet ku ato do te trajtohen
- Struktura ligjore duhet te jete e sakte qe te rregulloje te gjitha keto sherbime

Informacioni duhet mbledhur dhe shperndare ne menyre qe te siguroje identifikimin dhe monitorimin e burimeve te mbetjeve te rrezikshme dhe te ndertohet nje fabrike me te gjitha kerkesat ligjore, sherbimet dhe teknologjite ne dispozicion.

Se fundmi, themelimi institucional dhe kapaciteti institucional duhe te merren me te gjithë detyrat administrative te perberesve te meparshem

Figure: Perberesit ne adminsitrimin e mbetjeve te rrezikshme




Qasja moderne mjedisore për parandalimin e ndotjes gjithashtu kërkon që të ketë elemente për parandalimin e mbetjeve të rrezikshme ose minimizimin në strategjinë kombëtare të MRr. Strategjia e MRr nuk mund të zhvillohet si një sektor më vete i politikës kombëtare të mjedisit.

Një çështje kyçe në këtë strategji do të jetë ajo e bashkëpunimi midis autoriteteve të MRr dhe të institucioneve qeveritare të cilët janë përgjegjës për sektorët e mëposhtëm:

- Administrimi i mbetjeve të ngurta përfshirë dhe kontrollin e depozitimeve industriale dhe bashiake
- Kontrolli dhe parandalimi i ndotjes së ajrit, ujit dhe ujrave të zeza
- Promovimi i modernizimit industrial
- Politika e prodhimit, përfshirë siguria e konsumatorit, standartizimi i produkteve dhe çështjeve lidhur me riciklimin e produkteve.
- Politika kimike, përfshirë sigurinë kimike, rrezikun e administrimit, licensimin e përdorimit dhe shpërndarjes së kimikateve të rrezikshme
- Politika lidhur me mbrojtjen e tokës dhe rehabilitimin e tokës së ndotur.

Keto lidhje ilustrohen në figurën e mëposhtme:

Figure: Sektorët politike që lidhen me politikën e mbetjeve të rrezikshme



Ne kuader te pershkrimeve te mesiperme parimet e politikës janë te perfshira ne Strategjine Kombetare Shqiptare mbi Mbetjet

Elementet strategjike janë strukturuar sipas temave te mëposhtme:

- Planifikimi dhe ngritja e impianteve per trajtimin e MRr
- Rehabilitimi i vendeve te ndotura dhe parandalimi i ndotjes
- Vendosja e shërbimeve menaxhuese te MRr
- Financimi i administrimit te mbetjeve te rrezikshme dhe rehabilitimit te tokës
- Kuadri ligjor
- Mundësimi, zbatimi, monitorimi dhe vetedija
- Promovimi i parandalimit te MRr si pjese e strategjise se prodhimit te paster
- Ngritja e kapaciteteve institucionale

2.3.3.1 Elementi i I-re Strategjik: Planifikimi dhe Ngritja e Njesive (Vend-depozitimeve per Trajtimin e Mbetjeve te Rrezikshme

Nje vend-depozitim kombetar per Mbetjet e Rrezikshme do te ndertohet dhe do te drejtohet nga Qeveria e Shqiperise. Drejtimi i ketij vend-depozitimi mund ti caktohet edhe sektorit privat, por kjo alternative nuk mund te ndodhe ne te ardhmen e afert kur shumica e mbetjeve vjen nga rehabilitimi i zonave te nxehta te cilat financohen nga Qeveria dhe dhuruesit nderkombetar.

Djegia e mbetjeve te rrezikshme eshte e perqendruar ne nje ose vetem disa vende ku ndotja e ajrit eshte e kontrolluar dhe eshte vendosur nje standart i larte monitorimi. Djegie e disa llojeve të caktuara MRr mund të pranohet në disa raste kur perdoren procese industriale termike ekzistuese me temperature te larte dhe me nje kontroll te mire te shkarkimeve (emetimeve). Per tipe te tjera MRr inceneratore te vecante janë te nevojshem.

Industria eshte e nxitur te rregulloje riciklimin e tipeve te ndryshme te MRr qe kane nje vlere ekonomike. Kompanite qe kane kapacitetin te riciklojne vete mbetjet e tyre te rrezikshme janë te nxitura te pranojne mbetje te tilla nga kompanite e tjera.

Per tipet e MRr qe janë te shtrejnta per tu djegur eksportimi i tyre ne vende te tjera eshte mundësia e vetme.

Pervoja nga e gjithë bota tregon qe hartimi i nje inventari per gjenerimin e MRr kerkone shume vite. Shifra me te besueshme nuk do te jene te gatshme derisa te kete filluar grumbullimi i mbetjeve te rrezikshme. Kjo do te thote qe ne fillim disa objekte duhen ndertuar bazuar ne vleresime shume te peraferta.

2.3.3.2 Elementi i II-te Strategjik: Rehabilitimi i vendeve te ndotura dhe parandalimi i ndotjes

Te gjithë zonat e nxehta industriale do te pastrohen deri aty ku rreziket per shëndetin e njeriut dhe ekosistemin te jene te pranueshme.

Pastrimi do jete prioritet ne baze te vleresimit te rrezikut. Standartet e rehabilitimit varen nga perdorimi i tokës se planifikuar per vendet ish industriale.

Pastrimi do te financohet nga fondet nderkombetare ne rastet me te keqija, nga ndotesi nese eshte e mundur ekonomikisht ose nga investuesit ne raste kur rritja në vlerën e pasurisë do të kompensojnë shpenzimet e rehabilitimit.

Projektet e financuara do të përdoren në mënyrë efikase për transferimin e njohurive teknike të ofruesit të shërbimit shqiptar. Ofruesit e shërbimeve lokale janë të angazhuar në projektet e financuara duke inkurajuar përdorimin e kompanive lokale në tendera ndërkombëtar.

Administrimi dhe kontrolli i rrepte i mbetjeve të rrezikshme do të çojë në parandalimin e shtimit të zonave të nxehta.

Vlerësimi, reagimi për aksidentet kimike dhe parandalimin e rrjedhjeve kimike përmes mirëmbajtjes parandaluese dhe mirë administrimit të firmës do të kërkohen nga përdoruesit e kimikateve të rrezikshme.

Projektet për ngritjen e objekteve të trajtimit të tokës së ndotur nga zonat e nxehta do të jenë të koordinuar me qëllim afatgjatë për krijimin e një sistemi të përhershëm të administrimit të MRr në Shqipëri. Për shembull, përdorimi i landfillëve për asgjësimin e mbetjeve konsiderohet si prioritet i parë për mbetjet inorganike. Eksporti i MR nga zonat e nxehta në vende të tjera preferohet vetëm për mbetjet që kërkojnë trajtim të veçantë që nuk është i realizueshëm në Shqipëri - me përjashtim të procedurave që tashmë kanë filluar.

2.3.3.3 Elementi III-te Strategjik: Vendosija e shërbimeve administruese të MR

Aktorët e sektorit privat janë të nxitur për të zhvilluar shërbimet për administrimin e MR. Transferimi i njohurive nga vendet e tjera është lehtësuar përmes projekteve të financuara nga donatorët ndërkombëtarë, duke përfshirë konsulentët lokal dhe ofrues të tjerë shërbimesh.

2.3.3.4 Elementi IV-et Strategjik: Financimi i administrimit të mbetjeve të rrezikshme dhe rehabilitimit të tokës

Financimi ndërkombëtar përveç financimit qeveritar që është aplikuar për gropat grumbuluese të MR, merret dhe me pastrimin e vendeve të ndotura dhe historike për studimin, planifikimin dhe transferimin e dijeve.

Shpenzimet e operimit dhe mirëmbajtjes MR dhe objekteve në dispozicion do të mbulohen plotësisht nga tarifat e shfrytëzimit të mbledhura sipas Principit Ndotesi Pagan. Megjithatë kostoja e trajtimit të MR dhe pastrimit të vendeve të ndotura historikisht duhet të mbulohen nga publiku dhe fondet e donatorëve. Bashkëpunimi midis sektorit publik dhe privat do të kërkojë financimin në trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve të rrezikshme. Gjithashtu investimet e huaja në trajtimin dhe riciklimin e MR janë të mirepritura. Një pjesë e kostos së trajtimit mund të kompensohet me vlerën e kimikateve.

Në tarifat e shfrytëzimit të objekteve të MR do të përfshihen gjithashtu kostot për ri-investimet e ardhshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e objektit të trajtimit

2.3.3.5 Elementi V-te Strategjik: Struktura Ligjore

Ligji i ri mbi Administrimin e Mbetjeve dhe Vendimet e tij zbatuese do të sigurojnë zbatimin e strukturas ligjore të kësaj strategjie. Ligji për Pergatitjet dhe Substancat Kimike, Ligji mbi Mbrojtjen e Mjedisit dhe ligji VNM do të bashkohen Ligjit mbi Administrimin e Mbetjeve.

Ceshtjet teknike si identifikimi i MR, monitorimi, trajtimi dhe administrimi do të sigurohen nga vendimet Ministrore dhe dokumentat udhëzuese të pergatitura nga MMPAU në bashkëpunim me autoritetet përkatëse

Legjislacioni mbi pastrimin e tokës nga ndotja do të pergatitet dhe pershtatet.

Leja mbi trajtimin e MR do të rregullohet. Kjo do të thote qe lejet qe kerkohen nga ligje te ndryshme do te shkrihen ne nje leje te vetme per te shmangur konfliktet.

Ne nje faze te mevonshme kontrolli i legjislacionit te ndotjes ne Shqiperi do te behet sipas principeve te Parandalimit dhe Kontrollit te Ndotjes. Riciklimi i sigurte ne industri i MR eshte inkurajuar nga direktivat.

Shkarkimi i MR ne kanalizime apo ajer është i ndaluar në mënyrë të qartë, si dhe përzierja e MR me mbetje të tjera. Parandalimin dhe minimizimi i MR do të nxitet nga legjislacioni dhe në përdorimin e instrumenteve ekonomike.

2.3.3.6 Elementi i VI i Strategjisë: Dhënia e lejeve, forcimi, monitorimi dhe ndërgjegjësimi

Në fazën e parë inspektimi i mbetjeve të rrezikshme fokusohet në prodhuesit e mëdhenj dhe prodhuesit e mbetjeve veçanërisht të rrezikshme dhe të atyre që janë të përshtatshme për t'u zhvendosur në landfillet e caktuara – me shumë mundësi, shërbimi i parë që do të jetë i gatshëm dhe i licensuar. Ndëshkimi për ata që nuk i dërgojnë mbetjet e rrezikshme në një impiant të autorizuar për trajtimin e tyre nuk është problem, përpara se të tilla impiante të ndërtohen. Ndërkaq, trajtimi, riciklimi dhe magazinimi i sigurtë në vendet e caktuara janë strategjitë kryesore.

Çështjet e theksuara gjatë punës së inspektimit dhe zbatimit do të jenë:

- Identifikimi dhe klasifikimi i mbetjeve të rrezikshme
- Kryerja e regjistrimit dhe sistemit vjetor të raportimit
- Forcimi i ndarjes së mbetjeve të rrezikshme nga mbetjet e tjera
- Marrja e masave për reduktimin e hedhjes së mbetjeve të rrezikshme në kanalizimet e ujërave të zeza
- Ngritja e magazinave të sigurt
- Rritja e ndërgjegjësimit në detyrimet e prodhuesve të mbetjeve

Ministria e Mjedisit dhe ARM-të do të punojnë sëbashku me bashkitë, organizatat për menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe policinë për të parandaluar shkarkimin e mbetjeve të rrezikshme në landfillet industriale dhe bashkiake si dhe të kufizojnë dhe njohin hedhjen ilegale të këtyre mbetjeve.

Autoritetet vendore që përgjigjen për sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza udhëzohen që të shtojnë kontrollin e hedhjes së kimikateve në këto kanalizime. Industrite e lidhura me sistemin e kanaleve të ujërave të zeza u kërkohet të kenë një sistem vetë-kontrolli për shkarkimet e tyre dhe të nxisin kufizimin e këtyre shkarkimeve.

Autoritetet mjedisore përgjegjëse për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, licensimin, inspektimin dhe monitorimin e emetimeve industriale në ajër dhe ujë do të vënë në dukje teknologjinë më të mirë për reduktimin e emetimeve toksike. Pastrimi i emetimit të gazrave do të gjenerojë më shumë mbetje të rrezikshme për t'u trajtuar.

Dhënia e lejeve mjedisore do të zhvillohet mbi bazën e alternativave të Kontrollit të Integruar të Ndotjes dhe Prodhimit të Pastër (si parandalimi i mbetjeve) do të cilësohet si prioritet parësor në lidhje me zgjidhjen end-of-pipe. Kjo do të thotë se zëvendësimi i kimikateve të rrezikshme, rendiment më i lartë në përdorimin e lëndëve të para dhe ujit, modifikime të procesit, mirëmbajtja parandaluese dhe kontrolli i derdhjeve etj. do të jetë më e preferueshme para se të investohet në kanalizimet e reja të ujërave të zeza, gazit ose impiantet e trajtimit të mbetjeve.

Lëvizja ndër-kufitare e lëndëve të para dhe kimikateve është e kontrolluar në mënyrë efikase për të parandaluar importin apo eksportin e paligjshëm të mbetjeve të rrezikshme. Importi i tyre në Shqipëri

nuk është i lejuar. Kjo mund të rikonsiderohet më vonë për të lejuar bashkëpunimin rajonal ose riciklimin e mbetjeve, të cilat janë të klasifikuara si të rrezikshme. Eksporti i mbetjeve në vendet e tjera me teknologji të përshtatshme trajtimi lejohet, duke ndjekur kushtet e Konventës së Bazelit, në qoftë se njësisia e shpenzimeve për të tilla trajtime në Shqipëri do të ishte e ndaluar.

Monitorimi i sasisë së mbetjeve të rrezikshme është bazuar kryesisht në vetë-monitorimin e kompanive. Është i nevojshëm një Raportim Vjetor i gjenerimit të mbetjeve nga të gjitha subjektet me leje mjedisore.

2.3.3.7 Elementi VII-te i Strategjisë: Promovimi i parandalimit të mbetjeve të rrezikshme – si pjesë e strategjisë për prodhimin e pastër

Parandalimi i mbetjeve të rrezikshme është promovuar nga Qeveria Shqiptare, duke siguruar nxitje ekonomike për të investuar në prodhimin e pastër. Kjo do të thotë modernizim të industrisë ekzistuese, duke aplikuar teknologji më të mirë dhe të arsyeshme ekonomikisht për fabrikat e reja dhe riorganizimin e pajisjeve të degraduara nga mirëmbajtja e keqe.

Zëvendësimi i kimikateve industriale që gjenerojnë mbetje të rrezikshme veçanërisht të dëmshme është nxitur me përdorimin e instrumenteve të tilla si tarifatat e përdoruesve, udhëzimet në prokurimet publike, transferimin e njohurive në lidhje zëvendësimin e kimikateve dhe në disa raste me programe për kimikate të zgjedhura.

Shqipëria do të miratojë gradualisht parimin e përgjegjesisë së zgjerimit të prodhuesve, që do të thotë se prodhuesit janë të detyruar të zhvillojnë produkte të pastra dhe të organizojnë riciklimin e produkteve që janë në fund të jetës së tyre.

Objektivat numerikë për reduktimin e mbetjeve të rrezikshme nuk janë të përshtatshme në këtë pikë, sepse duhen zhvilluar më parë statistikat për këto mbetje.

2.3.3.8 Elementi VIII-te i Strategjisë: Baza institucionale dhe ndërtimi i kapaciteteve

Detyrat dhe kompetencat e disa autoriteteve janë përcaktuar në ligjin për mbetjet e rrezikshme. Këto autoritete duhet të pajisen me stafin, trajnimin dhe buxhetin e nevojshëm.

Në Shqipëri, ku pastrimi i hot spot-eve të trashëguara do të gjenerojë shumicën e mbetjeve të rrezikshme për të paktën një dekadë, qeveria është e detyruar të ketë një rol qendror në trajtimin e këtyre mbetjeve dhe tokës së ndotur.

MMPAU dhe MPPTT do të ketë një rol kyç në ngritjen e impianteve dhe shërbimeve për heqjen e mbetjeve të rrezikshme sëbashku me gjeneruesit e mbetjeve. MMPAU ose MPPTT do të zotërojë dhe drejtojë landfilllet e para të mbetjeve të rrezikshme dhe gjithashtu do të përfshihet në mbledhjen dhe riciklimin e mbetjeve të naftës në të gjithë vendin dhe rrjetin e impianteve të tjera për mbetjet e rrezikshme. METE është gjithashtu përgjegjëse për promovimin e modernizimit industrial dhe prodhimin të pastër, parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve të rrezikshme, si një nga synimet e prodhimin të pastër.

MoLGD dhe MoTAT së bashku me Ministrinë e Mjedisit do të koordinojnë planifikimin dhe ngritjen e qendrave të pranimit të mbetjeve të rrezikshme nga familjet, shërbimet dhe industritë e vogla. Këto do të jenë në pronësi dhe drejtohen nga Qarqet ose Bashkitë.

Ministria e Mjedisit do të jetë në krye të koordinimit të menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe do të jetë përgjegjëse për dhënien e lejeve, zbatimin, monitorimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Procedurat për dhënien e lejeve dhe inspektimin janë strukturuar në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe autoritetet e tjera përkatëse të licencimit, të tilla si METE, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Transportit dhe autoritetet doganore.

2.4 Parimet e Menaxhimit të Mbetjeve

2.4.1 Hierarkia e Mbetjeve

Aktualisht legjislativi i BE është fokusuar në zbatimin e sakte të hierarkisë së mbetjeve duke përfshirë (i) Parandalimin, (ii) Përgatitjen për ripërdorim, (iii) Riciklimin, (iv) Rikuperimin dhe (v) Asgjësimin.

Kjo hierarki mbetjesh synon të nxisë menaxhimin e mbetjeve duke reduktuar sasinë e mbetjeve të prodhuara, dhe të rikuperojë një vlerë maksimale nga mbetjet që prodhohen.

Strategjia Kombëtare e Mbetjeve e adopton hierarkinë e mbetjeve si një nga parimet themelore të saj.

Parandalimi i Mbetjeve

Qeveria Shqiptare po punon në hartimin e programeve për promovimin e parandalimit dhe minimizimit të mbetjeve. Këto programe i drejtohen në radhë të parë prodhuesve të mbetjeve tregtare dhe industriale. Gjithashtu, do të zhvillohen edhe fushata informuese për të lehtësuar një fushatë më të madhe për parandalimin e prodhimit të mbetjeve drejtuar familjeve.

Ripërdorimi dhe Ripërtërimi

Mundësitë më të mëdha të ripërdorimit dhe të ripërtërimit gjenden në menaxhimin e pajisjeve në fund të jetës, pajisjeve elektrike dhe elektronike (duke përfshirë këtu edhe pajisjet shtëpiake) dhe të produkteve të tjera, të cilat mund të sigurojnë një mundësi të mirë punësimi dhe biznesi, gjithashtu edhe mundësi trajnimi dhe benefite të përfshirjes sociale për njëzë të pa punë ose me pagë të ulët.

Udhëzime në vendosjen e iniciativave bazuar në komunitet do të hartohen nga partneriteti nërmjet aktoreve kombëtare dhe lokale. Ekziston gjithashtu një potencial për përdorimin e kontenerëve shumë përdorimesh për disa produkte duke përfshirë pijet freskuese dhe qumështin.

Riciklimi dhe Kompostimi

Riciklimi dhe kompostimi janë menyrat kryesore për të ruajtur vlerat e materialeve në fund të jetës. Në mënyrë që këto dy opsione të jenë të zbatueshme, duhet të drejtohen dy çështje themelore: e para, materialet duhet të jenë në një gjendje të përshtatshme në mënyrë që të rikupërohen në një formë që më pas të përdoren, dhe së dyti duhet të ketë një kërkesë për këto produkte që do të rikupërohen.

Në mënyrë që të arrihet progresi i nevojshëm në riciklimin dhe kompostimin e mbetjeve familjare në Shqipëri, fillimisht do të nevojitet një rritje e numrit të qendrave të riciklimit, të shërbimit të grumbullimit të ndarë të mbetjeve anash trotuarit dhe të teknologjive të tjera për rikuperimin e materialeve nga mbetjet.

Zhvillimi i tregut për materialet shtesë që do të mblidhen, është gjithashtu një çështje që kërkon prioritet dhe që kërkon zbatimin e iniciativave të ndryshme që kanë për qëllim zhvillimin e tregut.

Rikuperimi i Energjisë

Rikuperimi i energjisë nga mbetjet është një pjesë e dobishme e menaxhimit të integruar të burimeve e cila mund të bëhet në disa forma. Teknikat tradicionale të tilla si incenerimi i mbetjeve mikse të cilat janë shpesh jo të njohura për publikun dhe sigurojnë benefite të limituara. Nevojiten forma të reja të kthimit në energji të mbetjeve. Një menaxhim i përmirësuar i burimeve mund të arrihet nëpërmjet ndarjes me një çilesi më të mirë të mbetjeve në burim në mënyrë që energjia të rikupërohet vetëm

nga materiale te pershtatshme. Perdorimi i teknikave alternative duke perfshire gazifikimin, pirolizen dhe teknologjine plazma, mund te ofroje reduktimin e rrezikut te demtimit te mjedisit dhe shendetit te njerezve.

Asgjesimi

Ne fund te hierarkise eshte vendosur asgjesimi i sigurte. Edhe pse kjo eshte menyra e fundit e trajtimit e mbetjeve, eshte bere progres ne projektimin me te mire te landfilleve per te ardhmen.

Vemendje po i kushtohet gjithashtu edhe menaxhimit te mbetjeve te rrezikshme familjare duke siguruar qe landfillet e mbetjeve apo mbetjet e menaxhuara nga sistemi i trajtimit te mbetjeve te perziera do te jene me te sigurta ne te ardhmen. Eshte gjithashtu e rendesishme qe te arrihet nje qasje reale e standarteve te landfilleve te pershtatshme per kushtet e Shqiperise. *Megjithate te gjitha landfillet e reja duhet te ndertohen sipas standarteve te BE.*

Hierarkia e menaxhimit te mbetjeve duhet te reflektohet ne vendimin per investimet qe duhet te behen. Investimet ne landfillet e reja (e cila eshte faza e fundit e hierarkise) duhet te behen vetem pasi jane bere investimet per fazat qe ndodhen ne fillim te listes se hierarkise sic jane infrastruktura e grumbullimit te ndare te mbetjeve, riperdorimi, riciklimi dhe rikuperimi. Kjo gje ben te mundur qe investimet e reja ne landfill te reflektojne nevojat reale aktuale te vendit, te cilat do te jene shume te uleta ne te ardhmen si rrjedhoje e zbatimit dhe detyrimit te fazave te para te hierarkise. Kjo gje siguron gjithashtu qe te mos behen investime te pa nevojshme por gjithashtu edhe kursehet hapësira dhe shmangen impaktet e panevojshme ne mjedis

2.4.2 Afersia e vendodhjes dhe Vete - Mjaftueshmeria

Parimet e afersise se vendodhjes dhe vete – mjaftueshmerise kerkojne qe mbetjet te menaxhohen sa me afer te jete e mundur me vendin ku prodhohen. Politika e BE eshte qe Vendet Antare duhet te menaxhojne vete mbetjet e tyre, dhe ku te jete e mundur te shmangin eksportin ne vendet e tjera.

Strategjia Kombetare e Mbetjeve adopton afersine e vendodhjes dhe vete-mjaftueshmerine si nje nga parimet baze te saj.

Shqiperia ka per qellim qe te zbatoje kete parim. Megjithate eshte i njohur fakti qe menaxhimi i te gjitha mbetjeve ne shqiperi mund te mos jete i mundur dhe mund te mos jete gjithnje zgjidha me e mire.

Gjithashtu Shqiperia ka per qellim te zbatoje parimin e afersine se vendodhjes sa me shume te jete e mundur ne nivelin e planifikimit te zones se mbetjeve, ndonese mund te arrihen benefite te qarta nga bashkimi i zgjidhjeve te problemeve te infrastruktures ndermjet zonave.

2.4.3 Ndotesi paguan

Parimi “ndotesi paguan” kerkon qe prodhuesit e mbetjeve te paguajne kostot e vendosura per mbetjet qe ata prodhojne. Potenciali mjedisor dhe kostot e njerezve per prodhimin e mbetjeve, trajtimit dhe asgjesimin duhet te reflektohen ne cmimin e produktit dhe ne tarifat e vendosura per sherbimin e menaxhimit te mbetjeve.

Strategjia Kombetare e Mbetjeve adopton parimin ndotesi paguan si nje nga parimet baze te saj.

Objektiva eshte qe te sigurohet nje sistem i drejte dhe ne radhe te pare te beje te mundur qe prodhuesit te prodhojne sa me pak mbetje.

3. Politika Kombetare mbi Mbetjet per Shqiperine

3.1 Politika per Administrimin e Integruar te Mbetjeve

Ne menyre qe te kete nje ndryshim efektiv dhe qe te sjelle nje zgjidhje afatgjate te qendrueshme mbi problemin e administrimit te mbetjeve ne Shqiperi, Ministria ka perqendruar vemendjen e saj ne kater shtylla kryesore sic jane:

Planifikimi, Edukimi, Financimi, Legjislacioni

Keto shtylla te cilat jane shume te rendesishme per zgjidhjen afatgjate te deges se administrimit te mbetjeve ne Shqiperi, ka nevojte te trajtohet si perparesi ne menyre qe te kete nje ndryshim te efektivitetit. Te ndryshosh qendriet dhe praktikat aktuale te individeve, subjekteve te biznesit dhe institucioneve do te marri shume kohe, fuqi dhe investime. Sipermarrje te tilla duhet te planifikohen mire ne nivel lokal, rajonal dhe kombetar. Prandaj fokusi kryesor eshte zbatimi i nje plani te thjeshte por efektiv.

3.1.1 Planifikimi ne Adminstrimin e Mbetjeve

Objektivi kryesor ne kete sektor do te jete zbatimi I planeve te thjeshta por efektive te administrimit te mbetjeve ne baze te zonave e reja te percaktuara ne Shqiperi (Planet Kombetare, Rajonale dhe Lokale te Menaxhimit te Mbetjeve). Keto zona ne fakt do te jene pasqyra te qarqeve ekzistuese. Keto plane do te identifikojne investimet afat shkurter dhe afat mesem dhe mbeshtetjen qe nevojitet. Keto me pas do te formulohen ne projekte te cilat do te financohen nga qeveria dhe me kontributin potencial te disa donatoreve.

Pergatitja e planeve kerkon dy faza:

3.1.1.1 Faza I – Pergatitja e Planit Kombetar mbi Administrimin Mbetjeve

Ky Plan Kombetar mbi Administrimin e Mbetjeve do te bazohet ne 4 shtylla kryesore te cilat do te perbejne strukturen per zhvillimin e planeve ne nivel lokal dhe rajonal.

Kjo do te coje ne zbatimin e plote te kerkesave te Komunitetit European mbi administrimin e mbetjeve.

Plani Kombetar per Menaxhimin e Mbetjeve ka per qellim te siguroje bazat per:

- Nje kuader kombetar per zhvillimin e planeve lokale dhe te zonave te mbetjeve te cilet kane vendosur parime, kane zgjidhur ceshtje me rendesi kombetare te tilla si mbetjet e rrezikshme dhe menaxhimin e mbetjeve klinike, veprimet e specializuara te rikuperimit dhe riciklimit (te gomave apo plastikes) dhe
- Plane te menaxhimit te mbetjeve lokale te cilat fokusohen ne grumbullimin dhe asgjesimin e mbetjeve urbane, duke perfshire ndarjen e mbetjeve dhe pergatitjeve per riciklim.

Plani kombetar mbi mbetjet do te krijojte keto struktura qe te forcoje dhe te realizoje qellimet dhe objektivat qe jane planifikuar:

- Komiteti Kombetar i Mbetjeve(politike)
- Grupi Keshillimor mbi Mbetjet Kombetare(teknike)
- Zonat e Mbetjeve

3.1.1.2 Faza e II – Pergatitja e Planeve mbi Administrimin e Mbetjeve ne Nivel Lokal dhe Rajonal

Perfshin pergatitjen e planeve lokale dhe rajonale ne menyre qe ti pergjigjen kerkesave afat shkurter dhe afat mesme.

Planet ne nivel rajonal (zona e mbetjeve) dhe lokal duhet te perfshijne:

- Procedura te pershtatshme dhe efektive te grumbullimit dhe transportit;
- Nje inventar te vendeve ekzistuese, gjendjen e tyre dhe planet per permiresimin e tyre;
- Standarde te perballueshme per ndertimin e landfilleve te cilet zvogelojne ndotjen;
- Mekanzima per te rritur te ardhurat nga sherbimi i grumbullimit te mbetjeve; dhe
- Te ndermerren hapa per informimin e publikut per demin e shkaktuar nga hedhja e mbetjeve.

Autoriteteve lokale do tu kerkohet qe te perfshijne ne planet e tyre mbi administrimin e mbetjeve gjitashtu dhe projekte per pastrimin e vendeve te paautorizuara per asgjesimin e mbetjeve.

Gjithesesi imponimi ndaj autoriteteve lokale nuk do te jete shume i nevojshem. Udhezimi, standartet e pershtatshme (per grumbullimin, trajtimin dhe asgjesimin) dhe suporti teknik do te jene te nevojshem tu sigurohen autoriteteve lokale ne menyre qe te sigurohen qe planet jane te nje cilesie te pershtateshme dhe qe rezultatet jane te krahasueshme.

3.1.2 Edukimi ne Menaxhimin e Mbetjeve

Qellimi i nje plani te detajuar eshte qe te lehtesoje zbatimin e nje sistemi te ri. Pjesa me e rendesishme e cdo sistemi jane njerezit qe do te operojne dhe menaxhojne sistemin e ri. Aktoret kryesore te sistemit duhet te edukohen ne menyre qe te realizojne potencialet e tyre brenda sistemit dhe si rrjedhoje sistemi te performoje ne cilesine e duhur.

Edukimi mjedisor i publikut do te mbeshtetet nga programe specifike ne bashkepunim me shoqerine civile. Qeveria do te rishikojte te drejtat mjedisore te publikut dhe do te permiresojte procedurat e apelimit administrativ dhe juridik, si rrjedhoje do te permiresojte te drejten e grupeve mjedisore dhe qytetareve ne pergjithesi per te mbeshtetur veprimet ligjore dhe duke ndeshkuar ata qe demtojne apo ndotin mjedisin.

Trajnimi i ketyre aktoreve te sistemit eshte shume i rendesishme per zbatimin dhe operimin me sukses te vete sistemit. Edukimi dhe trajnimi mund te marrin formen e: Fushatave per Informimin e Publikut dhe Trajnim profesional ose edukim tretesor per ata qe jane ne nivelin fillestar te menaxhimit te sistemit.

3.1.2.1 Fushata per Informimin e Publikut

Nje nga masat e para qe do te merren do te jete zhvillimi i nje fushate informimi te mire organizuar. Kjo fushate do te kete per qellim:

- Te rrise informimin e pergjithshem te pasojave te rrezikshme dhe ne shendet qe do te sjelle hedhja e mbetjeve dhe djegia e hapur dhe mundesite e reduktimit te zhvillimit ekonomik si psh. turizmi;
- Te ndryshojte zakonet dhe sjelljet ne vende te ndryshme dhe ne nje kohe kur impiante te reja po zbatohen per grumbullimin e mbetjeve, ndarjen, riciklimin dhe asgjesimin. Gjithashtu eshte propozuar qe fushata e informimit te ndiqet nga nje fushate detyruese kundrejt hedhjeve ilegale te mbetjeve.

3.1.2.2 Trajnimi profesional

Ne ditet e sotme mekanizmat e disponueshme per punen me kohe te plote, per te rritur kapacitetin profesional te punonjesve te sektorit publik dhe privat ne fushen e mjedisit jane te limituar. Rritja e kapacitetit eshte shume e rendesishme, vecanerisht ne procesin e zhvillimit te pergjegjesise se autoriteteve lokale dhe rajonale.

Kurse te shkurtra qe mund te kryhen nga individe me kohe te pjeseshme perfaqesojne nje mekanizem te mire per te arritur zhvillim te kapaciteteve. Keto kurse te shkurtra duhet te trajtojne tema specifike dhe pas perfundimit te tyre, individet mund te aplikojne per nje kualifikim zyrtar ne fushen e menaxhimit te mjedisit.

3.1.3 Financimi ne Menaxhimin e Mbetjeve

Sic permendet edhe ne piken me lart, edukimi i burimeve njerezore eshte shume i rendesishem per te pasur sukses ne zbatimin dhe ne operimin e nje sistemi te ri. Si rrjedhoje, burimet njerezore dhe vete sistemi kane nevoje per nje financim te pershtatshem. Eshte nje ceshtje thelbesore qe komponenti financiar i cdo plani te zonave te mbetjeve te vendose nje dispozite per financim te pershtatshem dhe te qendrushem. Plani Kombetar i Menaxhimit te Mbetjeve dhe Planet Lokale dhe Rajonale te Menaxhimit te Mbetjeve do te parashikojne financim te mjaftueshem dhe do te theksojne elementet kyce te sistemit te financimit si dhe do te pershkruajne metodat e llogaritjes se tyre.

3.1.4 Legjislacioni ne Menaxhimin e Mbetjeve

Edhe pse tre shtyllat e politikës te permendura me lart jane vendosur sic duhet, nje sistem kerkon qe te kete nje rregullim dhe eshte e rendesishme qe cdo administrator i sistemit te kete nje set te plote me regulla dhe rregullore, qe ne kete rast te perforecojne sistemin.

Republika e Shqiperise eshte angazhuar ne nje proces per antaresimin e plote ne BE dhe per kete arsye Ministria e Mjedisit ka punuar per transponimin e instrumentave legjislative kyc te BE ne instrumentat legjislative te Shqiperise. Kjo pune do te vazhdoje deri ne vitin 2012 duke qene se statusi aktual il transponimit te Direktivave eshte plotesuar vetem pjeserisht. Legjislacioni qe i perket kesaj Strategjie Kombetare te Mbetjeve eshte prezantuar ne seksionin 1.2. Ky legjislacion ka paraqitur masat per te mbrojtur mjedisin dhe shendetin njerezor duke parandaluar apo zvogeluar impaktin e kundert te gjenerimit dhe menaxhimit te mbeteve, duke reduktuar impaktet e pergjithshme te perdorimit te financimit dhe duke permiresuar eficiencen e ketij perdorimi.

Adoptimi i ketij legjislacioni do te ndikojte thellesisht ne menyren e menaxhimit te mbetjeve te Shqiperise. Ky do te jete nje hap perpara drejt permiresimit te perdorimit te financimit dhe qellimit te pergjithshem te Qeverise Shqiptare per nje zhvillim te qendrueshem.

3.2 Permiresimi i Menaxhimit te Mbetjeve ne te ardhmen

Rruga drejt permiresimit dhe pranimi ne BE, kerkojne kapercimin e disa problemeve serioze. Progresi ne menaxhimin e mbetjeve do te arrihet nepermjet fushave kyce te punes te listuara me poshte:

1. te planifikohen masa per te bere te mundur ndarjen nga mbetjet te materialeve per riciklim;
2. te rritet pergjegjesia e prodhuesve;
3. te behen permiresime ne sistemin aktual te te dhenave mbi mbetjet;

3.2.1 Planifikimi i masave per te beret e mundur ndarjen nga mbetjet te materialeve per riciklim

Duke pare te dhenat e disponueshme duket qarte se Shqiperia ka nje potencial te konsiderueshem per riciklimin e mbetjeve, vecanerisht per riciklimin e mbetjeve te biodegradueshme duke qene se perben nje perqindje domethenese te mases totale te mbetjeve. Kjo eshte nje ane positive e te dhenave te mbledhura dhe lehteson pajtimin e objektivave te vendosura nen Direktiven e Lendfillit te BE. Plani Kombetar i Menaxhimit te Mbetjeve nenvizon masat per ti dhene avantazh riciklimit te mbetjeve bashkiake dhe te plotesojne objektivat e BE per grumbullimin e ndare te rrymave specifike te mbetjeve, riperdorimin, riciklimin/rikuperimin dhe largimit nga landfillimi i mbetjeve.

Per permiresimin e riciklimit te materialeve nje kusht i domosdoshem eshte ndarja e mbetjeve ne burim. Kjo kerkon qe bashkite te organizojne apo te krijojne nje sistem grumbullimi te vecante ose ndarje te mbetjeve nga familjet e cila konsiston ne ndaren e mbetjeve ne rryma te ndryshme. Ne te gjitha zonat e mbetjeve rekomandohet qe te zbatohet sistemi i grumbullimit te ndare te mbetjeve ne tre kosha: materiale te riciklueshme te thata te te gjitha llojeve ne koshin e pare, materiale te riciklueshme te njoma ne koshin e dyte, dhe ne koshin e trete te grumbullohen mbetje mikse qe nuk perputhen me asnje nga koshat e meparshem

Materialet e riciklueshme te thata do te shkojne ne Stacionet/ Qendrat e Transferimit per te bere nje ndarje me te detajuar te rrymave. Secila nga rrymat e mbetjeve te ndara ne menyre te kujdeshme do te futet ne procese specifike prodhimi/implante riciklimi.

Materialet e riciklueshme te njoma do te shkojne ne impiantet e kompostimit, ne menyre qe te prodhojne kompostim qe me vone do te mund te perdoret per te permiresuar cilesine e shtresave te punueshme te tokes.

Vetem perberja e koshit te trete do te dergohet per tu asgjesuar ne landfill.

Ne menyre qe te garantohet cilesia e seciles nga rrymat e mbetjeve te cilat transferohen ne procese/teknologji specifike prodhimi, perberja e secilit nga koshat do te transferohet ne fazen tjetere te menaxhimit te mbetjeve, duke perdorur mjetet specifike te transportit. Ne vecanti, materialet e riciklueshme te thata nuk duhet te transportohet me te njejtin mjet qe transporton edhe mbetjet nga koshi i dyte dhe i trete.

Rrymat e tjera te mbetjeve si baterite dhe akumulatorete, mbetjet nga Pajisjet Elektike dhe Elektronike, mjetet ne fund te jetes etj. do te grumbullohen vecmas nga prodhuesit sipas skemes se vecante te grumbullimit te mbetjeve qe do te vendoset duke ndjekur rritjen e pergjegjesise se prodhuesve dhe aprovimin e rregullores specifike.

3.2.2 Rritja e pergjegjesise se prodhuesve

Prodhuesit (apo te autorizuarit e tyre: importuesit, distributorete, etj) duhet te jene plotesisht pergjegjes per menaxhimin e produkteve te tyre gjate ciklit te pergjithshem te jetes se produkteve te tyre, dhe jo vetem per mbetjet e gjeneruara gjate aktivitetit te prodhimit. Kjo nenkupton qe prodhuesit e produkteve te cilet kane prodhuar produkte qe ne fund te jetes se tyre kthehen ne mbetje problematike, jane pergjegjes per grumbullimin e ketyre mbetjeve (psh. mjete ne fund te jetes, baterite e makinave, vajrat e mbetura, MPEE) dhe duhet te mbulojne te gjitha shpenzimet qe skema e grumbullimit te mbetjeve (sic jane mbetjet e gjeneruara nga produktet e tyre) te funksionojne ne praktike dhe te kryhet trajtimi i mbetjeve te tyre.

3.2.3 Permiresimi i sistemit aktual te te dhenave mbi mbetjet

Ne menyre qe te jemi sa me prane realitetit, duhet qe te kryhen studime mbi mbetjet ne te gjitha zonat e mbetjeve ne menyre qe te llogaritet sasia ditore e mbetjeve urbane te prodhuara nga nje banor gjate nje viti, duke u bazuar ne kushtet reale te cdo bashkie si dhe ne standardet e komunitetit (ne

nivel ekonomik), gjithashtu duke u bazuar edhe ne studimet e kryera nga konsulentet e huaj ne bashkepunim me qeverine lokale.

Plani Kombetar i Menaxhimit te Mbetjeve thekson metodologjine qe duhet te perdoret ne menyre qe secila nga bashkite te mund te percaktoje sasite e mbetjeve te prodhuara gjate nje viti. Te dhenat te cilat jane matur ne menyre te kujdeshme do te mundesoje bashkine dhe qeverisjen qendrore te planifikojte me mire kerkesat e infrastruktures ne te ardhmen.

3.3 Mekanizmat per te Siguruar Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve

Ekzistojne nje sere sfidash qe shfaqen ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve te cilet nenvizojne nevojën per reforma te cilat perfshijne sa vijon:

Sfidat Ekonomike:

Kostot e impianteve te trajtimit dhe mirembajtja

Ekonomia e shkalles (p.sh. permasat dhe kapaciteti i impiantit)

Sfidat e Mjedisit:

Mundesia per te reduktuar landfillin e mbetjeve (investimi fillimisht ne grumbullimin e ndare te mbetjeve, Stacionet/Qendrat e Transferimit per nje ndarje te metejshme te mbetjeve, riperdorimi, riciklimi/rikuperimi).

Reduktimi i kerkeses mbi financimet natyrore per produktet (nepermjet riciklimit)

Sfidat Sociale:

Kerkesa e komunitetit per programet e riciklimit

Kerkesa e komunitetit per sherbime konsekuente brenda kufijve te Qarkut

Sfida Ligjore:

Rritja e kerkesave rregulluese (p.sh. per landfillet)

Potencial per kerkesa te reja te parachikuara me ligj (p.sh. Politika e Mbrojtjes se Mjedisit (Mbetjeve))

Per te permbushur keto sfida Qeveria Qendrore duhet te jete ne nje pozicion te caktuar, qe nepermjet nje roli drejtues te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve, ti pergjigjet nevojave dhe shqetesimeve te ministrive te tjera te linjes, Keshilleve te Qarqeve dhe institucioneve te tjera te komunitetit te cilet kane nevojë te qartesoje rolin e tyre ne menaxhimin e mbetjeve dhe menaxhimin e financimit, si dhe llojet e reformave ku ata mund te kontribuojne ne nje menyre te qendrushme.

Pervec stafit te dedikuar te Ministrise se Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujerve, duhet te caktohen edhe institucione te tjera qe te kontribuojne per rritjen e performances se qeverise ne kete process reformimi.

Per zbatimin e plote dhe efficient te politikës mbi menaxhimin e integruar te mbetjeve jane krijuar grupe pune prej tre nivelesh sic jane:

- o Nje Komision Nder Ministror mbi Mbetjet (ne nivel qendror dhe politik)
- o Nje grup Kombetar Keshillimor mbi Mbetjet (ne nivel qendror dhe teknik)
- o Grupet e punes se Zonave te Mbetjeve (ne nivel lokal dhe teknik ne cdo Qark/zone mbetjesh)

3.3.1 Komisioni Nder Ministror mbi Mbetjet (IMCW)

Kryetar: Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave

Anëtarët: Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

Ministria e Shëndetsisë

Ministria e Financave
Ministria e Pushtetit Vendor
Ministria e Arsimit
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes
Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Plani i Ri kombëtar për mbetjet në Shqipëri që do të mbulojë periudhën 2010-2025 do të nxjerrë në pah disa çështje të cilat do të duhet të adresohen për të përmirësuar mënyrën e administrimit të mjedisit në një nivel të lartë politik.

Një prej masave që është parë si thelbësore për qeverisjen e mirë në kushtet e mjedisit do të jetë krijimi i një Komiteti Ministror për Mbetjet. Komiteti do të përbëhet nga përfaqësues të lartë të qeverisë, në nivel Zëvendës Ministri, nga secila prej ministrive, ku ka një sektori mbi mjedisin. Komiteti do të kryesohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe listën e Ministrive të cilët do të marrin pjesë si anëtarë të përhershëm në komitet është përshkruar më lart.

Roli i Komitetit

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave ka rënë dakord me katër shtyllat kryesore të politikës

(**PERL**):

Planifikim

Edukim

Rezervim

Legjislacioni

Nën kryesinë e Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, qëllimi i komisionit do të jetë që të sigurohet se brenda çdo Ministrie ka një politikë të përbashkët dhe të unifikuar për administrimin e mbetjeve dhe të mjedisit. Shtyllat themelore e **PERL** do të jenë politikat që çdo ministri do të përdori në çështjet e mjedisit. Udhëzime në këtë drejtim për shtyllat politike e **PERL** do të lëshohen nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave.

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave do të sigurojë që secili Ministri anëtarë të jetë e vetëdijshme për përgjegjësitë e veta sipas kushteve të ndonjë politikë të re, legjislacioni, udhëzimi, planifikimi apo iniciativa të ngjashme. Gjithashtu ajo duhet të sigurojë nëse ka ndonjë ankese, që padyshim do të ketë, Ministria e prekur duhet të llogarisë dhe të raportojë paraprakisht koston.

Përveç kësaj çdo Ministri duhet të marrë përgjegjësi mbi legjislacionin të ri ose instrumenteve të tjera që kanë të bëjnë me mjedisin dhe për të vlerësuar nevojat e tyre brenda vendit në drejtim të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve, në mënyrë që të mund të ketë një tranzicion të qetë ku ndryshimet operacionale që janë parashikuar të vendosen nga Ministrinë.

Përveç kësaj është e rëndësishme që të ketë komunikim horizontal midis gjithë Ministrive anëtarë mbi iniciativat e administrimit të mbetjeve, duke përfshirë mbledhjen, magazinimin, depozitimin, transportimin e mbetjeve dhe çmontimin e objekteve të administrimit të mbetjeve.

Në mënyrë të veçantë do të sigurohet që në secilen Ministri të jenë përcaktuar qartë fushat ku operacionet e veçanta ndikojnë në mjedis dhe kur këto operacione mund të përmirësohet, janë ndërmarrë hapat e duhur për të zbutjen ndaj ndikimeve negative mjedisore ekzistuese.

Në fakt Komisioni do të jetë një konsultim ndër-Ministror i rrjeteve të komunikimit brenda Qeverisë që të sigurojë që administrimi i mbetjeve dhe mjedisi janë marrë parasysh nga të gjitha ministrit dhe se këto çështje janë trajtuar në një nivel të lartë politik. Ai gjithashtu do të sigurojë që jo vetëm Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave do të bëhet një gur themeli i çështjes mjedisore në kuadër të Qeverisë Qendrore, por përveç kësaj ajo do të sigurojë që Qeveria të ketë një angazhim të qartë për PERL dhe se ky angazhim do të bartet në një mënyrë të unifikuar prej organeve të qeverisë dhe sektorit privat në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.

Termet e Referencës për Komitetin Nder Ministror per Mbetjet (KNMM):

Duhet te organizohen takime te rregullta cdo tre muaj per te:

- Te sigurojne nje perqasje uniforme te politikës dhe legjislacionit
- Te percaktohen nevojat specifike ne kontekstin ekonomik dhe burimeve njerzore per politikën mjedisore
- Te therrase ne mbledhje kur te jete e nevojshme Grupin Kombetar Keshillimor te Mbetjeve
- Te therrase ne mbledhje kur te jete e nevojshme Grupin e punes se Zones se Mbetjeve

Cdo anetar i keshillit mund te mbaje lidhje/perditesime me cdo perfaqesues te te njejtit institucion tek NËAG per te:

- Vleresuar perfundimet dhe rekomandimet e Grupit Kombetar Keshillimor te Mbetjeve mbi ceshtjet e **PERL**
- Te bej rekomandime Ministrive mbi rezultate e mesiperme ne emer te **PERL**

3.3. 2 Grupi Kombetar Keshillimor mbi Mbetjet

Paralelisht me ngritjen e Komisionit Ndër-Ministror mbi Mbetjet do të ngrihet gjithashtu një grup keshillimor mbi mbetjet kombetare dhe palet e interesuara do jone kombetare dhe nderkombetare. Numri i aktorëve ndërkombëtar natyrisht mund të zvogëlohet në të ardhmen, sidomos pasi Shqipëria ti jetë bashkuar BE, megjithatë, është menduar se prania e palëve të a ndërkombëtare do të lehtësojë ngritjen e kapaciteteve brenda grupit.

Termet e references per Grupin Kombetar mbi Administrimin e Mbetjeve:

Kushtet e propozuar të Referencës për Grupin Kombëtar Këshillimor te Mbetjeve (GKKM) është si më poshtë:

- Anëtarët o GKAM do të veprojnë si këshilltare te Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe përfaqësuesi i caktuar nuk do të jetë figure politike.
- Anëtarët o GKAM do të formulojnë rekomandime që do ti paraqiten Ministrisë për miratim, por GKAM nuk do të ketë asnje pushtet ekzekutiv.
- Anetareve te GKAM do tu kerkohet te komentojne ne cdo raport qe eshte pergatitur nga pala teknike e Ministrise perpara se ti shperndahet aktoreve te jashtem.
- Anetaret e GKAM do te zgjidhen ne menyre te tille qe te “ ankorohen” sa me larg Ministrise, por qe prape te funksionojte si nje grup keshillimor

Kriteret qe duhen plotesuar per tu anetaresuar te GKAM

Anetaret e GKAM duhet te jene eksperte ne:

- Mbetjet bashkiake: administrimin e mbetjeve bashkiake dhe te jene te familjarizuar me Direktivat Kuader te Mbetjeve si dhe teknologjine qe do te perdoret per administrimin e mbetjeve

- Mbetjet e rrezikshme: administrimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te jete i njohur me teknologjite qe do te perdoren per grumbullimin dhe administrimin e tyre.
- Transportimin e mbetjeve: ne transportimin e mbetjeve dhe te jete i njohur me rregullat e ADR dhe me rekomandimet e ardhura nga OKB mbi transportimin e te mirave te rrezikshme.
- Te dhenat dhe informacionet mbi mjedisin, mbi administrimin dhe sistemin e mjedisit
- Politikat e administrimit te mbetjeve, strategjia dhe legjislacioni
- Riciklimi i mbetjeve te ndryshme.

Perberja e Grupit Kombetar Keshillimor mbi Mbetjet

Qe te funksionoj ne menyre efektive GKAM numri i anetarve duhet te varioj nga 12 deri te 24 persona, duke u varur nga ndryshimi i perberesve teknik si dhe nga numri i specialisteve te disponueshem per te marre pjese. Palet e meposhtme jane propozuar per te perfaqesuar GKAM dhe te jene pjestare te perhershem te Grupit:

- MMPAU
- AMP
- Kreu i Shoqatës së Shërbimeve Publike
- Perfaqesuesit e firmave te mjedisit
- Perfaqesues te firmave ligjore
- Ekspertet nderkombetar mbi administrimin e mbetjeve
- Industrite
- Shoqata shqipetare e riciklimit
- Kompanite e administrimit te mbetjeve
- Organizatat jo Qeveritare
- Grupet Rome

Grupi Kombetar Keshillimor Mbi Mbetjet nje here ne vit do te zgjedhe kryetarin i cili do te zgjidhet perbrenda antareve te grupit.

Linjat e komunikimit

Kryetari i GKAM do te bjere dakort me rekomandimet e bera ose do te komunikoj me MMPAU ose me perfaqesuesit e saj te caktuar duke i shkruajtur direkt Ministrise. Rekomandohet komunikimi shkresor (letra, fax ose email)

Administrimi i GKAM do te behet nga nje sekretar qe do jete pjese e stafit ministror i zgjedhur nga vete Ministri. I njeiti person sherben si sekretar, asistent i Ministririt dhe do te marre pjese ne takimet e ICWM

Kryetari i GKAM duhet te lidhet me ate te GZA per tu siguruar qe jane te vetedijshem per pergjegjesit qe ka secila pale

Frekuenca e takimeve

Sygjerohet qe takimet e GKAM te behen cdo 3 muaj dhe jo me shume

Implikimet financiare lidhur me Grupin Kombëtar Këshillimor mbi Mbetjet

Anetaresia ne GKAM do jete vullnetare dhe shpenzimet e bera nga mbledhjet e GKAM do te rimbursohen nga Ministria me nje fature te vlefshme

Kordinimi me rrjetin e Grupit Zona e Mbetjeve

GKAM do te konsultohet me GZM si nje pjese e brendeshme e procesit te konsultimit. Kjo do te behet permes kryetarit te GKAM dhe atij te GZM dhe kjo do te behet ne menyre shkresore.

4. Implikimi financiar mbi kuadrin ekonomik

Qëllimi i këtij seksioni është të shohim se si kostot e identifikuar mund të financohen me zbatimin e kësaj strategjie. Megjithatë, duhet të theksohet, se qysh prej fillimit plani kombëtar i mbetjeve do të jetë i ndertuar në atë mënyrë që do të marrë parasysh situatën në Shqipëri në dy faza të dallueshme të zhvillimit. Faza 1 do të jetë në stadin para pranimit në BE dhe Faza 2 do të jetë periudhë e zhvillimit pas pranimit në BE. Këto dy fazat e zhvillimit kanë implikime të ndryshme për menaxhimin e financimit e mbetjeve.

Në Fazën e 1-re të financimit, do të sigurohet nëpërmjet programit të financimit të Qeverisë Qendrore dhe nëpërmjet financave të premtuara nga bashkësia kolektive e donatorëve ndërkombëtarë, qoftë si donacione, apo si marrëveshjeve të posaçme financiare të kredisë. Këto fonde do të menaxhohen përmes mekanizmave të Qeverisë qendrore dhe bashkërendimit të njesise se donatoreve në Këshillin e Ministrave. Nëse këto fonde do të krijojnë një Fond Mjedisor kryesor ose jo është ende për t'u vendosur.

Në Fazën 2-te fondet do të vijnë kryesisht nga programi I fondeve të qeverisë qendrore dhe nga programet e infrastrukturës së fondeve të BE.

Në çdo rast shpenzimet për zbatimin dhe përputhjen me Struktura të Direktivave të BE mbi mbetjet është llogaritur përafërsisht mes € 150 dhe € 200 milion me kosto operative të shtuar vjetore prej rreth € 52 milion në vit deri në vitin e 13-te pas zbatimit.

Pjesa më e madhe e kostos është për tu krijuar nga administrata publike (136,000,000 € ose 88% e totalit), nga të cilat qarqet dhe administrata lokale (121 milion € ose 78%) dhe të administratës qendrore (€ 15.000.000 ose 10%, nga të cilat pjesa më e madhe do të krijohet nga MMPAU). Pjesa tjetër do të ndahet në mes të ndërtimit dhe industrisë së naftës (18.500.000 € ose 12%).

Shpenzimet vjetore do të ndahen pak a shumë në të njëjtën mënyrë: administratës publike (49.000.000 € ose 92% e koston totale vjetore), qarqeve dhe qeverisjes vendore (45.000.000 € ose 86%) dhe qeverisë qendrore (€ 3 800 000 ose 6%), nga të cilat pjesa më e madhe është krijuar nga MSH). Pjesa tjetër ndahet mes ndërtimit, naftës dhe industrive të tjera (4.340.000 € ose 8%).

Sipas llojit të masave të zbatimit, pjesa më e madhe e shpenzimeve do të shkojnë për pajisje dhe ndërtim (133,000,000 € ose 86% të totalit), asistencë teknike (12.400.000 € ose 8%), ndërgjegjesimit publik (8.300.000 € apo 5,3%), etj shpenzimet vjetore do të shkojnë kryesisht për operimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të reja (41.700.000 € ose 79% e koston totale vjetore), personelin e ri (€ 5.000.000 ose 9%), etj.

Burimet totale njerëzore të kërkuara shtese për zbatimin e Struktura të Direktivave për mbledhjen e mbetjeve është vlerësuar nga 350 specialistë me kohë të plotë, prej të cilëve shumica do të punësohen nga administrata publike (277 ose 80%), që në rajone dhe administrata lokale do të marrin numrat më të lartë (268 ose 75%) dhe pjesa tjetër në administratën qendrore. MMPAU do të marrë (9 ose 2,6%). Objektet e kujdesit shëndetësor do të punësojnë 62 ose 18% e numrit të përgjithshëm.

4.1 Burimet e financimit

Pika e fillimit per caktimin e shpenzimeve te menaxhimit te mbetjeve ne te ardhmen eshte parimi ndotesi paguan, i cili nenkupton qe prodhuesit e mbetjeve duhet te paguajne sa me shume te jete e mundur shpenzimet e menaxhimit te mbetjeve te tyre. Pervec se nje kerkese ligjore, ky parim eshte nje kusht paraprak per zbatueshmerine dhe qendrueshmerine financiare afat gjate per sektorin e menaxhimit te mbetjeve, gjithashtu do te siguroje edhe rritjen e stimulimit te "prodhuesve" te mbetjeve (duke perfshire edhe prodhuesit e produkteve) qe te reduktojne prodhimin e mbetjeve dhe te bejne rikuperimin e tyre. Faktori i rikuperimit eshte shume i rendesishem per mbetjet e rrezikshme duke qene se prodhuesit e ketyre mbetjeve deri me sot kane paguar te njejtat tarifa si me prodhuesit e mbetjeve jo te rrezikshme ose ne disa raste nuk kane paguar fare.

Megjithate, ndersa shpenzimet e grumbullimit dhe asgjesimit te mbetjeve do te mbuloohen nga prodhuesit, ekziston akoma ceshtja financiare, duke qene se kerkohen shpenzimet kapitale per grumbullimin, transportin dhe impiantin e asgjesimit dhe te gjitha keto shpenzime kapitale nuk mund te perballohen nga tarifat e mbledhura nga familjet.

4.1.1 Faza e 1 e Financimit: (Para pranimit ne BE)

Supozohet se Qeveria Shqiptare (qendrore, rajonale dhe lokale), do te marre iniciativen, te pakten si fillim, te ndertoje impiante per grumbullimin e mbetjeve dhe te permiresoje procesin e riciklimit dhe te asgjesimit te mbetjeve, gje qe do te kerkoje rritjen e financimit, edhe pse shpenzimet e ketij financimi do te mbuloohen nga tarifat qe do te paguajne prodhuesit e mbetjeve.

Buxheti i shtetit, bashkise dhe komunes

Ne te shkuaren por edhe ne ditet e sotme, qeveria qendrore ka ndermarre nje rol drejtues ne financimin e shpenzimeve kapitale apo te studimeve te fizibilitetit ne sektorin e menaxhimit te mbetjeve. Keto financime mund te jene ose mund te mos jene kryer ne bashkepunim me komunitetin e donatoreve nderkombetare dhe gjithashtu mund te jete pjese e nje buxheti te rregullt apo te nje alokimi special te rezervuar per nje rast apo suate te vecante.

Per shembull Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (MPPTT) ka nje plan financimi afat mesem per menaxhimin e mbetjeve te ngurta. Me teper sa se nje buxhet i veshtire, ky eshte nje plan dhe fondet nuk jane plotesisht te sigurta. Per periudhen 2008 – 2010 dhe 2011 MPPTT ka gartuar planin e financimit afat mesem per menaxhimin e mbetjeve te ngurta.

Shuma e alokuar ne Lek SHqiptare (ALL) eshte 148 milion per vitin 2009, 350 milion per vitin 2010 dhe 400 milion per secilin nga vitet 2011 dhe 2012. Vihet re qe keto shuma jane alokuar per projekte te vecanta, duke perfshire:

- o Ndertimet e Lendfilleve (Shkoder, Bajram Curri, Rreshen, Skrapar, Fier, Lushnje, Elbasan, Vlore)
- o Mbylljen e Lendfilleve (Korce, Vlore, Durres, Pogradec, Elbasan)
- o Studime per mbylljen dhe rehabilitimin e lendfilleve ekzistuese (Durres, Elbasan, Shkoder, Vlore, Sarande, Lushnje)
- o Studime fizibiliteti per lendfillet (ne Lushnje, Fier, Elbasan, Vlore)
- o Projektimin e landfillit rajonal per Vloren
- o Konsulence

Periudha e para- pranimit ne BE: Instrumentat per Asistencen Para - pranimit (IPA)

IPA eshte prezantuar ne Janar te vitit 2007 dhe ka zevendesuar programe te mepareshme dhe instrumenta financiare te BE-se per vendet kandidate dhe per vendet qe kane potencial per tu bere kandidate. Programi IPA perbehet nga pese komponent te ndryshem:

- o Asistence per periudhen e tranzicionit dhe ndertimin Institucional;
- o Bashkepunimi pertej kufirit (me vendet anetare te BE dhe vende te tjera kandidate per IPA);
- o Zhvillim rajonal (transporti, zhvillimi mjedisor dhe ekonomik);
- o Burimet njerezore (forcimi i kapitalit njerezor dhe lufta kunder perjashtimit nga detyra);
- o Zhvillimi rural.

Komponenti i I-re eshte nen pergjegjesine e Drejtorise se Pergjithshme per Zgjerimin e Komisionit, e cila eshte gjithashtu pergjegjese per koordinimin e pergjithshem te asistences ne periudhen para pranimit. Perfshine masat per ndertimin institucional dhe investimet qe nevojiten per keto ndertime, gjithashtu, aty ku eshte e nevojshme, edhe masat e duhura per periudhen e tranzicionit dhe te stabilizimit. Kjo kryhet permes programeve vjetore kombtare dhe me shume objektivesh.

Komponenti i II-te mbeshtet bashkepunimin pertej kufijve ndermjet vendeve kandidate/vendeve qe kane potencial per te qene vende kandidate dhe bashkepunimin e ketyre vendeve me vendet anetare te BE. Drejtoria e Pergjithshme per Zgjerimin e Komisionit dhe Drejtoria e Komisionit per Zhvillim Rajonal jane bashkarisht pergjegjese per zbatimin e komponentit te II-te. Ne kete komponent kerkohet nje aplikim i perbashket me vendet fqinje.

‘Vendet qe kane potencial per te qene vende kandidate’ sic eshte Shqiperia bejne pjese ne komponentin e I-re dhe te II-te te permendur me lart.

BE ben alokime treguese shume vjecare bazuar ne Kuadrin Financiar Shume-vjecar IPA (KFSHV). Shumat e disponueshme per te ardhmen, pas vitit 2011 deri me daten e pranimit, ne terma reale pritet qe te perdoren me ritme te ngadalta. Kur Shqiperia te behet kandidate e plote, do te kete nje rritje te alokimeve treguese.

Keto shuma mbulojne ndihmen ne te gjitha sektoret, dhe jo vetem sektorin e mjedisit dhe te mbetjeve. Projektet klasifikohen si detyrime politike, ekonomike dhe detyrime te antaresimit. Ndarja ndermjet ketyre grupeve per alokimet e periudhes 2007 – 2009 ka qene perkatesisht 30-35%, 20-25% dhe 40-50%. Asistenca per zbatimin e Direktives Kuader te Mbetjeve mund te klasifikohet si nje detyrim i antaresimit.

Duke filluar me alokimin e IPA 2008, Shqiperia pritet qe te siguroje bashke-financim – duke filluar nga 10% per projektet per asistence teknike (AT) deri ne 25% per projektet per investime. Megjithate ne rastet e mepareshme, ky bashke – financim mund te kete qene ne sherbime apo te mira materiale dhe jo domosdoshterisht kontribut monetar. Meqenese kjo mund te perfshije pagat e personave qe marrin pjese ne sherbimet publike, dhe meqenese kjo pjesemarrje ne cdo rast eshte me te vertete e nevojshme me projektet per asistence teknike, shpenzimet e bashke – financimit te Shqiperise mendohet qe te jene zero.

Grante nga donatore te tjere nderkombetare

Duke u bazuar ne databasen e projekteve per ndihme e cila mbahet nga departamenti i Keshillit te Ministrave per koordinimin e ndihmes se huaj, donatore qe nuk bejne pjese ne BE i kane dhene Shqiperise nje ndihme prej 2600 milion Euro gjate 9 viteve te fundit. Nga kjo shume totale, rreth 366 milion Euro jane perdorur per projektet e sektorit mjedisor. Vetem 22 milion Euro ose rreth 1 % e shumes totale jane perdorur per projekte te sektorit te mbetjeve te ngurta, nderkohe qe 280 milion Euro jane perdorur per projekte te sektorit te ujit dhe kanalizimeve. Pjesa me e madhe e projekteve ne sektorin e mbetjeve te ngurta jane perdorur per rehabilitimin e problemeve historike te tokes se ndotur.

4.1.2 Faza e 2 e Financimit: (periudha e pas pranimit ne BE)

Ne kete faze, ku antaresimin ne BE eshte gjithnje e me shume i maturuar, pjesa me e madhe e granteve te financimit te periudhes se pas pranimit do te behen te disponueshme nga Fondi European per Zhvillimin Rajonal (FEZHR) per te financuar investimet e nevojshme ne fushen e mbetjeve:

Periudha e pas – pranimit ne BE: grante nga fonde strukturale (FEZHR dhe FK)

Shqiperia do te jete ne gjendje te aplikojte per marre financim nga Fondi European per Zhvillimin Rajonal dhe Fondi i Kohezionit ne momentin qe do te jete antare e BE. Aktualisht nuk dihet se sa mund te jete shuma ne dispozicion, por duke u bazuar ne eksperiencen e vitit 2007 per vendet kandidate per te hyre ne BE si dhe pranimin e Rumanise dhe te Bullgarise, mendohet qe shuma e

financimit do te jete me e madhe se ajo e para pranimit dhe kjo shume do ta ndihmoje infrastrukturen e Shqiperise te arrije standardet e BE. Me siguri qe ne kete aspekt do te kerkoet edhe bashke financimi i Shqiperise.

Ekzistojne disa menyra, te cilat zonat e mbetjeve mund ti shqyrtojne ne menyre qe te rrisin financen e nevojshme:

1. Hua nga nje institucion financiar nderkombetar (IFN) sic jane Banka Boterore dhe BERZH. Kjo eshte menyra me e mire per arsye se kushtet e vendosura per marrjen e ketyre huave jane me pak te veshtira se sa nga ato te bankave tregtare (interesa me te uleta, periudha te te gjata te shlyerjes). I vetmi problem eshte se keto hua jane te disponueshme vetem per projekte me shuma te medha investimesh duke qene se IFN-te aplikojne minimumin e limiteve te interesit ne varesi te sasise se huase qe jane duke dhene (p.sh. 20 milion Euro). Disa IFN kerkojne qe te lihet nje garanci per huane e marre.
2. Hua nga nje banke tregtare. Edhe pse kushtet e kredise jane me pak terheqese ne krahasim me IFN-te, dhe duke pare qe huate ne Shqiperi zhvillohen dhe maturohen gjithnje e me shume, kjo mundesi mund te kthehet ne nje opcion relativisht te hapur.
3. Bono te leshuara nga autoritetet e qeverise lokale. Pjesa me e madhe e autoriteteve lokale ndoshta nuk jane akoma ne ate faze ku mund te leshojne bono me qellim rritjen e finances, dhe kjo per arsye se nuk jane qytete te medha dhe mungon pavaresia ne auditimin e llogarive te tyre. Qytete me te medha mund te jene ne gjendje te leshojne bono me qellim rritjen e kapitalit. Megjithate, per te arritur kete, ata do te kishin nevojte per nje klasifikim te kreditimit nga nje agjensi e specializuar sic eshte Moody's, Standard & Poor.
4. Kapital privat {nepermjet marreveshjes se partneritetit publik privat (PPP)}. Ne nje faze te metejshme, gjate periudhes se pas pranimit ne BE mund te jete e mundur terheqja e kapitaleve private per disa projekte te infrastructures mjedisore. Nga njera ane, bashkite mund te nenshkruajne kontrate sherbimi me kompani private per grumbullimin e mbetjeve dhe transferimin e tyre ne nje qender te trajtimit te mbetjeve, ne nje impiant te rikuperimit te materialeve ose impiant riciklimi ne kembim te nje tarife. Kjo menyre shmang problemet e financimit te qeverise, duke qene se eshte kompania private ajo qe do te rrise financen e nevojshme, dhe ne parim tarifa mund te rikuperohet nga tarifat e vendosura per prodhuesit e mbetjeve. Ne nje nivel me te sifistikuar, kontraktoret private duhet te operojne ne nje sasi te konsiderueshme te te gjithte sistemit te menaxhimit te mbetjeve ne nje prefektore, ne formen e nje koncesioni apo bazuar ne nje kontrate NOT (ndertim – operim – transferim). Keto ndertime do te kerkojne nje numer zhvillimesh para se te zbatohen ne Shqiperi, duke perfshire ketu edhe reformen ne sektorin e finances ne bashki dhe ne ndermarrjet komunale, deshmi te qarte qe shteti eshte i gatshem te detyroje zbatimin e ligjeve te reja dhe bashkite te jene te gatshme te lejojne qe shpenzimet reale te menaxhimit te mbetjeve te mbulohen nga tarifat qe paguajne prodhuesit e mbetjeve si dhe nevoja e vendosjes se operatoreve te besueshem ne impiantet e reja.

4.2 Tarifat e mbetjeve

Tarifa mbi mbetjet ose ndryshe te quajtura Tarifat e Pastrimit aplikohen direkt te rezidentet, konsumatoret komercial dhe indutrite nga bashkite. Percaktimi i taksave eshte i permblendhur ne ligjin Ligjin nr.9632, 30.10.2006, mbi Taksat Vendore Kapitulli VII, Artikulli 35 dhe Ligji nr.8652, 31.07.2000

Këshilli Bashkiak ose Komunal përcakton tipin e taksës, rregullat e grumbullimit dhe administrimin e tyre. Taksa për një "biznes të vogël" nuk mund të kalojë 10% e taksës treguar në Tabelën e Taksave për Bizneset e Vogla.

Nuk ka asnjë autoritet qendror rregullativ të veçantë që shqyrton dhe miraton tarifën apo ndryshimet në tarifë.

Këshilli Bashkiak ose Komunal gjithashtu përcakton nëse tarifën do të mbledhen nga autoritetet lokale ose nga një agjent i caktuar nga ai. Kur taksat janë të mbledhura nga një agjent, ai është i caktuar nga Kryetari i Bashkisë ose kreu i Komunës, i cili hyn në një kontratë me të (agjentin). Agjenti duhet të veprojë sipas rregullave të përcaktuara nga Këshilli Bashkiak ose komunal.

Te ardhurat të krijuara nga mbledhja e taksave duhet të përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë grumbulluar.

Te ardhurat e gjeneruara nga tarifën e pastrimit duhet të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë krijuar (ato nuk janë taksë).

Të ardhurat e krijuara nepermjet mbledhjes së taksave për pastrim janë rastësisht larg nga buxheti i përdorur nga ana e komunës për pastrimin e qytetit dhe administrimin e mbetjeve. Shumica e komunave kanë nevojë duhet të shtojnë burime të tjera që të mbarojnë pastrimin e qytetit dhe administrimin e mbetjeve.

Tarifën e menaxhimit të mbetjeve do të rriten në mënyrë që të reflektojnë kostot në përputhje me legjislativën e BE-së.

4.3 Fondi Mjedisor

Investimet e nevojshme për arritjen e standardeve mjedisore do të mbështeten nga Fondi Mjedisor i cili do të vendoset në një linjë me Programin e Qeverisë.

Qëllimi kryesor i Fondit Mjedisor është që të veprojë si një grumbullues qendror dhe si një pikë shpërndarjeje për disa apo për të gjitha të ardhurat nga tarifën mjedisore, gjatë, taksat dhe burime të tjera, duke përfshirë edhe donatorët. Me pas shpërndarja e fondeve tek projektet mund të bëhet në bazë të kriterëve të qarta dhe transparente. Në mënyrë që Fondi Mjedisor të funksionojë në mënyrën e duhur, duhet të plotësohen disa kushte. Në radhë të parë duhet të sigurohen të ardhurat të mjaftueshme për të bërë një kontribut të rëndësishëm. Gjithashtu, gjatë procedurës së alokimit të fondit, nuk duhet të ketë interferencë nga jashtë.

Në momentin kur qeveria të ketë vendosur kriteret primare të përmirësimit mjedisor dhe kriteret për përzgjedhjen e projektit, Fondi Mjedisor duhet të aplikojë lirisht këto kriterë, pa pasur influencë të papershtatshme politike. Kriteret e alokimit të fondeve duhet të monitorohen periodikisht nga auditimi.

Me qartësi, aktivitetet e Fondit Mjedisor duhet të kontrollohen, dhe ndonëse kontrolli do të kryhet nga një organizatë anonime, siç do bankat, në Bordin e Kontrollit do të bëjnë pjesë përfaqësues të Ministrive përkatëse duke përfshirë Ministrinë e Financës, Punëve Publike, Punëve të Brendshme dhe ato të Mjedisit.

Është e rëndësishme që sektori privat dhe jo qeveritar të kenë nga një përfaqësues në bordin drejtues të fondit duke qenë se këto sektore ndikohen drejtpërdrejtë nga problemet që mendohet që fondi do të zgjidhë, dhe ata kanë akses në informacionin dhe mirekuptimin lokal të cilët nuk do të kenë ndikim në vlerësimin nëse veprimet e fondit janë praktike dhe reale.

Një nga problemet kryesore në kryerjen e investimeve në infrastrukturën mjedisore komunale në Shqipëri ka qenë vështirësia në terheqjen e financimit të donatorëve. Krijimi i Fondit Mjedisor do ta

zgjithe kete problem. Fondi Mjedisor do te jete pergjegjes edhe per te siguruar nje pike koordinimi ndermjet te cilit donatoret mund te sigurojne financim per projektet prioritare dhe te sigurojne elementet e nevojshem per bashke – financim te Shqiperise.

5. Raportimi, Monitorimi dhe Vleresimi

5.1 Hapat e tjere dhe Mbarevajtja e Monitorimit

5.1.1 Administrimi i Ndryshimeve

Kjo Strategji paraqet sfida te vërteta për të gjithë aktorët kryesorë për të mbajtur një qëndrim të koordinuar për administrimin modern të sistemit të administrimit të mbetjeve në Shqipëri.

Perfshirja e aktoreve kryesore ka qene thelbësore për zhvillimin e Strategjise Kombetare të Mbetjeve dhe ata gjithashtu do të kenë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve.

Një vazhdim i komunikimit midis palëve është një mjet efektiv për ruajtjen e Planit Kombëtar mbi Mbetjet. Aftësia për të formuar drejtimin e ardhshëm të planit në nivel kombëtar është gjithashtu i rëndësishëm.

Perfshirja e Aktoreve Kryesore në zhvillimin e planeve Rajonale dhe Bashkiake do të jetë një çështje thelbësore që në fillim; rishikimi dhe zgjedhja ndërmjet opsioneve strategjike që i përshtatet me mirë asaj zone. Përgatitja e Planeve do të përfshijë një keshillim të gjere dhe iniciativa informimi për të inkurajuar interes në këtë proces dhe për të siguruar që këndvështrimet e aktoreve kryesore, duke përfshirë edhe publikun, të merren në konsideratë.

Nepermjet këtij procesi zgjidhja e problemeve të mbetjeve do të kryhet në nivel lokal dhe Planetë përfundimtare që do të hartohen do të jenë në pronesi të një grupi të gjere aktorësh. Inkurajimi i pjesëmarrjes do të bëhet nepermjet disa menyrash duke përfshirë: konferenca shtypi, postera, fletushka informimi, faqe interneti, takime konsultimi, konsultime me shkollat si dhe përgjigja e pyetjeve të paleve të interesuara.

Në rolin e partnerit, Qeveria do të përpiqet të garantojë që Planetë e Zonës së Mbetjeve do të sigurojnë përfshirjen e të gjithë aktoreve kryesore dhe në veçanti, që autoritetet lokale do të përfshihen plotësisht në procesin e zhvillimit të zgjidhjeve të ardhshme për menaxhimin e mbetjeve bashkiake.

5.1.2 Mbajtja në Dijeni e Aktoreve kryesore

Një **Seminar vjetor me Aktoret kryesore** do të mbahet në nivel kombëtar. Ky seminar do të bëjë të mundur që një grup me i gjere i aktoreve kryesore të takohen një herë në vit. Qëllimi i këtij seminari do të jetë përfshirja e aktoreve kryesore në rishikimin e progresit të zbatimit të Planit Kombëtar të Menaxhimit të Mbetjeve. Do të sigurojë gjithashtu një mënyrë për të vazhduar përpara dhe për të influencuar në drejtimin që do të marrë plani në të ardhmen.

Një kuader në rrejt i aktiviteteve do të ofrojë një mjet për përditesimin e progresit në zbatimin e Planeve Zonale të Mbetjeve dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve. Ato do të paraqesin një varg aktiviteteve të cilat janë planifikuar si pjesë e shpërndarjes së projekteve. Si një kornizë e të gjithë aktiviteteve kyçe ajo do të japë paleve të interesuar mjetet për të parë progresin, të vlerësojë zhvillimet e reja, të bashkojnë punën e tyre me objektivat e Planit Kombëtar mbi Mbetjet dhe të ruajnë aktivitetet në cilat ata marrin pjesë.

5.1.3 Monitorimi dhe Rishikimi i Planeve Zonale te Mbetjeve dhe Planit Kombetar mbi Mbetjet

Administrimi i mbetjeve po ndryshon me nje shpejtesi marramendese, me zhvillimet ne legjislacion, ne teknologjite e grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit, zhvillimin e tregut dhe permisimin e te dhenave.

Plani Kombëtar mbi Mbetjet dhe Projektet Zonale te Mbetjeve duhet të mbahen nën shqyrtim për të siguruar që ata te jenë të përgjegjshëm për të ndryshuar me kalimin e kohës. Kjo është veçanërisht per rastet kur merresh me trajtimin e ketyre planeve te cilat kane lene mundesi te hapura afatgjata per te qene hap pas hapi me teknologjit e reja te trajtimit te mbetjeve.

Ndersa ajo eshte e qarte dhe ne rastet me te medha Planet Zonale te Mbetjeve dhe Strategjia Kombetare mbi Mbetjet kane qene efektive, eshte akoma e nevojshme te rishikohen kufijte per tu siguruar qe ata jane duke shperndare shkallet e ekonomise dhe partneriteteve. Nje rishikim i Planit mbi Zonat e Mbetjeve do te ndodhi pergjate dy viteve te ardhshme.

Objektivat e vendosura ne cdo Plan Zonal te Mbetjeve do jete i lidhur me objekte te tjera qe do te monitorohen dhe raportohen kundra nje grupi treguesish nderkombetar. Rendesit do ti jepet ne kete process zhvillimit te treguesve qe adresojne faktoret social, ekonomik dhe mjedisor

Objektivat dhe masat të veçanta janë vënë në përgjigje të çështjeve mjedisore të identifikuarat tashmë. Ky kapitull prezanton mjetet me të cilat këto objektiva mund të arrihen:

5.1.3.1 Koordinimi i politikave dhe interesave tona

Te nenvleresosh rendesine e zhvillimit te qendrueshem, ta shohesh mjedisin si nje ceshtje qe i perket ekologjisteve, te mos njohesh pergjegjesite qe ke per ajrin, ujin dhe token eshte nje gabim qe do ti kushtojte shume shtrejnte brezave te ardhshem

Mjedisi eshte nje ceshtje qe i perket te gjithe popullit: te gjithe duhet te luajne rolin e tyre ne administrimin e mjedisit dhe realizmin e objektivave te kesaj strategjie. Ashtu sic duhet te luaj cdo person rolin e vet duhet dhe institucionet dhe organizatat te cilave ne i besojme- institucionet e qeverise. Per ta bere kete sa me efektive institucionet duhet te koordinojne politikat dhe masat e tyre ne menyre qe ligjet, administrimi dhe investimet te jene eficente dhe koherente

5.1.3.2 Zbatimi i monitorimit

Kjo strategji eshte pjese e sistemit te menaxhimit te mjedisit te Shqiperise i cili perfshin monitorimin dhe raportimin e progresit. Duke qene se strategjia eshte pjese e sistemit, ai gjithashtu ka nevoje per monitorim. Monitorimi do te ndermerret duke perdorur ne linje indikatoresh. Nje set baze do te raportohet vazhdimesisht duke perfshire kater tipe indikatoresh:

- Gjendjen e Indikatoreve Mjedisor
- Indikatoret e Performances se Infrastruktures Mjedisore
- Indikatoret Financiare
- Indikatoret Administrative

Gjendja e Mjedisit

Masat e fundit te zbatimit te kesaj Strategjie do te jene kushtet e mjedisit ne aspektin e administrimit te mbetjeve

Treguesit e pare te publikuar ne lidhje me kete Strategji kane per qellim te japin nje tregues te pergjithshem per ndryshimet e ndodhura ne mjedis.

Nje nga sfidat me te medha te paraqitura nga kjo Strategji eshte nevoja per te realizuar nje zhvillim te qendrueshem te infrastruktures komunale. Per kete arsye kater tregues specifik, dy per mbetjet e

lengeshme dhe dy per mbetjet e ngurta do te raportohen cdo vit per te treguar nivelin e masave te marra nga komuna.

Elementet	treguesit
Mbetjet	Grumbullimi dhe hedhja e mbetjeve ne % per popullsine
Mbetjet	Riciklimi i mbetjeve ne % i mbetjeve te prodhuara qe jane ricikluar

Indikatorët Financiar

Eshe gjithashtu e rendesishme te konsiderohet shuma e perpjekjeve qe eshte bere per te adresuar sfidat per investimet me te medha. Si te tille indikatorët e angazhimit financiar do te duhet te publikohen gjithashtu:

Elementet	treguesit
Administrimi i mbetjeve	Investimi ne mbetjet e ngurta per vit (cmim fiks)
Toka e ndotur	Investimi ne restaurimin e tokes se ndotur per vit (cmim fix)
Administrimi mjedisor	Shpenzimet operacionale mbi mbrojtjen e mjedisit ne vit

Treguesit administrativ

Nje qellim kryesor i strategjise eshte zbatimi i nje sistemi modern administrative mbi mjedisin. Eshte e rendesishme te dihet nese ky sistem po funksionon. A jane mundesuar burimet e duhura dhe a jane procedurat e duhura duke u aplikuar? Nje informacion mbi mbarevajtjen e sistemit adiministrativ eshte i rendesishem per te vleresuar efektivitetin e tij ose nevojat e tij per permisim apo reformin. Kjo kerkon monitorimin e rregullt te produktivitetit. Kjo do te perfshije komandimin dhe kontrollin: ceshtjes se lejeve, freskimit e lejeve, frekuencat e inspektimit, efikasitetin e grumbullimit, por prape do ti duhet te mbuloje dhe aspekte te tjera te lidhura me efikasitetin e administrimit si koha qe duhet per tju pergjigjur kerkeses se nje pjestari te publikut, ose koha qe duhet per te pergatitur raportet.

Performanca e administrates mbi standartin e administrimit do te rregjistrohet dhe publikohet si ne formen e meposhtme:

Elementet	Treguesit
Zhvendosja e legjislacionit	Shkalla e marreveshjes midis legjislacionit kombetar dhe atij te Komunitetit European
Informacioni mjedisor dhe komunikimi	Konsultimet me grupet e interest per pergatitjen e Politikave mbi Mbetjet, Strategjive, Projekteve dhe Ligeve. Informimi nga ana e MMPAU te audiences mbi administrimin e mbetjeve dhe mjedisit.
Gjobat/ Zbatimi	Shkalla e lartë e anulimit te gjobave. Ndjekjet penale kunder personave qe bejne vepra serioze lidhur me demtimin e mjedisit
Edukimi mbi Mjedisin	Mesuesit te trajnuar per te shpejguar ceshtjet mbi administrimin e mbetjeve dhe te mjedisit si nje lende me vete e futur ne sistemin para universitar. Shkollat fillore : Nje number trajnuesish te kualifikuar qe te trajnojne mesuesit e shkollave fillore persa i perket moduleve dhe teknikave mbi mjedisin

Përveç treguesve baze te caktuar, matjet e veçanta do të bëhen në lidhje me masa të veçanta.

5.1.3.3 Te raportojme progresin tone

Kjo strategji eshte nje dokument publik i marre seriozisht nga Qeveria per popullin Shqipetar. Por ai nuk do te jete i suksesshem vetem nese merret persiper vetem nga Qeveria. Bashkepunimi midis qytetareve dhe organizatave te tjera jo qeveritare eshte shume i rendesishem. Qeveria per shembull do te publikoje dhe shpjegoje masat e marra prej saj ne menyre qe te nxisi publikun qe te marrin pjese ne zbatimin e kesaj strategjie.

Progresi do ti raportohet direkt edhe partnereve donator dhe Komisionit European ne menyre qe ti mbajme ata te informuar mbi efektivitetin e mbeshtetjes se tyre.

Informacioni i mbledhur gjate monitorimit te zbatimit te strategjise nuk do te jete i dobishem nese nuk ndahet ne menyre te hapur dhe raportohet.

Raportimi dhe komunikimi midis institucioneve qeveritare

Ky plan kerkon zgjidhjen e disa ceshtjeve shume te nderlikuara qe prek nje shume sektore. Ne menyre qe te adresohet kjo eshte e rendesishme per institucionet qe te komunikojne haptazi dhe te ndajne informacionin qe kane.

Veshtiresite teknike dhe ato praktike kane parandaluar qe keto te ndodhnin ne te shkuaren. Gjithsesi duke qene se sistemi komunikativ nder istitucional po zhvillohet, sidomos nepermjet perdorimit te teknologjise se re, veshtiresi te tilla do te zvogelohen nga qeveria.

Vendosja e keshillit nder Ministror mbi Mbetjet dhe Grupit Kombetar Keshillimor mbi Mbetjet bashkuar me Grupin Zonat e Mbetjeve do te ndihmojne qe barrierat e ngritura per shkembimin e informacionit te mos pengojne zbatimin e kesaj strategjie.

Komunikimi me komunitetin dhe me palet e tjera te interesuara

Publiku, industria, tregtia, OJQ-të, agjencitë ndërkombëtare dhe donatorët janë pjesemarres te nevojshem te ketij projekti. Si mund te shpresojme ne qe ata te marrin pjesë në mënyrë efektive nëse ne nuk i tregojme atyre se çka po ndodh në një mënyrë të strukturuar dhe të efektshme?

Duhet te ofrohen buletine te rregullta mbi zbatimin e strategjise dhe buletine të rregullta të gjendjes se mjedisit duke përfshirë edhe një raport vjetor, të gjithë aktorëve te administrimit te mbetjeve.

Komunikimi me BE dhe Donatore te tjere

Progresi gjithashtu do tu raportohet ne menyre te drejtperdrejt partnereve donatore dhe Bashkimit European ne menyre qe ti mbaj ata te informuar per efektshmerine e mbeshtetjes se tyre dhe ti vleresoje ata per nevoja potenciale qe do te kete ne te ardhmen.